AKADEMIA E SHKENCAVE E R P. TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË

# DEFTERI I REGJISTRIMIT TË SANXHAKUT TË SHKODRËS I VITIT 1485

Paraqitja, hyrja, transliterimi,
përkthimi dhe komentet nga
SELAMI PULAHA

TIRANË, 1974

U dorëzua në shtyp në dhjetor 1973. Doli nga shtypi në maj 1974

Tirazhi: 3000 kopje Formati: 70x100/16 Stash. 2204-72

Shtypur: Drejtoria Qendrore e Poligrafisë
Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë

# HYRJE

Studimi i ndryshimeve social-ekonomike që ndodhën në tokat shqiptare me pushtimin osman të kryer gjatë shekullit XV përbën një nga detyrat kryesore në fushën e studimeve të historisë mesjetare shqiptare, sepse nëpërmjet tij do të mund të zbulohen rrënjët e asaj qëndrese të ashpër që i bëri populli shqiptar gjendjes së re jo vetëm në shekullin XV, por edhe në shekujt XVI-XVII dhe do të mund të kuptohet rruga historike që ndoqi në kushtet e reja populli ynë. Zgjidhja e kësaj detyre kërkon në radhë të parë botimin e materialeve dokumentare që pasqyrojnë politikën e ndjekur nga sunduesit e rinj osmanë ndaj klasës feudale vendase dhe ndaj fshatarësisë, nëpërmjet zbatimit të sistemit të timarit. Në këtë drejtim një hap të rëndësishëm përpara bëri historiani turk Halil Inalxhik me botimin e *Defterit të sanxhakut shqiptar të vitit 1431-32*,[1] që është një burim historik me vlerë për të njohur gjendjen e re të krijuar në Shqipërinë e mesme dhe jugore në gjysmën e parë të shekullit XV. Me qëllim që të zgjerojmë këtë kuadër edhe për krahinat e Shqipërisë veriore pas rënies së Shkodrës në vitin 1479, i vumë vehtes për detyrë të botojmë *Defterin e hollësishëm (mufassal) të regjistrimit të tokave dhe të popullsisë në sanxhakun e Shkodrës në vitin* 1485[2], deri tani i pabotuar dhe i pastudjuar.

Në arkivat turke, si në Arkivin e kryeministrisë në Stamboll (*Başvekâlet arşivi = BV.A.*) dhe në Arkivin e drejtorisë së përgjithshme të tapive dhe të kadastrës në Ankara (*Tapu ve Kadastro umum müdürlügünün arşivi = TK.A.*) ruhet një pasuri e madhe burimesh lidhur me krahinat e Shqipërisë veriore nga fundi i shekullit XV dhe gjatë shekullit XVI. Nga këto burime më të rëndësishme janë:

1 — Defteri i hollësishëm (*mufassal*) dhe defteri i përmbledhur (*icmal*) i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës në vitin 1485[3].

2 — Fletët e regjistrimit të hollësishëm dhe të atij të përmbledhur të nahijeve të Pipërit, të Kuçit, të Hotit dhe të Kelmendit në vitin 1497[4].

3) Defteri i timareve të Rumelisë i viteve 1529-36[5].

4) Defteri i hollësishëm i sanxhakut të Shkodrës i vitit 1582[6].

---

1) H.Inalcik, *Suret-i defter-i, sancak-i arvanid*, Ankara 1954.
2) Başvekâlet arşivi, Tapu defterleri, *Defter-i mufassal liva-i Iskenderiye, nr.* 17. Më poshtë do ta citojmë vetëm me emrin: defter.
3) BV.A., Tapu defterleri, *Defter-i liva-i Iskenderiye;* nr.17 dhe nr.26 m.
4) BV.A., Tapu defterleri, *Defter-i liva-i Iskenderiye*, nr.17 shtojca në faqet 189-204; *Defteri liva-i Iskenderiye*, nr.26 m. Shih gjithashtu B.Djurdjev, *Iz istorije Crne Gore, brdskih i malisorskih plemena*, Radovi naučnog društva BiH.II, Sarajevo 1954, f.165-220,
5) BV.A., Tapu defterleri, nr.367.
6) TK.A., defter nr.59.

5) Defteri i hollësishëm i sanxhakut të Dukagjinit i viit 1571[7].

6) Defteri i hollësishëm i sanxhakut të Dukagjinit i vitit 1591[8].

Nga këto, zgjodhëm për botim defterin e hollësishëm të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 jo vetëm për faktin se ai paraqet regjistrimin e parë, të plotë, të kryer pas pushtimit, por edhe për arësyen se krahina e Shkodrës është një nga zonat e pakta në Ballkan, për të cilën kemi një dokument të tillë të rëndësishëm për periudhën para pushtimit osman, siç është *Kadastri venedikas i Shkodrës dhe regjistri i koncesioneve*[9], që sjell të dhëna të hollësishme mbi pronësinë dhe marëdhëniet feudale të sistemit të pronies në shekullin XV. Pra, duke patur për të njejtën zonë dy dokumenta të hartuara për të njejtat qëllime dhe të njëjtit karakter për një periudhë të pandërprerë prej një shekulli krijohet mundësia për të ballafaquar dhe për të krahasuar gjendjen e periudhës së para pushtimit me atë pas pushtimit osman. Kjo lejon të ndriçohen për së afërmi disa aspekte të ndryshimeve që ndodhën me vendosjen e sistemit të timarit si dhe veçoritë e zbatimit të këtij sistemi në kushtet e veçanta të Shqipërisë.

Përveç regjistrimit të vitit 1485, defteri që po botojmë, ka në fund, si shtojcë, regjistrimin e hollësishëm të nahijeve të Pipërit dhe të Kelmendit të bërë në vitin 1497. Siç dihet, regjistrimin e përmbledhur (*icmal*) të këtyre nahijeve si dhe të nahijeve të Kuçit dhe të Hotit në vitin 1497, e ka botuar historiani jugosllav B. Gjurgjev[10]. Po përfshijmë në botim këtë shtojcë, sepse përmban të dhëna me interes për gjendjen dhe lëvizjet e malësorëve të Pipërit dhe Kelmendit, të cilat mungojnë në regjistrimin e përmbledhur.

Njoftimet e defterit në fjalë i përkasin një treve shumë të gjerë, që i kapërxen kufijtë e sanxhakut të Shkodrës. Në vitin 1485 ky sanxhak ndahej në katër kaza: të Shkodrës, të Podgoricës, të Pejës dhe të Bihorit. Kazatë ishin ndarë në njisi më të vogla administrative, në nahije:

*Kazaja e Shkodrës* ndahej në nahijet e Shkodrës, të Drishtit, të Bregut të Këndejmë (Bregu veri-lindor i liqenit të Shkodrës), të Bregut të Përtejmë (Bregu jugë-perendimor i liqenit të Shkodrës), të Krajnës, të Merkodit, të Maleve të Shestanit dhe të Maleve Mjet (zona e Shëngjinit).

*Kazaja e Podgoricës* ndahej në nahijet e Podgoricës, të Zhabjakut, të Kuçit, të Bjelopavliqit (Palabardhit), të Pipërit, të Maleve të Hotit, të tokave të Petrishpanit (tokat e Pjetër Spanit – Pulti i sotëm, Shala, Shoshi, Nikaj-Mërturi) dhe të Kelmendit (pas vitit 1497, kur Kelmendi njohu sundimin osman).

*Kazaja e Pejës* ndahej në nahijet e Pejës, të Altun-ilisë (zona midis Gjakovës-Junikut-Tropojës) dhe të Suhogërlës.

*Kazaja e Bihorit* ndahej në nahijet e Komninit, të Komaranit, të Plavës, dhe të Izlarjekës.[x]

Përveç këtyre, në regjistrim janë përfshirë dhe një pakicë fshatrash nga nahijet e Vuçiternit, të Prishtinës, të Prizrenit, etj., që bënin pjesë në sanxhaqet e Vuçiternit dhe të Prizrenit.

7) BV.A., Tapu defterleri, nr.499.
8) TK.A., defter nr.63.
9) F.Cordignano, *Catasto veneto di Scutari e Registrum Concessionum* 1416-1417, v.I-II, Scutari 1940, Roma 1942; Joseph Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, Tomus VIII, IX, München 1970.
10) B.Djurdjev, *Iz istorije Crne Gore...*, në Radovi naučnog društva BiH. II, Sarajevo 1954 f.165-220.
*) Në Sanxhakun e Shkodrës përveç tokave shqiptare ishin përfshirë edhe toka me popullsi sllave.



**Koha e hartimit të defterit dhe shkruesi.**

Siç thuhet në hyrjen e defterit në fjalë,[11] regjistrimi i tokave në sanxhakun e Shkodrës të krijuar si njësi administrative më vehte pas rënjes së këshjellës së Rozafatit në vitin 1479, u krye nga emini i quajtur Mustafa Saraxheldin dhe nga shkruesi Sulejman Abdullahu. Ai u përfundua në periudhën midis 17 shkurtit dhe 18 marsit të vitit 1485 (në muajin Safer të vitit 890 hixhri).

Të dhëna mbi jetën dhe aktivitetin e dy nëpunësve të lartpërmendur mungojnë krejtësisht si në defter ashtu dhe në materialet e tjera dokumentare. Vetëm për shkruesin Sulejman Abdullahu, dimë se ishte prej robërve të liruar të vezir Mahmut Pashës[12], komandant i shquar i Mehmetit II, i cili, pas dështimit të rrethimit të Krujës në vitin 1467, në krye të një ushtrie turke kishte sulmuar dhe kishte shkretuar qytetin e Shkodrës[13]. Në defter gjenden të dhëna që na krijojnë bindjen se shkruesi duhet të ketë qenë me kombësi sllave. Kështu, kur shënon se kujt i përkisnin bashtinat, ai i ven zakonisht emrat e zotëruesve të tyre në rasën gjindore të serbishtes, p.sh. *baştina Radiç der desti Dabjiva* — bashtina e Radiçit në dorën e Dabzhivit, ose *baştina Ivko der desti Radosava* — bashtina e Ivkos, në dorën e Radosavit[14]. Më bindëse për pikëpamjen tonë janë disa të dhëna të tjera: fshatrat Trushi i madh dhe Trushi i vogël, që në kadastrin e Shkodrës të vitit 1416–17 përmenden me emrat *Trompsi grandi dhe Trompsi pizolj*, i gjejmë të regjistruar në defter me emrat *Dolini Turmshi* dhe *Gorni Turmshi*[15]. Cilësimi i këtyre si «*Dolini*» (i poshtmë) ose «*Gorni*» (i sipërmë) është një emërtim i ringa shkruesi i defterit, sepse është e pamundur që toponimet e lart përmendura të jenë sllavizuar midis viteve 1416-1485 në një periudhë kur në Shkodër prej kohësh nuk ekzistonte më sundimi serb. Të njejtin fenomen kemi dhe në rastin e fshatrave Voronica e sipërme dheVoro nica e poshtme, të cilat shkruesi i përmend me emrat *Gorna Voronica* dhe *Ashaga Voronica*[16]. Pra njerin toponim e sllavizon, kurse tjetrin e turqizon.

Në hyrje të defterit përmendet qyteti i Edernesë si vendi ku ka përfunduar hartimi i këtij dokumenti. Duke u nisur nga praktika e regjistrimeve të tokave gjatë shekullit XV, të cilat zakonisht bëheshin në vend nga ana e në punësve osmanë të kadastrës[17], mendojmë se defteri që kemi në duar nuk është kopja e parë, por një kopje e dytë ose e tretë e hartuar në Ederne pas përfundimit të regjistrimit.

Është e kuptueshme se për krahinat e pushtuara me kohë, si ato të Pejës dhe të Medunit, regjistrimi i vitit 1485 nuk ishte regjistrim i parë. Edhe në defter gjenden argumenta për të vërtetuar këtë mendim. Në disa raste, p.sh. kur është fjala për Pejën ose Medunin, përmendet ekzistenca e defterit të regjistrimit të mëparshëm ose, siç quhet aty, të defterit të vjetër (*defteri-atik*)[18]. Ekzistenca e një defteri të tillë vërtetohet edhe për zonën e Shkodrës nga dy shënime të tjera,

11) defter, f.209.
12) po aty.
13) Për veprimtarinë e Mahmut Pashës shih: Tursun bey, *Tarih-i ebül feth*, në Tarihi osman encümeni mecmuasï (TOEM), nr.23, f.124, nr. 34, f.132, 137.
14) defter, f. 221, 222.
15) J.Valentini, *Acta Albaniae Veneta...*, Tomus VIII, f.315, 353-356; defter, f.152.
16) defter, f. 75, 145-146.
17) H.Inalcik, *Suret-i defteri...*, f.XV.
18) defter, f. 211, 402, 461, 158.

të bëra për fshatin Shënkoll të Tejbunës dhe Prelë të Drishtit[19], si edhe tërthorazi nga shënimet për disa fshatra të nahijes së Shkodrës që cilësohen si të papërfshira në defterin e mëparshëm (*haric ez defter*)[20].

Këto të dhëna na bëjnë të pranojmë se osmanët do të kenë ndërmarrë ndonjë regjistrim në tokat e pushtuara rishtas fill pas rënies së Shkodrës në vitin 1479, të paktën në zonën fushore, së cilës i përkasin shënimet e mësipërme. Fakti që pas një kohe të shkurtër prej 5 vjetësh kryhet në këtë sanxhak një regjistrim ri dhe sidomos që në regjistrimin e vitit 1485 nuk ka ndonjë gjurmë të funksionimit të sistemit të timarit për periudhën 1479-1485, na shtyn të pohojmë se ky regjistrim paraprak nuk duhet t'ia ketë arritur qëllimit të vet dhe ta konsiderojmë regjistrimit e vitit 1485 si regjistrimin e parë, të plotë, të krahinave të sanxhakut të Shkodrës. Sunduesit e rinj nuk ishin në gjendje të arrinin menjëherë, para vitit 1485 në një regjistrim të qëndrueshëm, në një fiksim të hollësishëm të të gjitha detyrimeve të popullsisë si dhe në një ndarje të rregullt të rentës feudale spahijve në formën e timareve, ashtu siç patën arritur në krahinat e Shqipërisë jugore dhe qendrore, të cilat i patën regjistruar menjëherë me vendosjen e administratës osmane, pas pushtimeve të viteve 1417 dhe 1430. Kjo vonesë mendojmë se duhet të jetë shkaktuar nga pozita akoma e pakonsoliduar e pushtetit osman në këtë zonë të sapopushtuar si dhe nga lëvizjet kryengritëse, sidomos nga kryengritja e vitit 1481 e udhëhequr nga Gjon Kastrioti, i biri i Skënderbeut, e cila i detyroi forcat osmane të përqendroheshin kundër saj.

### Ndërtimi i defterit

Defteri që po botojmë është i tipit të defterve të hollësishëm (*mufassal*). Ashtu siç duket në pasqyrën e lëndës së defterit[21], regjistrimi i feudeve nuk është bërë duke mbajtur për bazë njësitë administrative të sanxhakut, por sipas madhësisë së feudeve: në fillim *hasset*, pastaj *ziametet* dhe *timaret*. Së pari janë shënuar hasset perandorake. Ato gjenden vetëm në nahijen e Shkodrës. Pas tyre janë regjistruar hassi i sanxhakbeut, feudi më i madh në sanxhak, si dhe ziametet. Hassi i sanxhakbeut përfshinte fshatra nga nahije të ndryshme, ose nahije të tëra. Këto janë regjistruar në një vend dhe nuk janë dhënë të shpërndara së bashku me timaret, sipas secilës kaza. Ziametet përfshinin krejtësisht një unitet të veçantë krahinor ose një nahije, siç është rasti i ziametit të nahijes së Altun-ilisë ose i ziametit të Mehmetit, të birit të Kasapit në nahijen e Petrishpanit dhe të Bregut të Këndejmë, ose një grup të madh fshatrash të veçantë si p.sh. ziameti i Suhogërlës, i Deçanit etj.

Ndryshe nga hasset dhe ziametet, timaret janë regjistruar me radhë në bazë të njësive administrative. Ato i gjejmë vetëm në kazanë e Pejës, të Shkodrës dhe shumë pak në atë të Podgoricës, meqenëse pjesët e tjera ishin dhënë në zotërim si hasse dhe ziamete. Në fillim janë dhënë timaret e seraskerëve të nahijeve, pastaj të subashëve ose vojvodëve. Timareve të kadijve dhe të dizdarëve nuk u është dhënë ndonjë vend i veçantë.

Shumica e ziameteve dhe të timareve janë formuar prej fshatrash që varen nga e njejta nahije apo kaza. Vetëm një pakicë prej tyre në kazanë e Pejës përfshijnë edhe fshatra jashtë kufijve të sanxhakut, si bie fjala të nahijeve të Prizrenit, të Tërgovishtës, të Vuçiternit dhe të Labit.

Në fund të regjistrimit janë shënuar vojnukët e sanxhakut, të ndarë sipas nahijeve të ndryshme.

Defteri ka madhësinë e zakonshme të defterëve të shekullit të XV, 11:29 cm. Përmban 473 faqe. Faqet nr. 22, 119, 205, 206, 208, 260, 307, 331, 333, 349, 357, 381, janë të pashkruara. Me përjashtim të faqes nr.473, defteri është krejt i padëmtuar. Lidhja origjinale e defterit ka humbur dhe administrata e arkivit i ka bërë një lidhje të re, me kapakë në ngjyrë të zezë, duke vënë numrin rendor për secilën faqe. Por gjatë lidhjes së re kanë gabuar renditjen e faqeve, sepse kanë konsideruar si faqe fillestare jo faqen ku fillon regjistrimi, por një nga faqet e mezit, ku janë shkruar timaret e kazasë së Pejës. Rrjedhimisht pasqyra e lëndës së defterit dhe shënimi hyrës që duhej të ishin në fillim, janë vënë në faqet 207 dhe 209. Duke u mbështetur në rrjeshtimin e materialit në pasqyrën e lëndës f.207), pjesën e përfshirë nga faqet 1-204 e vendosëm në vendin që i përket, pas faqes së fundit nr.473. Kjo përputhet me vetë përmbajtjen e lëndës. Referimet në tekstin tonë i kemi dhënë gjithmonë në bazë të numrave të faqeve në defter.

### Transliterimi, transkribimi dhe përkthimi

Transliterimi dhe përkthimi i materialit të këtij burimi paraqet shumë vështirësi, për arësye se në shkrimin e emrave të kyrefamiljarëve ose të vendeve zakonisht mungojnë shënjat diakritike të osmanishtes, gjë që pengon një lexim krejtësisht të sigurtë. Vështirësi më të madhe kemi ndeshur në leximin e emrave sllavë Për të patur një lexim të saktë të tyre, kemi krahasuar emrat brenda për brenda materialit të defterit ose edhe në materialet e regjistrimeve të tjera të kryera në shekujt XV-XVI. Zakonisht jemi përpjekur që emrat e shkruar me dhjetra herë pa shenjat diakritike t'i gjejmë në ndonjë rast të shkruar plotësisht ose pjesërisht me shenjat diaktritike. Kur këto raste mungojnë, kemi krahasuar të gjitha format dhe kemi dhënë në tekst leximin më të përafërt. Kështu, duke i gjetur në ndonjë rast, qoftë edhe të vetëm, të shkruar me shenjat diakritike kemi evituar leximet e tjera të mundshme të emrave si Plak (f. 166)),Span (f.147), Miokush (f.2), Pepa (f.289), Bjela (f.280, 281), Grubaç (f.30, 427), Zagoraç (f.182), Dejan (f.343), Junak (f.132), Bozha (f.135), Nenada (f.254), Menc (f.213), Noku (f.310), Nosha (f.232), Bubqa (f.218), Prepja (f.277), Prijezda (f.110,449), Bezhan (f.468), Prebil (f.30), Peja (f.83, 345), Menku (f.358), Bosa (f.407,) Brata (f.298).

Në rastet kur leximet nuk janë të sigurta, kemi dhënë në shënim leximet e mundshme, kurse në tekstin e origjinalit dhe të përkthimit kemi dhënë atë formë që ndeshim në raste të tjera në këtë burim ose në burime të të njëjtit karakter. Kështu, disa emra të shënuar pa shenja diakritike mund të lexohen në disa forma, si p.sh. Brajan ( بريان ), mund të lexohet edhe Bratan ose Treban. Këtë e kemi dhënë në tekst në formën Brajan. Emri Nenko ( ننقو ) mund të lexohet edhe Petko, Niko, Niku, por në tekste e kemi dhënë Nenko dhe Petko, sepse në këto forma i gjejmë të shënuar më shpesh në këtë burim ose në burime të tjera. Në raste të tilla kur një emër i shkruar pa shenjat diakritike ka dy lexime të sigurta, është e pamundur të përcaktohet se cili emër ka qenë më i përdorur se tjetri. Në të njejtën mënyrë kemi vepruar edhe në rastet kur emrat janë shënuar pjesërisht me shenjat diakritike, siç është rasti i emrit Prepjaç ( پرساچ ) që mund të lexohet edhe Prijaç, Pribaç, Pritaç.

19) defter, f.161, 167.
20) defter, f. 160.161.
21) defter, f.207.

Përkthimi i materialit të këtij burimi është në fakt transkribim, meqenëse pjesa më e madhe e tij përbëhet nga emrat e kryefamiljarëve dhe të vendeve. Shtesat që vijnë si nevojë e përkthimit shqip, në botim i kemi dhënë me germa më të zeza me qëllim që të dallohet forma e origjinalit. Kështu p.sh. origjinali Gön veledi Şuk– كون ولد شوك në përkthim është dhënë: Gjoni, i biri i Shukut. Në rastet kur emrat e dytë në shqip pësojnë ndryshime për shkak të rasës, kemi dhënë në kllapa formën e origjinalit vetëm kur ato ndeshen për herën e parë. P.sh.; Gön veledi Papa – në përkthim është dhënë – Gjoni, i biri i Papës (Papa). Kjo mënyrë e lejon lexuesin të dallojë ato emra që në origjinal janë dhënë në trajtën e shquar me nyjet e shqipes. E pamundur është shquarja në transkribim i bashkëtingëllores *s* nga *sh*, i *d* nga *dh*, kur nuk janë shënuar shenjat diakritike, ose i *l* nga *ll*, i *u* nga *o*. Kështu emri Lazar mund të ketë qenë Llazar, ose Lesh mund të ketë qenë Llesh etj.

Me shënimet përgjithësisht kemi synuar të japim saktësimet në transliterimin dhe përkthimin e materialit. Ato i kemi vënë në vendin ku është paraqitur nevoja për herë të parë.

Për çdo feud kemi vënë numur rendor, kurse numrin e faqeve të origjinalit e kemi dhënë anash faqeve të përkthimit, duke e shënuar në kllapa. Shtesat e bëra në përkthim i kemi dhënë brenda kllapave [ .....], kurse shënimet që gjenden në origjinal i kemi dalluar në përkthim, duke shkruar anash [sh–]. Në tekst kemi përdorur edhe kllapat e rrumbullakta kur japim përkthimin e një termi ose termin në gjuhën e origjinalit si shpjegim për përkthimin, ose kur japim një lexim tjetër të mundshëm për një emër. Fshatrat që mundëm t'i identifikojmë me fshatrat e sotëm, i kemi dalluar, duke shënuar sipër, përbri tyre, shenjën x ose duke vënë shënime.

**Vlera e defterit si burim historik**

Defteri që po botojmë është një burim historik me vlerë, sepse me të dhënat që sjell, duke plotësuar burime të tjera, hedh dritë mbi gjendjen ekonomiko-shoqërore e politike të Shqipërisë së Veriut në fund të shekullit XV; ai jep mundësi të nxirret në shesh politika e sunduesve të rinj ndaj shtresave të ndryshme të shoqërisë shqiptare fill pas pushtimit të vendit dhe të përcaktohet shkalla e zbatimit të sistemit të timarit si dhe pozita e banorëve të krahinave të brendshme malore, për të cilat mungojnë krejtësisht ose për një pjesë të madhe njoftimet nga burimet e tjera. Për më tej, të dhënat e defterit lejojnë të nxirren konkluzione edhe për gjendjen e këtyre krahinave para pushtimit osman.

Të rëndësishme janë edhe të dhënat onomastike, të cilat kanë vlerë për historinë e gjuhës shqipe, dhe japin njëkohësisht mundësi të nxirren përfundime interesante mbi anën etnike, veçanërisht mbi gjendjen e elementit shqiptar në krahinat skajore të sanxhakut të Shkodrës gjatë fundit të shekullit XV.

Krahas këtyre anëve pozitive, burimi në fjalë ka edhe disa kufizime, Njoftimet e tij janë dhënë shumë shkurt, pa shpjegime, komente ose shënime anësore që shpesh i gjejmë në burimet e këtij lloji. Defteri paraqet një kuadër të marrë në një moment të caktuar dhe nuk tregon zhvillimin e mëvonshëm të gjendjes. Prandaj, për t'i kuptuar të dhënat e tij sa më drejtë dhe për të parë sa u zbatua sistemi i timarit, duhet t'i krahasojmë patjetër jo vetëm me të dhënat e defterëve të tjerë dhe të kanunnameve të shekujve XV e XVI për këtë trevë, por edhe me ato të burimeve të të njëjtit karakter për periudhën para pushtimit osman. Gjatë studimit duhet patur parasysh edhe fakti se defteri është i hartuar nga ana e administratës së sunduesve osmanë, ndonëse ndikimi i këtij faktori në të tilla burime



është shumë më i pakët se në burimet tregimtare ose në ato dokumentare të llojeve të tjera.

Me gjithë këto kufizime, të dhënat e defterit na lejojnë të trajtojmë hollësisht disa çeshtje me interes shkencor, qoftë të karakterit social-ekonomik, qoftë të karakterit etnik.

## I. NDARJA E TOKAVE DHE E TË ARDHURAVE NË TIMARE; QËNDRIMI I QEVERITARËVE OSMANË KUNDREJT KLASËS FEUDALE VENDASE[22].

Të dhënat e defterit të hollësishëm të regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës në vitin 1485 pasqyrojnë zbatimin e parimit se toka dhe të ardhurat e saj, me pushtimin, bëheshin pronë e klasës feudale osmane, duke ju ndarë pjestarëve të saj në formë timaresh, ziametesh, hassesh, dhe njëkohësisht lejojnë të gjykohet mbi politikën që ndoqën qeveritarët osmanë kundrejt klasës feudale vendase.

Në sanxhakun e Shkodrës në vitin 1485 ishin krijuar 120 feude, duke përfshirë këtu timaret, ziametet dhe hasset. Të ardhurat nga doganat mbi lumejt e Bunës dhe të Drinit, nga monopoli i kripës në vilajetet e Shkodrës dhe të Lezhës, nga peshkimi në liqen etj. gjithsej 231.758 akçe, ishin caktuar si hass i sulltanit[23]. Feudi më i madh i sanxhakut ishte hassi i sanxhakbeut, Nasuh beut[24]. Në të ishin përfshirë të ardhurat e qyteteve të Shkodrës, të Drishtit, të Pejës, detyrimet e të gjithë fshatrave të nahijeve të Pipërit, të Kuçit, të Bjelopavliqit, të Hotit, të Plavës, të Shestanit, të Merkodit, të Krajnës, të Komninit, të Komaranit. Izlarjekës dhe të një numri fshatrash nga nahijet e Pejës, të Podgoricës dhe të të Bregut të Përtejmë. Gjithsej ai përfshinte 161 fshatra dhe kishte 389.912 akçe të ardhura [25].

Përveç hasseve, të ardhurat e tjera që nxirreshin nga fshatarësia ishin ndarë në timare dhe ziamete si më poshtë.

| Kazatë | Sasia e hasseve | Sasia e ziameteve | Sasia e timareve | Nga këto: [26] | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Timare në zotërim të spahijve myslimanë | Timare në zotërim të spahijve të krishterë |
| Peja | dy hasse | një ziamet | 75 | 62 | 13 |
| Shkodra | | | 32 | 26 | 3 |
| Podgorica | | | 3 | 2 | — |
| Bihori | | | — | — | — |
| gjithsej: | 2 | 8 | 110 | 90 | 16 |

22) Problemet e karakterit social-ekonomik i kemi trajtuar hollësisht në artikullin *Krahinat perëndimore dhe qendrore të sanxhakut të Shkodrës, në fund të shekullit XV*, I dhe II, në Studime historike nr.2, 3, 1971, f. 43-73 dhe f. 115-138.
23) defter, f.120.
24) defter, f.236.
25) defter, f. 210-330
26) Për katër timare nuk janë shënuar emrat e zotëruesve, prandaj nuk mund të përcaktohet në se zotëroheshin prej spahijve myslimanë ose prej spahijve të krishterë.

Siç vërehet në këtë pasqyrë, sasia e feudeve të krijuara në sanxhakun e Shkodrës më 1485 është e pakët. Shumica e tyre gjendeshin në kazanë e Pejës të pushtuar me kohë. Kjo dëshmon se atje sistemi i timarit kishte bërë hapa përpara në vendosjen e tij të plotë. Shumë më i pakët është numri i feudeve në kazatë e Shkodrës dhe të Podgoricës, po të kihet parasysh teritori i gjerë i këtyre krahinave. Sasia prej 35 timaresh dhe 1 ziameti që formoheshin me të ardhurat e vjela nga fshatarësia e krahinave në fjalë, tregon se sistemi i timarit nuk kishte fituar një shtrirje të gjerë.

Për këtë dëshmon gjithashtu fakti se zonat malore të krahinës së Shkodrës dhe të Podgoricës nuk ishin vënë nën pushtetin dhe qeverisjen e spahijve, përfaqësuesve direktë të administratës osmane në tokat e timareve të tyre. Viset malore si Plava, Kuçi, Bjelopavliqi, Hoti, Pipëri, Shestani, Merkodi dhe Krajna ishin përfshirë në hassin e sanxhakbeut[27], kurse Pulti i sotëm, Shala, Shoshi, Nikaj-Merturi (*P.trishpan ili*), si një unitet më vehte, bënin pjesë në ziametin e Mehbeut, të birit të Kasapit[28].

Moszbatimi në thellësi i sistemit të timarit dëshmohet edhe nga pesha e pakët që zinin të ardhurat e shpërndara si timare, në shumën e përgjithshme të të ardhurave nga detyrimet që jepte fshatarësia. Timaret nuk përfshinin më shumë se 167.450 akçe, dmth 1/4 e sasisë së përgjithshme të rentës, kurse hassi i sanxhakbeut dhe ziameti i Mehmet beut kishin 450.315 akçe të ardhura, dmth afro 3/4 e sasisë së përgjithshme të detyrimeve, sasi që afërsisht arrinte në 617.765 akçe[29].

Sunduesit osmanë e kishin të vështirë të zbatonin sistemin e timarit në malësitë, sepse një gjë të tillë nuk e lejonin disa faktorë si niveli i ulët i zhvillimit të marrëdhënieve feudale, që lidhej me karakterin malor të vendit dhe mungesën e tokave të punueshme, qendresa e malësorëve kundër pushtimit etj. Këtu osmanët u gjendën para disa kushteve të veçanta: diferencimi ekonomik shumë i pakët në gjirin e shoqërisë malore, mungesa e një klase feudale të brendshme në kuptimin e plotë të fjalës, nuk u jepte atyre mundësi të krijonin një mbështetje shoqërore, duke gëlltitur në klasën sunduese osmane elementë feudalë vendës, siç patën vepruar gjetkë nëpërmjet institucioneve të tyre feudale. Për shkak të organizimit shoqëror mbi bazën e fisit ose katunit, dhe të mbisundimit të pronësisë së përbashkët të tokës, osmanët ishin të detyruar të mospraktikonin ndarjen e tokave me tapi dhe, për rrjedhim, të linin në fuqi pagimin e detyrimeve në formë të prerë. Renta mbeti përsëri në formën e një rente shtetrore, fikse, por që tashmë ndryshoi emrin duke u quajtur hass. Zotërues i saj u bë kryesisht sanxhakbeu, përfaqësuesi i pushtetit qendror, në vend të kryezotëve feudale të mëparshëm, Spanëve dhe Dushmanëve.

Moszbatimi i normave të zakonëshme të timarit, që rridhnin nga vënia në jetë e parimit të pronës mirie, si në drejtim të rentës feudale ashtu dhe në drejtim të vartësisë të fshatarve ndaj spahijve, ruajtja e pandryshuar e gjendjes së parapushtimit, na bindin se cilësimi i rentes së malësorëve si hass, feud karakteristik

27) defter, f.266-286 (Plava), 295-299 (Kuçi), 300-302 (Bjelopavliqi), 303-306 (Hoti), 308-313 (Pipëri), 321-324 (Shestani), 325-327 (Merkodi), 328-330 (Krajna).
28) defter, f. 334-350.
29) Kjo shumë përfshin vetëm të ardhurat nga detyrimet që nxirreshin prej popullsisë së kazave të Shkodrës dhe të Podgoricës, pa të ardhurat e hasseve perandorake nga doganat, peshkimi, monopoli i kripës etj.



për sistemin e timarit, nuk do të thotë se ky sistem u zbatua me të vërtetë në malësitë. Ndryshe nga rastet e zakonshme, hassi i këtushëm ishte vetëm një riemërtim i rentes feudale të mëparshme të malësorëve. Në këto kushte, kur renta ishte një rentë qendrore në dobi të kryezotit ose të sundimtarit të ri osman, dhe masa e malësorëve, të organizuar në bashkësi dhe katune,i nënshtrohej një shfrytëzimi nga jashtë, vendosja e normave të timarit ishte në fakt shumë e vështirë. Një veprim i tillë, po të bëhej, do ta forconte më tepër luftën e malësorëve kundër sunduesve të huaj, shfrytëzues të rinj më energjikë.

Nga ana tjetër diferenca e madhe midis të ardhurave të pakta në dobi të timarlijve dhe të ardhurave të shumta në dobi të zotëruesve të ziameteve dhe hasseve, dëshmon për faktin se klasa feudale ishte e kufizuar në numur për shkak të diferencimit të pakët brenda gjirit të shoqërisë. Ajo ishte ende e pazhvilluar në një shkallë të lartë, prandaj dhe pushteti osman në këtë fazë mbështetej më tepër tek oligarkia feudale, zotëruese e feudeve të mëdha, tek forca ushtarake e saj, se sa tek spahijtë, ende të pakët në numur.

Defteri i sanxhakut të Shkodrës, meqenëse pasqyron regjistrimin e parë e të plotë për zonën e Shkodrës, na jep mundësi të nxjerrim të dhëna me interes për politikën që ndoqën osmanët kundrejt klasës feudale vendase. Sipas tyre numri i feudalëve vendës të përfshirë në kuadrot e timareve si spahij të krishterë ishte shumë i vogël. Nga 35 timare që ishin krijuar në krahinat e Shkodrës dhe të Podgoricës, 3 timare u ishin dhënë në zotërim spahijve të krishterë vendës[30] dhe 8 timare të tjerë u ishin dhënë në zotërim spahijve myslimanë me origjinë shqiptare[31].

Numri i pakët i elementëve me origjinë vëndase, të integruar në klasën sunduese osmane të krahinës së Shkodrës, dëshmon qartë për xhveshjen thuajse të plotë të klasës feudale vendase nga e drejta e zotërimit të tokave të dhëna si pronie, ose nga e drejta e pronësisë së plotë që kishte pasur para pushtimit. Futja në kuadrot e timareve e rreth 11 feudalëve vendës si spahij të krishterë ose si spahij të myslimanizuar, dëshmon për eleminimin e klasës feudale vendëse si një forcë e pavarur ekonomike, politike dhe ushtarake. Ky konstatim vlen edhe sikur në radhët e spahijve myslimanë, për të cilët në defter nuk jepen cilësime

30) Këto janë:
a) Timari i Radiçit, i biri i Hraboviqit, në fshatin Oblik.
b) Timari i Rajkos, në fshatin Kadrun (Kalldrun).
c) Timari i Vukosavit i biri i Gjurashit, në fshatin Goriçani.

31) Këto janë:
a) Timari i Hasan Marinit, në fshatrat Marin, Stasaliq, Bushat, Kresht, Samrisht, Vranina, Vasojeviq, Krabzha, Shkozha, Zhaborova, Vranja.
b) Timari i Iljas Murës, në fshatrat Pulç dhe Egjrish.
c) Timari i Hasan Shqiptarit, në fshatin Tuz.
ç) Timari i Hamza Dibrit, në fshatin Rasa.
d) Timari i Sulejman Matjes si dhe i disa spahijve të tjerë myslimanë, në fshatrat Zhajna dhe Lepurosh.
dh) Timari i Mukbil Shqiptarit, në fshatin Mazarak.
e) Timari i përbashkët i Ahmet Radomirit, i Karagjoz Murës dhe Pir Aliut të birit të Kolës, në fshatrat Gradisaliq, Rosek, Bulkija dhe Kastrat.
ë) Timari i përbashkët i Hasanit i biri i Kolës, i Iljas Klinës, i Ukç Bolit dhe i disa spahijve të tjerë myslimanë, në fshatrat Prelat, Bukmira dhe Dom.
Shih defter f.133-6, 138-9, 164-5, 168-9, 169-70, 170-1, 173-5.

lidhur me prejardhjen e tyre[32], të ketë patur spahij me origjinë nga klasa feudale vendëse e viseve të pushtuara para rënies së Shkodrës dhe të nënshtruara islamizmit prej kohësh. Dokumentacioni perendimor sjell mjaft fakte që tregojnë se ajo pjesë e klasës feudale që i shpëtoi zhdukjes gjatë luftimeve në rrethimin e Shkodrës dhe të Drishtit, kishte emigruar me shumicë në Venedik së bashku me një sasi qytetarësh dhe fshatarësh. Kështu p.sh. senati i Venedikut urdhëronte më 5 qershor dhe 23 korrik 1479 rregullimin me punë të 30 fisnikëve të krahinës së Shkodrës, ish provizionatë të Venedikut[33], dhënien e beneficieve si dhe vendosjen e tyre me banim në disa toka të caktuara[34]. Midis të emigruarve përmenden edhe familjet e njohura feudale Moneta, Humoj, Ungri nga Drishti, Kojko Spano dhe Stefan Jonima nga Shkodra[35] etj.

Përveç numërit të pakët të spahijve me prejardhje nga krahina e Shkodrës, edhe pjesa shumë e vogël e rentes feudale që ata vilnin në dobi të vet, në krahasim me sasinë e përgjithshme të rentës që vilej nga fshatarësia, dëshmon për një përmbysje që nga themeli të pushtetit ekonomik dhe të epërsisë së klasës feudale vendase. Me përjashtim të dy feudeve, të timarit të Rajkos me 15.872 akçe të ardhura dhe të timarit të Hasan Marinit me 10.319 akçe, timaret e tjera në zotërim të spahijve të krishterë dhe të spahijve myslimanë me origjinë vendase kishin të ardhura të pakta që lëviznin nga 1476 deri në 3000 akçe. Akoma më pak të ardhura kishin spahijtë e myslimanizuar vendës që ishin pjestarë në zotërimin e timareve të përbashkëta (*müşterek*), siç është p.sh. rasti i timareve të mbrojtësve të kalasës së Drishtit.

Me një fjalë, sasia e rentës në dobi të elementëve të klasës feudale vendase, të përfshirë në klasën sunduese osmane, siç del nga mbledhja e të ardhurave të feudeve të tyre, nuk e kalonte shumën e 54.580 akçeve, dmth nuk ishte baras as me të ardhurat që kishte vetëm një ziamet, siç ishte p.sh. ziameti i Mehmet beut. Në krahasim me të ardhurat e hassit të sanxhakbeut, sasia që përvehtësonin spahijtë e krishterë (gjithsej 20.048 akçe) ishte afërsisht 18 herë më e vogël, kurse sasia e përbashkët e të ardhurave të spahijve të krishterë dhe të spahijve myslimanë me origjinë shqiptare ishte 7 herë më e vogël. Të ardhurat e këtyre elementëve përfaqësonin në fakt afro një të njëmbëdhjetën pjesë të gjithë rentes feudale (gjithsej 617.765 akçe) që nxirrej nga popullsia e krahinave të përfshira në kazatë e Shkodrës dhe të Podgoricës.

Në krahinën e Shkodrës, ndryshe nga krahinat shqiptare të përfshira në Sanxhakun shqiptar, qeveritarët osmanë nuk përdorën gjerësisht ato rrugë dhe forma të zakonshme e të njohura për të neutralizuar dhe për të gëlltitur një pjesë të klasës feudale vendase në klasën sunduese osmane, siç ishin p.sh. *institucioni i spahijve të krishterë, sistemi* i *gulamit, i içoglanëve* etj. Këtë politikë ata nuk e ndoqën jo sepse në krahinat e Shkodrës kishte munguar qëndresa, e cila i de-

32) Në praktikën e regjistrimit në shekullin XV, sidomos në defterin e sanxhakut shqiptar, zakonisht jepet nga një cilësim lidhur me origjinën e çdo spahiu. Një fenomen i tillë vërehet pak a shumë edhe në defterin e sanxhkut të Shkodrës. Kështu p.sh. gjejmë këtu të përmendur spahijtë Hasan Shqiptari, Mukbil shqiptari, Hasan Marini nga fshati Marin i Shkodrës, ose Hamzai nga Selaniku etj. (defter f.164-165, 176, 133-136, 129-131). Fakte të tilla na krijojnë bindjen se spahijtë e tjerë myslimanë nuk duhet të jenë me origjinë shqiptare. Megjithkëtë, meqë në defter nuk kemi cilësime të tilla për çdo spahi mysliman, nuk mund të përjashtohet mundësia që edhe të tjerë prej tyre të jenë me origjinë vendase nga krahinat që i ishin nënshtruar me kohë sundimit osman dhe procesit të islamizimit.

33) I.Zamputi, *Dokumenta të shekullit XV për historinë e Shqipërisë, Tiranë*, 1967, dok. nr.21.

34) I.Zamputi, v.p. , dok. nr.31.

35) I.Zamputi, v.p., dok. nr. 35, 54, 57, 120.



tyronte osmanët të krijonin një mbështetje shoqërore më të gjerë për t'ia kundërvënë, por për shkak të disa kushteve historike të veçanta në të cilat ato gjendeshin në shekullin XV. Fakti se këto krahina ndodheshin më parë nën sundimin venedikas dhe nuk kishin qëndruar për ndonjë periudhë të gjatë nën vasalitetin osman, kishte bërë praktikisht të pamundur përdorimin e formave të tilla kalimtare siç ishin institucionet e gulamëve dhe të içoglanëve, të cilat u zbatuan gjerësisht në një fazë të parë në tokat e Shqipërisë qendrore dhe jugore, të përfshira në Sanxhakun shqiptar. Po kështu, eliminimi i një pjese të klasës feudale vendase gjatë luftimeve, mërgimi i shumicës së atyre që shpëtuan, ruajtja e vëllazërive, fiseve, katuneve edhe në fshatrat e fushës, nuk u jepnin mundësi sunduesve të rinj që të zbatonin me rezultat më të mirë institucionin e spahijve të krishterë.

Pra, ndryshe nga pushtuesit venedikas, të cilët kur vunë nën sundim krahinën e Shkodrës, nuk e zhdukën klasën feudale vendase si forcë ekonomike dhe politike, por u njohën pozitat feudalëve vendës dhe i vunë në shërbim të tyre, duke u lënë proniet që ata kishin në zotërim qysh më parë, ose duke u dhënë pronie të reja, pushtuesit osmanë nëpërmjet luftës e dhunës e përmbysën pushtetin e klasës feudale vendase dhe e zhdukën ata si forcë politike dhe ekonomike të pavarur. Ndryshe nga viset e tjera të Shqipërisë qendrore dhe jugore, këtu, veçanërisht në gjysmën e II të shekullit XV, klasa feudale vendase ju kundërvu pushtuesit të ri, thuajse krejtësisht pa u përçarë nëpërmjet formave dhe institucioneve feudale të tij.

Ndërsa kundrejt klasës feudale mbajtën një qëndrim të tillë, ndaj fshatarësisë sunduesit osmanë qenë të shtërnguar në periudhën e parë të pushtimit të mbanin një qëndrim më të matur dhe të diferencuar, jo vetëm për zonat malore në krahasim me zonat fushore, por edhe brenda për brenda zonave fushore. Ata ishin të detyruar të merrnin parasysh si nivelin e ulët të zhvillimit të procesit të feudalizmit në këtë zonë ashtu dhe mundësinë e forcimit dhe të ngritjes në një shkallë më të lartë të qendresës së fshatarësisë, në rast se aty do të imponohej menjëherë sistemi i timarit në vend të formës së mëparshme të pronësisë dhe të marrëdhënieve feudale. Ky qëndrim ishte në të vërtetë një formë e politikës elastike të osmanëve, përshtatur kushteve lokale, për të arritur doradorës dhe pa shkaktuar një kundërshtim të fortë, vendosjen e detyrimeve karakteristike të sistemit të timarit.

## II. RENTA FEUDALE QË ISHTE DETYRUAR TË JEPTE FSHATARËSIA SHKALLA E ZBATIMIT TË SISTEMIT TË TIMARIT NË KRAHINAT E SANXHAKUT TË SHKODRËS

Defteri që po botojmë na jep një panoramë mjaft të qartë mbi shkallën e zbatimit të sistemit të timarit në krahinat e sanxhakut të Shkodrës. Numri i madh i feudeve të krijuara në krahinat e kazave të Pejës (Peja, Altunilia, Suhogërla) dëshmon se aty ishte zbatuar gjerësisht sistemi i ri osman. Kjo ishte bërë e mundshme si nga niveli mjaft i lartë i zhvillimit të marëdhënieve feudale në këtë zonë, ashtu edhe nga fakti se ato kishin kohë që qenë pushtuar prej osmanëve. Në viset e tjera të kazave të Shkodrës, të Podgoricës dhe të Bihorit, të përfshira kryesisht në hassin e sanxhakbeut dhe në një pakicë timaresh, ishin zbatuar vetëm pjesërisht normat e përgjithshme të sistemit të timareve, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me rentën feudale. Aty ishin lënë në jetë një pjesë e normave feudale që ishin në zbatim para pushtimit osman. Ky fakt ka sjellë si pasojë që të dhënat

e defterit të vlejnë edhe për zbulimin e gjendjes së fshtarësisë në periudhën e para pushtimit osman. Për këtë arësye ne e kemi pëqëndruar vemendjen në studimin e rentës feudale dhe të gjendjes në fazën e parë të pushtimit, në krahinat e kazave të Shkodrës dhe të Podgoricës. Le t'i shohim këto më për së afërmi:

Në krahinat qendrore dhe perendimore të sanxhakut të Shkodrës sistemi i timarit pati një zbatim të cekët; ai ishte shtrirë vetëm në një pjesë të ngushtë të fushës së Shkodrës. Për këtë dëshmon jo vetëm numëri i vogël i timareve të krijuara aty në vitin 1485, por, në radhë të parë, vetë renta feudale që nxirrej nga fshatarësia e krahinave në fjalë; kjo rentë për shumicën e fshatrave, qoftë malore ose fushore, nuk arrinte madhësinë e rentës që vilej në bazë të sistemit të timarit, nuk ishte renta karakteristike që jepnin rajatë, ndonëse të ardhurat që rezultonin prej saj u ishin ndarë spahijve në formën e timareve. Sipas dëshmive të defterit që po botojmë, dallojmë në krahinat e lartpërmendura tri zona kryesore, në të cilat renta feudale vilej në sasi dhe në forma të ndryshme:

a) zona e parë përbëhej nga ato fshatra të kazasë së Shkodrës të cilat ju ishin dhënë në zotërim spahijve, duke vendosur aty të gjitha detyrimet e zakonshme të rajave.

b) Zona e dytë nga ato fshatra, që ju ishin dhënë në zotërim spahijve, porse e jepnin rentën feudale jo në formën e detyrimeve të zakonshme të sistemit të timarit, por në bazë të detyrimeve që ekzistonin aty qysh para pushtimit, me larjen e *dukatit*, të *modit* e *obrokut*.

c) Zona e tretë përbëhej kryesisht nga fshatrat e malësive, ku nuk u vendosën detyrimet karakteristike për sistemin e timarit, por mbeti në fuqi renta e mëparsh me. Këto fshatra e njohën pushtetin osman, duke paguar renten në formën e dukatit një dukat për çdo shtëpi, ose, siç quhej tani , një *flori*. Fshatrat e kësaj zone formuan një unitet, meqenëse shumica e tyre i qe dhënë bashkërisht në zotërim si hass sanxhakbeut të Shkodrës dhe nuk ishin ndarë në timare[36].

a) **Zona e vendosur nën sistemin e timarit**. Të dhënat e burimit në fjalë tregojnë se detyrimet karakteristike për rajatë, ishin vendosur në një pjesë të fshatrave të nahijeve të Shkodrës, të Bregut të Këndejmë dhe një pakicë fshatrash të nahijeve të Drishtit, të Zhabjakut, të Krajnës dhe të Mërkodit[37].

36) Fshtrat që përbënin këto tri zona nuk janë regjistruar në defter veças dhe të ndarë nga njeri tjetri, por janë të përzier njeri me tjetrin sipas timareve. Kështu p.sh. në një timar përfshihen fshatra që paguanin rentën karakteristike për sistemin e timarit si dhe fshatra që paguanin rentën në formën e detyrimeve që ekzistonin aty para pushtimit osman. Kjo na ka detyruar të bëjmë një rigrupim të fshatrave, sipas formave të shlyerjes së rentës.

37) Në një gjendje të tillë ndodheshin fshatrat e poshtëshënuara: *në nahijen e Shkodrës:* Koplik (f.123-4), Mes (f.124-5), Shkripol (f.125-6), Egjrish (f.126,139), Shëndbifish (f.127), Reç (127), Romishtina (f.128), Kurta (f.129-130), Balec (f.130), Mosili (f. 130), Xhovan (f.130.131), Gril (f.132), Marshejn (f.132,133), Marin (f.133-4), Nikshiq (f.137.8), Pulç (f.138.142), Kadrun (f.139-140), Mgulshi (f.141-142), Dobranic (f.142), Gradec Tuz (f.143.4), Kosmaç (f.144), Kuruemira (f.145), Gorna Voronica (f.145-6), Gjerxh (f.147), Rjolli (f.149), Kuç (f.152-3), Poshtërkuza (f. 153), Bratorat (f.154), Dobri (f.154), Podgora (f.155), Bishtrjolla (f.156), Prela (f.167-8), Karpent (f.168), Rasa (f.168-9), Rash (f.14), Zhajna (f.169), Lepurosh (f.170), Gradisaliq (f.171-2), Rosek (f.171), Grizha (f.172-3), Prelat (f.173-4), Podol Tuz (f.175-6), Mazurak (f.176), Lushta (f.345-6), Dragovol (f.346), Shënd Ivrazh (f.347), Ashaga Voronica (f.75), Luk (f.32), Ivrashtraketa (f.13).
*në nahijen e Drishtit:* Shëngjin (f.166), Vilza (f.167), Dom (f.175).
*në nahijen e Krajnës:* Krajna (f.328-330).
*në nahijen e Mërkodit:* Mërkojeviq (f.325-327).
*në nahijen e Bregut të Këndejmë:* Damnic Tuz (f.341), Bgur Tuz (f.341-2), Kuqik Tuz (f, 342-3), Istulush Tuz (f.343), Petrosani Tuz (f.343-4).
*në nahijen e Zhabjakut*: Dajbaba (f.128), Tuz (f.164-5), Shukoviq Tuz (f.156-7).



Në defterin në fjalë për këto fshatra janë regjistruar një e nga një të gjitha detyrimet që duhet të paguanin fshatarët. Llogaritjet e detyrimeve janë bërë në bazë të sasive të vatrave (*hane*) të çdo fshati. Sipas tyre kuptohet se *ispenxhja*, që është taksa kryesore ndër detyrimet që fshatari duhej t'i jepte spahiut si zotërues i rajasë (*sahibi raiyet*), vilej në një sasi prej 25 akçesh për çdo vatër. Nënkuptohet se këtu është fjala për çdo kryefamiljar, sepse veças gjejmë të regjistruar edhe detyrimin e ispenxhes që jepnin fshatarët beqarë, të cilët kishin arritur moshën e pjekurisë (*mücerred*) si dhe gratë e veja (*bive*). Nga zbërthimi i llogaritjeve del se ndryshe nga sanxhaku shqiptar në gjysmën e parë të shekullit XV, ku beqarët zakonisht nuk ishin ngarkuar me këtë detyrim, në sanxhakun e Shkodrës ata ishin të detyruar të paguanin nga 25 akçe si ispenxhe, kurse të vejat nga 6 akçe. Përveç ispenxhes, në defter është regjistruar edhe e dhjeta (*öşür*) e prodhimeve bujqësore, që kishte të drejtë të vilte spahiu si zotërues i tokës (*sahibi arz*). Kështu është regjistruar e dhjeta e grurit, e elbit, e thekrit, e tërshërës, e linit, e mushtit, e bathëve, e thjerzave, e perimeve, e bletëve, e ullijve, e fiqve, si dhe e dhjeta e peshkut të gjuajtur. Si detyrim i së dhjetës janë shënuar edhe taksa e kullotës (*resmi giyah*), taksa e druve (*resmi hizem*), taksa e govatës (*resmi tekne*). Në dobi të spahijve janë llogaritur gjithashtu taksat e *nijabetit*, taksa e *martesës* (*resmi gerdek*), *badihavat* e tjera, si dhe *bidati i derrave*.

b) **Zona e fshatrave që e jepnin renten në format që ekzistonin para pushtimit, pa ju nënshtruar detyrimeve të zakonshme të rajave** Në fund të shekullit XV një numër i madh fshatrash në pjesën fushore në jugë të qytetit të Shkodrës dhe në zonën e Zhabjakut, nuk iu nënshtruan plotësisht detyrimeve të zakonshme të sistemit të timarit dhe vazhduan të shlyenin rentën feudale në madhësinë, në format e mëparshme, ndonëse në to ishin vendosur spahijtë. Në fakt tokat e këtyre fshatrave ishin shpallur tokë shtetërore -*mirie* dhe drejta e zotërimit të tyre ju ishte dhënë spahijve. Me një veprim të tillë, osmanët sillnin për këto fshatra vetëm një ndrim të kryezotit feudal si dhe një zëvendësim të proniarëve me spahijtë, pa shkaktuar gjatë kësaj faze fillestare ndonjë ndryshim thelbësor përsa i përket rentës, në krahasim me gjendjen e para pushtimit, kur e drejta e disponimit të tokave i përkiste kryezotit-Balshajve dhe më vonë shtetit të Venedikut, ndërsa e drejta e zotërimit u përkiste proniarëve vendës. Fshatarësia vazhdoi të ruante të drejtën e përdorimit dhe të shfrytëzimit të tokës. I vetmi ndryshim që solli pushtimi osman në këtë fazë të parë, ishte vendosja e së drejtës së tapisë në favor të spahijve. Ndonëse kjo normë e re ishte një hap përpara drejt zbatimit të sistemit të timarit, mbetej ende pa u zbatuar një nga aspektet kryesore të këtij sistemi, siç ishte ngarkimi i popullsisë me renten feudale, me detyrimet ekonomike dhe jo ekonomike që spahiu kishte të drejtë t'i vilte për vete si zotërues i tokës dhe si zotërues i rajave të regjistruar në defter për timarin e tij. Siç shihet qartë në defterin e hollësishëm të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, këto fshatra e paguanin renten feudale në mënyrë globale (të prerë, të caktuar qysh më parë). Në defter janë regjistruar për çdo fshat vetëm numri i vatrave dhe sasia e rentes e shprehur në akçe.

Fshatra që ju nënshtruan pagesës së rentës në formë globale ndeshen në nahijen e Shkodrës, veçanërisht zona e Tejbunës, Shkreli, Kastrati, në nahijen e Zhabjakut pothuajse shumica e fshatrave si dhe disa fshatra të nahijes së Petrishpanit, që iu ishin dhënë në zotërim spahijve etj.[38]

38) Në një gjendje të tillë ishin fshatrat e poshtëshënuara:
*në nahijen e Shkodrës* – Kryethi (f.125), Shkrel (f.129,142), Maliç (f.129), Mushani (f.131).

Më 29.X.1486 (evaili Zilkade 891 h.) një pjesë e fshatrave të kësaj kategorie u hoqën nga zotërimi i spahijve dhe u përfshinë në hasset perandorake. Të tilla ishin fshatrat Dobranic, Pulanj, Kakariq, Pellani (Belani), Samrish, Përdic (Bër, dica), Gorni Turmshi, Dolini Turmshi, Dajçi, Postërpat, Buzogjatja, Kukla. Melsabardh, Shakull, Pendëtari, Prekal, Këryq (Këroq), Buvarëza. Gjëndja e këtyre fshatrave mbeti si më parë. Përsëri u ruajt në to pagimi në formë globale i detyrimeve që u takonin spahijve, veçse tashmë ato shkonin në dobi të sulltanit

Gjendjen e fshatrave të krahinës së Shkodrës së nënshtruara detyrimeve në formë globale, na ndihmojnë për ta ndriçuar më mirë dy njoftime të rëndësishme të kanunnameve të sanxhakut të Shkodrës të viteve 1529-36 dhe 1570[39]. Këto bëjnë të qartë çka përfaqësonte në vetvehte, çfarë detyrimesh përmblidhte kjo rentë. Në kanunnamenë e vitit 1529-36, ndërmjet të tjerave bëhet fjalë edhe për një grup fshatrash të krahinës së Shkodrës, që u kishin qenë nënshtruar disa normave të veçanta, të ndryshme nga ato të sistemit të timarit, Banorët e tyre jepnin dy detyrime kryesore të quajtura: *hinne* dhe *hënta*. Në dokument thuhet: «Kanuni i disa fshatrave në sanxhakun e Shkodrës që japin hinne dhe hënta është ky: saktësia e masës së hëntasë është një barrë grurë që në atë vend i thonë *moz*; me masën e kartesë (koshiqit) që përdoret qysh prej kohësh në atë vend, një moz për bëhet nga tre karte, dhe në defter për çdo moz është caktuar një vlerë prej 80 akçesh. Dhe shuma e saktë e hinnesë ishte caktuar nga padishahu 52 akçe, dhe për vlerën e potkonjve (*nal baha*) ishte caktuar të merreshin nga pesë akçe për çdo hinne»[40]. Siç dëshmon ky shënim, fshatrat në fjalë duhej të jepnin

Samrish (f.134,151), Oblik (f.136-7), Shënshirgj (f.143), Reçi (f.146), Pulanj (f.146), Kakariq (f.147), Pelani (f.147), Daraglat (f.147), Barbullush (f.148), Përdic (Bërdica) (f.151), Gorni Turmshi (f.152), Dolini Turmshi (f.152), Dajçi (f.152), Stres (f.155), Postërpat (f.158), Buzogjatja (f.158), Kukla (f.158), Melsabardh (f.159), Shakull (f.159), Gjondra (f.159), Pendëtari (f.159), Prekali (f.160), Këryq (Këroq) (f.160), Buvarëza (f.160), Luoros (f.160), Zakol (f.160), Shënkoll (f.161), Kastrat (f.170), Gramshi (f.176-7) Balvazi (f.347), Kalza (f.13);

*në nahijen e Drishtit:* Blesha (f.159).

*në nahijen e Bregut të Përtejmë:* Shkllav (f.319), Petr Shirok (f.319), Koprjova (f.319), Manes (f.320).

*në nahijen e Maleve të Shestanit:* Fshas (f.323), Goriça (f.323), Bardon (f.323), Muriqani (f.323), Unfrasfnil (f.323), Valza (f.323);

*në nahijen e Zhabjakut:* Istasaliq (f.134), Golubovça (f.134), Bushat (f.134), Vranina (f.135), Shkozha (f.135-6), Zhaborova (f.136), Vranja (136), Goriçani (f.141), Martish (f.143), Brisaliq (f.151), Plavniç (f.157), Gostil (f.162), Pestban (f.162), Gruda (f.163-4), Grila (f.347-8), Ber (f.143);

*në nahijen e Petrishpanit:* Kresht (f.134),

*në nahijen e Podgoricës:* Grila (f.157), Izlanic (f.157), Istajkoviq (f.157-8), Fupos (f.158), Krabzha (f. 135).

Shih në faqet e lartpërmendura defterin e sanxhakut të Shkodrës, BV.A, Tapu defterleri,nr. 17.

39) *Kanuni i kanuname za bosanski, hercegovački, kliški, crnogorski i skadarski sandžak, saopštavaja:* Dr.B.Djurdjev, N.Filipović, H. Hadžibegić, M.Mujić, Dr.H. Šabanović, Monumenta Turcica Historiam Slavorum meridionalium illustrantia, T.I., serija I, zakonski spomenici sv.I, Sarajevo 1957, f. 178-180. Ö.L.Barkan, *Osmanli imparatorlugunda zirai ekonominin hukukî ve malî esaslarî, kununlar* I, Istanbul, 1945, f.291-292.

40) *Kanuni i kanunname za Bosanski...*, f.178-180. Çdo hënta ose moz kishte vlerën e 80 akçevë dhe jo të 8 akçeve, siç e kanë vënë botuesit e kanunnameve në fjalë. Ata kanë gabuar në transkibimin e fjalës tetëdhjetë (seksener), duke e shënuar tetë (s kiz). Po japim tekstin e plotë të frazës:

«و لواى اسكندريه حنه و حنطه‌ادن قريه‌لرك قانون بوردكه: حنطه عيارى بر يوك بغدايدر كه اول يرده موز درلر و قديمدن اول يرده جارى اوله كلن اولچوسيله اوچ قارته بر موز اولور و دفترده هر موزه سكسنر آقچه بها تعيين اولنمشدر و حنه اللى اكيشر آقچه پادشاهيدن عياردور و نعل بها هر حنه‌دن بيشر آقچه آلنمق عياردور».

Shih origjinalin, BV.A., Tapu defterleri, nr.367, f.30 4.

tre detyrime të quajtura *hënta, hinne* dhe *nal baha*. Le t'i shohim ato më konkretisht:

*Hënta* (shqip: grurë) – Ashtu siç thuhet në kanunname, hëntaja ishte një barrë grurë që vendasit e quanin *moz* ose *mod*, me vlerën e 80 akçeve. Por në të vërtetë hëntaja ose modi nuk ishte baras me peshën e një barre të zakonëshme gruri të përdorur si njësi matëse në tregjet shqiptare ose në vjeljen e detyrimit të së dhjetës, ndonëse në kanunnametë e shekullit XVI thuhet se hëntaja përbëhet nga një barrë grurë, në përputhje me vetë kuptimin e fjalës mod[41]. Barra e zakonshme nuk e kalonte sasinë e 153,960 kg.[42], kurse modi ose hëntaja, sipas kanunamesë së Shkodrës të vitit 1570, ishte baras me 160 vukije d.m.th. me 205, 280 kg.[43] Përveç ndryshimit në peshë, midis barrës së zakonshme dhe modit vërejmë se kishte ndryshim edhe në çmimin e grurit. Modi vlerësohej me 80 akçe,' kurse një barrë e zakonshme në vitin 1529-36 me 38 akçe, dhe në vitin 1570 me 50 akçe[44]. Gjatë shekullit XVI vlera e modit prej 80 akçesh nuk ndryshoi aspak dhe nuk u përputh me ndryshimet në sasinë e prodhimit ose me lëvizjet e çmimeve të grurit në treg[45]. Ajo mbajti zakonisht vlerën e dy barrëve të zakonshme të grurit, ndonëse si peshë nuk i përgjigjej një përpjestimi të tillë. Në fakt modi ishte një peshë më e rëndë se barra e zakonëshme, dhe përbënte një sasi fikse, të caktuar qysh më përpara, të rentës në natyrë. Kjo formë e shlyerjes së rentës u trashëgua dhe jetoi deri nga gjysma e dytë e shekullit XVI[46].

*Hinne* – Përveç hëntasë-modit, fshatarët e fshatrave të lartpërmendura paguanin edhe një detyrim tjetër të quajtur me emrin *hinne*, që konsistonte në dhënien e 52 akçeve. Kjo sasi ishte e caktuar nga ana e sulltanit. Shprehja që

41) F.Cordignano, *Catasto Veneto di Scutari* ..., v.I, f.40.

42) Kanunnametë e sanxhaqeve shqiptare dëshmojnë se një barrë në sanxhaqet e Shkodrës, të Elbasanit, të Ohrit, të Vlorës dhe të Delvinës ishte baras me 6 killë të Stambollit (shih: BV.A., Tapu defterleri, nr.281; TK.A., nr.66,91; Ö.L.Barkan, *Kanunlar*, f.291; H. Inalcïk, *Suret-i defteri*... f,126). Meqenëse një killë e Stambollit ishte baras me 20 vukije ose okë (për këtë shih kanunnamenë e Elbasanit) del se një barrë ishte e barabartë me 120 okë ose me 153,960 kg. po të llogaritim se një okë ishte baras me 1,283 gr.

43) Në fillim të shekullit XV modi ishte baras me 4 karte. (F.Cordignano, *Catasto Veneto di Scutari*..,) v.I,. 40 Më vonë në fillim të shekullit XVI ishte baras me 3 karte (sipas kanunnamesë së Shkodrës të vitit 1529-36), kurse në gjysmën e dytë të shekullit të XVI me 2 karte, siç duket në përputhje me ndryshimet e peshës së kartesë. Kjo kuptohet nga shprehja që gjendet në kanunnamenë e vitit 1570 se modi ishte baras me dy karte, që përdoreshin aktualisht. Shih gjithashtu J. Kabrda, *Kodet turke (kanunnametë) në lidhje me Shqipërinë dhe rëndësia e tyre për historinë kombëtare*, Buletini i shkencave shoqërore nr.4, 1958, f.191.

44) Ö.L.Barkan, *Kanunlar*, f.291; *Kanuni i Kanunname za Bosanski*... f. 178-180.

45) Po japim këtu poshtë një pasqyrë të çmimeve të produkteve bujqësore gjatë fundit të shekullit XV dhe shekullit XVI, të llogaritur për barrën e zakonshme (për kazanë e Shkodrës dhe të Podgoricës), në bazë të të dhënave të defterit të vitit 1485 dhe të kanunnameve të shekullit XVI.

| | çmimet në v.1485 | çmimet në v.1529-36 | çmimet në v.1570 |
|---|---|---|---|
| barra e grurit | 40 akçe | 38 akçe | 50 akçe |
| » e bathëve | 40 » | 38 » | 50 » |
| » e thjerzave | 50 » | 38 » | 50 » |
| » e qiqrave | — | 38 » | 50 » |
| » e elbit | 25 » | — » | 30 » |
| » e thekrit | 25 » | 25 » | 36 » |
| » e ujemit | 20 » | 18 » | 24 » |
| medreja e mushit | 8 » | 5 1/2 akçe | 8 » |

46) Ö.L.Barkan, *Kanunlar*, f. 291.

gjendet në kanunnamenë e Shkodrës të vitit 1529-36[47] se «për çdo hinne ishte caktuar të merreshin nga 5 akçe [si taksë] për vlerën e patkojve» na bind se hinneja në vetvehte përfaqësonte një unitet që përgjigjej për pagimin e 52 akçeve. Kuptimin e termit hinne e sqaron më mirë një pasazh i kanunnamesë së Shkodrës të vitit 1570, që bën fjalë për fshatrat e vendosura nën këto detyrime. Në të thuhet: «. . ·Hasset perandorake që ndodheshin më përpara në nahijen e Shkodrës dhe që me kohë ju ishin ndarë dhe shpërndarë zotëruesve të timareve, kishin dhënë nga 80 akçe që ishte vlera e [detyrimit] hënta, e cila përbëhej nga një barrë grurë d.m.th. nga një moz, që me masën e kartesë të përdorur aktualisht në atë vilajet, ishte [ baras] me dy karte grurë dhe secila karte me 80 vukije; dhe çdo i martuar [kishte dhënë] nga 52 akçe si hinne dhe nga 7 akçe për vlerën e patkonjve. Në këtë mënyrë, për çdo fshat ishte caktuar nga një sasi hinne dhe hënta, që ata e kishin dhënë»[48]. Ky pasazh dëshmon qartë se hinneja vilej nga çdo i martuar, ose më drejtë, nga çdo kryefamiljar, i cili përgjigjej kundrejt spahijve dhe shtetit për pagimin e rentes. Pra termi hinne përfaqësonte të njejtën njësi të ngarkuar me detyrimet, ashtu si vatrat (hane) e regjistruara në defteret kadastrale osmane të kësaj periudhe, që në vetvehte përfaqësonin kryefamiljarët[49].

Pra, siç shihet, në grupin e dytë të fshatrave të krahinës së Shkodrës renta globale e regjistruar në defterin e hollësishëm të vitit 1485, përbëhej nga tri detyrime kryesore: nga pagesa prej 52 akçe për çdo vatër (hinne), nga një barrë grurë me vlerën e 80 akçeve, që në kanunnametë njihet me emrin hënta ose moz, dhe nga taksa e quajtur «vlera e patkonjve».

Në të vërtetë sistemi i hinnesë dhe hëntasë nuk është gjë tjetër veçse vazhdimi i sistemit të dukatit dhe modit, që ishte aty në zbatim në periudhën para pushtimit, por që tani kishte marrë pjesërisht veshjen e terminologjisë osmane. Në periudhën e sundimit venedikas dhe në atë të sundimit të feudalëve vendas – siç dëshmojnë kadastri i Shkodrës dhe dokumenta të tjera venedikase – fshatarësia ishte e detyruar të paguante si taksa kryesore nga një dukat dhe nga një mod grurë për çdo shtëpi, si dhe detyrimin shtesë të quajtur obrok, në sasinë e 4 groshëve[50]. Mund të supozojmë pra se pagesa prej 52 akçesh për çdo zjarr (hinne) në periudhën e sundimit osman nuk ishte gjë tjetër veçse dukati i dikurshëm, kurse hënta ja ishte modi ose mozi. Siç kuptohet nga të dy kanunnametë e Shkodrës të shekullit XVI, detyrimi i obrokut duhet të jetë zëvendësuar me taksën e quajtur «vlera e potkonjve» që merrej në vitin 1529 në sasinë e 5 akçeve, kurse në 1570 në sasinë e 7 akçeve për çdo vatër. Sipas kadastrit të Shkodrës [51], obroku vilej për të përballuar shpenzimet e zyrtarëve, të proniarve, kur këta do të kalonin nëpër fshatrat e pronieve për të mbledhur detyrimet nga fshatarët. Për të njejtin qëllim, siç e thotë vetë emri, vilej nga spahijtë edhe taksa «e vlerës së potkonjve».

Kanunnametë e Shkodrës të shekullit XVI dëshmojnë qartë se sistemi i hinnesë dhe hëntasë ishte specifik për fshatrat e përfshira në hasset perandorake. Porse të dhënat e defterit të hollësishëm të vitit 1485 e zgjerojnë më tepër zonën ku shtrihej ky sistem, duke treguar se rentën në formë globale e jepnin jo vetëm

47) *Kanuni i Kanunname za Bosanski...*, f.178-180.
48) Ö.L.Barkan, *Kanunlar*, f.291.
49) H.Inalcïk, *Suret-i defter-i...*, Ankara 1954, f.XXXII.
50) G.Ostrogorskij, *Pour l'histoire de la feodalité byzantine*, Bruxelles 1954, f.240-241.
51) F.Cordignano, *Catasto Veneto di Scutari ...*, v.II, shih indeksin.



fshatrat e hasseve perandorake, por edhe një grup tjetër fshatrash të përfshira në timare.

Të dhënat statistikore të këtij dokumenti tregojnë se sasia e rentës që jepte çdo vatër në fund të shekullit XV nuk ishte e barabartë për të gjitha fshatrat e kësaj kategorie.

**Sasia mesatare që jepte çdo vatër në 68 fshatrat që paguanin rentën në formë globale.**

| | | | |
|---|---|---|---|
| mbi 137 akçe | nga 100-137 akçe | nga 100 akçe | nga 70-100 akçe |
| në 19 fshatra | në 12 fshatra | në 19 fshatra | në 18 fshatra |

Siç shihet, kemi një diferencim në sasinë e rentës së çdo vatre në fshatra të ndryshëm. Kjo shkaktohej nga caktimi i sasisë së modeve në përputhje me gjendjen ekonomike të fshatrave. Në fshatrat jo pjellore do të jenë vjelë në një numur vatrash jo nga një mod grurë për secilën, por nga gjysëm modi ose më pak, ashtu siç praktikohej edhe para pushtimit osman.

Nga ana tjetër, të dhënat e mësipërme dëftojnë se në më shumë se 2/3 e këtyre fshatrave sasia mesatare që jepte çdo vatër në fund të shekullit XV ishte më e vogël se shuma prej 137-139 akçesh që ato do të jepnin më vonë në shekullin e XVI[52]. Pra detyrimet e fshatrave të kësaj kategorie u rritën dhe u rënduan në kalimin nga shekulli XV në shekullin XVI, të paktën deri në vitet 1529-36, kur gjendjen e re e bëjnë të njohur të dhënat e kanunnamesë së Shkodrës të datuar me këtë kohë.

Fshtarët e fshatrave të vëna nën sistemin e hinnesë dhe hëntasë ishin të ngarkuar me një rente feudale më të lehtë se ajo që jepnin fshatarët e fshatrave të nënshtruara sistemit të timarit. Kjo pasqyrohet qartë edhe në shumat e të ardhurave që u jepte spahijve çdo shtëpi rajash.

**Sasia mesatare që jepte çdo vatër në 62 fshatra të nënshtruara sistemit të timarit**

| | | |
|---|---|---|
| mbi 137 akçe | nga 100–137 akçe | më pak se 100 akçe |
| në 33 fshatra | në 20 fshatra | në 9 fshatra |

Më shumë se gjysma e fshatrave të nënshtruara sistemit të timarit jepnin për ispenxhen, të dhjetat dhe badihavatë më tepër se 137-139 akçet për vatër që ishin caktuar si rente globale për fshatrat e vendosura nën sistemin e hinnesë dhe hëntasë. Fshatrat e tjerë jepnin edhe më pak; disa prej tyre për arësye se ishin derbendxhij ose për shkak se një pjesë e shtëpive paguanin në formë globale. Megjithkëtë, kjo nuk do të thotë se këto fshatra paguanin rente më të lehtë, për shkak se ato ishin shtërnguar të jepnin edhe një detyrim tjetër – xhizjen[53].

Në defterin e vitit 1485 shumat e dhëna për detyrimet e fshatrave të nënshtruar sistemit të timarit, përfaqësojnë të ardhurat e spahijve nga taksa e ispenxhes, nga të dhjetat e prodhimeve bujqësore, nga taksat e emërtuara «badi-

52) Sipas kanunnameve të Shkodrës të shekullit XVI, secila vatër jepte: 52 akçe hinne, 80 akçe hëntа, 5-7 akçe për «vlerën e potkonjve», d.m.th. gjithsej 137-139 akçe.
53) Për një banor të ardhur (Prishliç) në qytetin e Shkodrës, të quajtur Nikolla, në defter është shënuar se ai e jepte haraçin (xhizjen) në një vend tjetër. Kjo tregon se banorët e tjerë paguanin xhizjen. Të ardhurat nga kjo taksë regjistroheshin në defterë të veçantë. Shih defterin f. 316.

hava» dhe nuk përfshijnë të ardhurat nga taksa e xhizjes, e cila zakonisht vilej nga rajatë veças në dobi të arkës qendrore, shtetërore. Kurse shumat e dhëna nëdefter për fshatarët që paguanin rentën në formë globale, sipas kanunnameve të Shkodrës, përfaqësojnë detyrimin e modit që vilej në formë të prerë përkundrejt të dhjetave të prodhimeve bujqësore, taksën e vlerës së patkonjve – obroku i dikurshëm, dhe hinnenë ose dukatin. Këto shuma përbëjnë të gjithë renten e tyre në natyrë dhe në të holla, duke përfshirë edhe detyrimin e taksës së xhizjes. Hinneja ose dukati në sasinë e 52 akçeve ishte në radhë të parë baravlera e xhizjes, gjë që lihet të nënkuptohet nga fakti se sasia e hinnesë, sipas kanunnameve të Shkodrës, caktohej nga sulltani [54].

Këto të dhëna dëshmojnë qartë për faktin se fshatarët e vendosur nën sistemin e timarit i ishin nënshtruar një shfrytëzimi feudal më të madh nga ai i fshatrave që vazhdonin të mbeteshin nën sistemin e dukatit, modit dhe obrokut. Rrjedhimisht kjo të çon në konkluzionin se sistemi i timarit i zbatuar në një pjesë të fushës së Shkodrës dhe në shumicën e fshatrave të zonave të nënshtruara prej kohësh, sillte me vehte një shfrytëzim më të rëndë në krahasim me gjendjen e para pushtimit. Në periudhën e paspushtimit deri në vitin 1485, kjo gjendje e rënduar u vendos vetëm në ato fshatra ku normat e reja të sistemit të timarit zëvendësuan format e mëparshme të shlyerjes së rentës feudale: të dukatit, modit, obrokut etj. Nga sa mundëm të nxirrnim nga Kadastri venedikas i Shkodrës i vitit 1416-17, duke e krahasuar me defterin e regjistrimit të vitit 1485, të tilla fshatra ishin: Bishtrjolla (Bistiriola), Dobri (Dobreae), Kadrun (Caldiron), Koplik (Copenico), Kuruemira (Grouemira grandj) (Gruemirj pizolj), Podgora (Podegora), Egrish (Egressi), Lushta (Liusta), Zhajna (Xagnena), Marshejn (Marsenj), Balec (Balezo), Lepurosh (Leporonsi), Rjolli (Riola), Kuç (Cucci), Mazarak (Zamarachi), Grizha (Grisa), Reç (Reci), Mes (Messi), Kosmaç (Cusmaci), Dobranic (Dobranci)[55]. Porse zona e vendosur nën timar ishte akoma më e gjerë, sepse përfshinte edhe një varg fshatrash, të cilat, duke mos hyrë në juridiksionin venedikas, nuk përmenden në kadastrin e Shkodrës të vitit 1416-17.

Veç rendimit të rentës në natyrë e në të holla, për thellimin e shfrytëzimit pas pushtimit kontribuoi edhe vendosja e një detyrimi të ri që nuk ekzistonte më përpara për gjithë krahinën e Shkodrës. Ky detyrim ishte e dhjeta e gjakut. Materialet që kemi në dispozicion dëshmojnë tërthorazi mbi zbatimin aty të sistemit të devshirmesë. Sipas disa dëshmive të nxjerra nga defterë të shekullit XVI, nahijet e Hotit, të Plavës, të Izlarjekës [56] dhe të Zadrimës[57] ishin falur nga dhënia e djemve për jeniçerë (*yeniçer oglani*) qysh nga fundi i shekullit XV. Sigurisht, përjashtimi i këtyre krahinave nga ky detyrim, përfaqëson rastet e jashtëzakonshme dhe nënkupton se ai zbatohej në krahinat e tjera të sanxhakut.

54) Në rastin tonë, sipas defterit të vitit 1485, të ardhurat nga hinneja përfshiheshin në hassin e sanxhakbeut. Nuk përjashtohet mundësia që një pjesë e tyre të konsideroheshin si të ardhura nga ispenxha dhe rrjedhimisht të ardhurat nga hinneja të ndaheshin midis sanxhakbeut dhe arkës shtetrore, ashtu siç ndodhte me detyrimet e florixhijve në Mal të Zi. Për fat të keq, për një gjë të tillë defteri i vitit 1485 nuk jep asnjë të dhënë.

55) Shih: J.Valentini, *Acta Albaniae Veneta...*, f.183, 184, 185-187, 193, 194. 198-200, 203, 205-206, 209, 211-214, 216-219, 222-224, 294, 426. Shih gjithashtu në defterin e regjistrimit të vitit 1485, respektivisht faqet: 156-157, 154, 139-141, 123-124, 145, 155, 126, 139, 345-346, 169, 132-133, 130,170, 149, 176, 172-173, 127, 146, 145, 124-125, 144, 142.

56) TK.A., *defteri liva-i Iskenderiye*, nr.59, 115, 228.

57) po aty; *defteri liva-i Dukagin*, nr.63, fl.113.



Pushtimi osman solli një normë tjetër të re rënduese, njëlloj si për fshatrat e vëna nën sistemin e timarit, ashtu edhe për ato që vazhduan të paguanin rentën feudale si para pushtimit, por që tani u ishin ndarë spahijve në timare. Zëvendësimi i proniarve me spahijtë në të dy zonat e përmendura më lart u shoqërua me vendosjen e së drejtës së tapisë në favor të spahijve. Kjo normë nuk ekzistonte në periudhën kur këto toka zotëroheshin ose nga proniarët ose nga bashkësitë fshatare. E drejta e re në favor të zotëruesve të tokës e rriti më tepër normën e shfrytëzimit dhe pushtetin e ri të spahijve mbi fshatarët në krahasim me pushtetin e proniarëve; ajo përforcoi vartësinë feudale të fshatarëve ndaj tokës që ata kishin në përdorim, në krahasim me periudhën para pushtimit.

Kjo bëhet akoma më e qartë po të kihet parasysh fakti se një shumicë fshatrash të zonës fushore të Shkodrës në gjysmën e parë të shekullit XV, duke mos qenë nën pushtetin e proniarëve, ruanin ende elemente të vetqeverisjes dhe ishin në fakt qeliza shoqërore dhe administrative më vehte[58]. Pushteti i proniarëve nuk kishte arritur të vendosej në të gjitha fshatrat e Shkodrës të regjistruara në kadastrin venedikas. Rrjedhimisht në vitin 1417 numri i kryeparëve (kavo) të fshatrave arrinte në 52, kurse numri i proniarëve ishte vetëm 16, prej të cilëve 10 ishin njëkohësisht edhe kryeparë[59]. Qenia në jetë e formave tëlashta të organizimit shoqëror si dhe ruajtja e një farë vetqeverisjeje nga komunat fshatare në periudhën para pushtimit osman, ishin kushtëzuar nga diferencimi jo i thellë klasor në gjirin e këtyre komuneve si dhe nga fakti që lidhjet e gjakut nuk ishin shfuqizuar ende krejt brenda lidhjeve teritoriale. Po të vrejmë nga ky këndfshatrat e zonës së Shkodrës në fillimet e shekullit XV (1416-17), do të konstatojmë se në 23 fshatra të gjithë banorët ose shumica e tyre ishin të një fisi dhe mbanin si mbiemra, mbiemrat e kryeparëve të tanishëm, të cilët njëkohësisht ishin emra të fshatrave në fjalë[60]. Kjo dëshmon se kryeparët e fiseve, ose të vëllazërive që banonin në to, si përfaqësues të vetqeverisjes lokale kishin mundur t'u bënin ballë përpjekjeve të proniarëve për të vendosur pushtetin e tyre feudal. Qendresa e bashkësive fshatare ishte ajo që frenoi gjithashtu fuqizimin e pushtetit të kryeparëve dhe shndërrimin e tyre në proniarë, siç ishte rasti i 10 kryeparëve që ishin më 1416-17 njëkohësisht edhe proniarë.

Pak a shumë e njejta gjendje ishte ruajtur deri në kohën kur u krye pushtimi osman. Defteri i sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485 na jep mundësi të konstatojmë se format e vjetra të organizimit shoqëror dhe lidhjet e gjakut ruheshin ende të forta në një varg vendbanimesh, të cilat duhet të ishin krijuar jo më herët se një ose dy breza përpara brezit të banorëve të regjistruar në defter. Kjo vërtetohet nga fakti se nga njera anë këto fshatra mbanin emrat e kryeparëve të një fisi ose vëllazërie, ose të një dege të një katuni, dhe nga tjetër banorët kryefamiljarë cilësohen si bijtë, vëllezërit ose nipërit e atij kryepari, emrin e të cilit kishte marrë edhe fshati[61]. Kështu p.sh. nuk ka dyshim se ngulitja e fshatit

58) I.Božić, *Proniarii et capita*, në Zbornik radova vizantološkog instituta, VIII/1, Beograd 1963 f.68.

59) I.Božić v.p. f.65.

60) Sipas kadastrit venedikas të Shkodrës, të tillë janë fshatrat Itusi, Oseti, Grouemira Grandj, Maiora, Egresi, Vaiussi, Bodisa ose Rastenj, Schirellj, Castrati, Marsenj, Cruetio, Bardj, Messi, Cusmaci, Lubani, Cazapur, Spatarj, Gunësi, Precal, Leporonsi, Mandrossi, Sigeci, Precal. Shih J.Valentini, *Acta Albaniae Veneta*, Tomus VIII, f.191-193, 198-199, 203-204, 206-207, 216, 291-297, 326, 350-351, 353, 314-315, 340; I.Božić *v.p.* f.65.

61) Në defterin e vitit 1485 janë shënuar shprehimisht lidhjet farefisnore midis banorëve të një fshati; në kadastrin venedikas studjuesi duhet t'i nënkuptojë këto vetëm nga mbiemrat e banorëve.

Reç duhet të jetë bërë vonë, për arësye se nga 15 familje që banonin në të, kryefamiljarët e 7 familjeve cilësohen si bijtë e një kryepari të quajtur me emrin Reç si: Gjorgji i biri i Reçit, Kola i biri i Reçit, Vuku i biri i Reçit, Nika i biri i Reçit, Deshardh (Desharz) Reçi, Gjergji i biri i Reçit, Prosha Reçi[62].

Në zonën e Shkodrës ndeshim gjithsej 31 fshatra të tillë:

në nahijen e *Hotit:* fshatrat Mihalina (nga Mihal), Tihomir[63].
» » *e Petrshpanit:* fshatrat Sunja dhe Davit[64].
» » *e Bregut të Përtejmë:* fshati Petr Shiroka[65].
» » *e Shestanit:* fshatrat Gjon Braka dhe Bobod[66].
» » *e Bregut të Këndejmë:* fshatrat Damniç Tuz, Bgur Tuz, Kuqik Tuz, Istulush Tuz, Petrashani Tuz, Pistull Tuz (i braktisur), truallishta Gjon Tuz, që vazhdojnë edhe në nahijen e Shkodrës: Gradec Tuz, Shukovik Tuz, Podol Tuz, dhe në nahijen e Zhabjakut: Tuz[67].

*në nahijen* e *Shkodrës:* fshatrat Dragovol, Kryethi, Reç, Mosili, Xhovan, Grila, Marshejn, Mglush, Kusmaç, Reçi, Prekali, Prela, Lepurosh, Gradisaliq dhe Mazarak[68].

Një prejardhje të tillë [69], por të ngulitur kohë më parë, duhet të kenë edhe disa fshatra të tjerë, emrat e të cilëve lenë të kuptohet se vijnë nga emri i një të pari të një fisi ose nga emri i vetë fisit[70].

Më 1485, në fshatrat Marshejn, Kusmaç, Prekal, Lepurosh, Kryethi, Mesi, ruheshin ende të forta lidhjet e gjakut ashtu si në fillim të shekullit të XV[71], kurse në fshatrat e tjerë si Shkripol, Egjrish, Gruemira, Tuzi, ato tashmë ishin shkrirë para lidhjeve teritoriale, përderisa në defterin e vitit 1485 banorët nuk cilësohen më si bij të një kryepari, por mbajnë mbiemra të ndryshëm[72]. Megjithkëtë, të dhënat e mësipërme na krijojnë bindjen se ende nga fundi i shekullit të XV në fshatrat e Shkodrës ruheshin format e lashta të familjes, siç ishin bashkësitë familjare, vëllezëritë e familjet e mëdha. Zakonisht në fshatrat e kësaj zone

62) defter, f.146.
63) defter, f.303-305.
64) defter, f.149-150.
65) defter, f.315.
66) defter, f.321-322.
67) defter, f.341-344, 143-144, 156, 164-165, 175.
68) defter, f.346, 125, 127, 130-133, 141, 144, 146, 160, 167-168, 170-171, 176.
69) Zakonisht emrat e këtyre fshatrave i ndeshim në defter si emra të kryeparëve, me përjashtim të disa rasteve si p.sh. të emrave të fshatrave Dragovol, Grila, Lepurosh, Gradisaliq, të cilat i gjejmë vetëm si mbiemra për shumicën e banorëve. Kjo le shteg të mendohet se në disa prej tyre mundet që fiset të kenë marrë emrin e vendit. Rast më të qartë për një fenomen të tillë kemi p.sh. në fshatrat Damniç Tuz, Petrashani Tuz, Gradec Tuz, të cilat e humbën më vonë emrin e fisit dhe mbeten vetëm me emrin e vendit, siç i gjejmë edhe sot: Kamenic (Damnic), Petroshan Gradec.
70) Me origjinë të tillë duhet të jenë fshatrat Pantalesh-Panta Leshi, Llazorci në nahijen e Kuçit (f.295-6, 299): Mariniq, Dimitroviq në nahijen e Bjelopavliqit (f.300-301); Geg (Gjegj) në nahijen e Hotit (f.303); Manes në nahijen e Bregut të Përtejmë (f.320); Nikijt në nahijen e Petrishpanit (f.335); Leshani, Vokshiq, Gjorgjoviq, Miladinofiç në nahijen e Pejës (f. 470-1, 99-100, 116-7, 120); Marin dhe Gjondra në nahijen e Shkodrës (f.133,159) etj.
71) Në vitin 1416-17 shumica e banorëve dhe kryeparët e këtyre fshatrave kishin të njejtë mbiemrin me emrin e fshatit, kurse me 1485 shumicën e banorëve të tyre i gjejmë të përmendur si bijt e kryeparve emrin e të cilëve mbanin edhe fshatrat. P.sh. në fshatin Marsenj gjejmë si kryepar Pal Marsenjin më 1416-17, kurse më 1485 gjejmë banorë të cilësuar si «i biri i Marshenit». Pra fiset nuk duhet të jenë ngulitur vonë për deri sa këto fshatra ekzistonin edhe në fillim të shekullit XV, por kohë më parë, dhe mundet që emri i kryeparit fillestar të fisit, me të cilin u quajt edhe fshati, të jetë trashëguar në brezat e mëvonshëm, gjë që ishte e zakonshme tek shqiptarët.
72) defter f.124, 125, 126, 139, 145, 139, 164.



banorët ishin diku tërësisht e diku në shumicën dërmuese, degë të së njejtës familje, d.m.th. kunorë të rrjedhur nga një kryepar i përbashkët, të cilat tani në defter ishin regjistruar veças, për efekt të pagimit të rentës feudale. Ruajtja e këtyre lidhjeve fisnore të forta në më se 31 fshatra të rajonit të Shkodrës, ekzistenca e bashkësive fshatare të përbëra nga pjestarë të një «barku» a «vëllezërie» të dikurshme, edhe pse tashmë të ndarë dhe të cilësuar me mbiemra të ndryshëm, është një dëshmi e shkallës ende jo të përkryer të zhvillimit të marrëdhënieve feudale në këtë zonë. Brenda për brenda celulave fisnore dhe bashkësive fshatare nuk kishin dalë ende elemente që të vendosnin pushtetin e tyre feudal, duke thyer guaskën e këtyre institucioneve dhe duke mënjanuar vetadministrimin e brendshëm të përfaqësuar nga kryeparët e fiseve ose të vëllazërive. Procesi i kthimit të kryeparëve në proniarë të vegjël feudalë nuk kishte mundur të kryhej kudo e plotësisht deri në pragun e pushtimit osman.

Në fund të shekullit të XV në zonën fushore bashkësitë fshatare dhe bashkësitë blegtorale ose «*katunet*» e sapoteritorializuara ku ruheshin ende lidhjet fisnore, nuk kishin kundrejt pushtetit osman të njejtën pozitë që kishin gëzuar më parë kundrejt pushtetit të senjorëve vendës dhe të Venedikut. Ndërsa pushteti feudal para pushtimit osman nuk kishte mundur të zëvendësonte plotësisht vetqeverisjen e komunave fshatare dhe kryetarët (kavo) e fshatrave me pushtetin e proniarëve, tashmë pushteti feudal osman, në sajë të fuqisë së madhe ushtarake, mundi të zëvendësonte me pushtetin e spahijve jo vetëm pushtetin e proniarëve, por edhe vetadministrimin e fshatrave, autoritetin e kryeparëve, duke çarë kështu përfundimisht guaskën e institucioneve fisnore. Në periudhën para pushtimit osman, ky proces ishte zhvilluar kryesisht brenda për brenda bashkësive, nëpërmjet diferencimit ekonomik shoqëror, dhe shndërrimit të kryeparëve në feudalë të vegjël proniarë. Me vendosjen e pushtetit osman procesi i feudalizmit u zhvillua me ritme më të shpejta, duke u imponuar bashkësive fshatare nga jashtë pushtetin e feudalëve të rinj – spahijve, zotrues të tokave dhe të rajave në timaret e tyre, pa qenë këta më parë kryeparë ose proniarë të tyre. Ky veprim e ngriti në një shkallë më të lartë procesin e feudalizmit.

Të dhënat që parashtruam tregojnë se marrëdhëniet karakteristike për sistemin e timarit patën në zonën fushore të Shkodrës, një shtrirje jo të plotë, gjë që u shpreh në numrin e vogël të timareve të krijuara dhe sidomos me ndryshimin ende të pakët të rentës feudale në krahasim me rentën që fshatarët e këtyre krahinave jepnin para pushtimit osman. Duke përjashtuar vetëm banorët e një zone të vogël, mbi të cilët u vendosën detyrimet e zakonshme të rajave, pjesën tjetër të popullsisë së fushës, sundimtarët osmanë, gjatë periudhës fillestare të pushtimit, nuk mundën ta ngarkonin me renten e zakonëshme për sistemin e timarit, prandaj qenë shtërnguar të linin në fuqi detyrimet e mëparshme në të njejtat sasi dhe forma.

Kjo u kushtëzua jo vetëm nga diferencimi i pakët klasor në gjirin e popullsisë dhe nga ruajtja e së drejtës së vetadministrimit në bashkësitë fshatare të fushës, por edhe nga faktorët politikë siç qenë qëndresa e ashpër e popullsisë kundër pushtimit osman, mungesa e klasës feudale vendase, tek e cila sundimtarët osmanë mund të krijonin më lehtë një mbështetje shoqërore, pozita e krahinës së Shkodrës si zonë kufitare etj.

c) **Krahinat e vendosura në statusin e florixhijve**[73] Viset malore të përfshira në kazatë e Shkodrës dhe të Podgoricës përbënin një grup të tretë, që dallonte nga viset e tjera fushore, ku ishin vendosur spahijtë, dhe ku fshatarësia pjesërisht u qe nënshtruar detyrimeve të reja që sillte sistemi i timarit ose pjesërisht ruajti format e mëparshme të shlyerjes së rentës feudale me dukatin, modin, obrokun.

Në këto vise malore fshatarësia kishte ruajtur një formë të mëparshme, më të lehtë, të shlyerjes së rentës feudale-*dukatin*.

Banorët e këtyre viseve ishin detyruar t'u paguanin zotërve të tokës (*sahibi arz*) të tyre nga 50 akçe për çdo shtëpi ose bashtinë, që në fakt paraqitnin vlerën e një dukati, ose, siç quhet në dokumentat osmanë, *të filorisë-floririt*, që ata ju a patën paguar zotërve feudalë në periudhën para pushtimit osman[74]. Sipas informatave që sjell defteri në fjalë, në statusin e florixhijve ishin përfshirë fshatrat e nahijeve të Pipërit, të Kuçit, të Hotit, të Bjelopavliqit (Palabardhit), të tokave të Pjetër Spanit (*Petrispan-ili*) dhe një pjesë e fshatrave të Shestanit, të përfshirë në hassin e sanxhakbeut. Në fakt, floriri ishte një pagim në formë globale i rentës, meqenëse florixhijt përveç 50 akçeve nuk ishin të detyruar t'i paguanin veças sulltanit haraçin për kokë, ose zotëruesve të tokës të dhjetën e prodhimeve bujqësore, ispenxhën si dhe detyrime të tjera të zakonshme të rajave[75]. Të dhëna të drejtpërdrejta që të dëshmojnë se çka përmbidhte detyrimi floririt te malësorët shqiptarë, ende na mungojnë. Megjithkëtë, çeshtjen e sqaiojnë të dhënat për florixhijt fqinjë të Malit të Zi. Sipas kanunnamesë së Malit rtë Zi të vitit 1523[76], floriri prej 55 akçesh që paguanin florixhijt malazezë për çdo shtëpi dhe bashtinë, përmblidhte tri detyrime kryesore: taksën e haraçit për kokë (xhizja) në vlerën e 33 akçeve, që shkonte në dobi të arkës shtetërore, detyrimet e së dhjetës dhe të ispenxhes në vlerën e 20 akçeve, që shkonin në dobi të sanxhakbeut me cilësinë e zotëruesit të tokës, dhe 2 akçe shtesë për shpenzimet e nëpunësve të sulltanit që do të mblidhnin taksën e xhizjes[77]. Nuk ka ndonjë arësye të mos pranojmë që edhe florixhinjtë shqiptarë, ashtu si fqinjët e tyre malazezë, të paguanin detyrimin e 50 akçeve përkundrejt taksave të njejta,

73) I pari që mori në studim gjendjen e viseve malore të MbiShkodrës nëpërmjet dokumentave osmanë, është historiani jugosllav B.Gjurgjev, veçanërisht në punimin *Nga historia e Malit të Zi e fiseve të rrëzëmaleve dhe e fiseve malësore*. Për këtë ai është mbështetur kryesishst, në të dhënat e defterit përmbledhës (icmal) të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 dhe të regjistrit përmbledhës të regjistrimit të veçantë që ju bë krahinave malore të Kuçit, të Pipërit, të Hotit, të Palabardhit në vitin 1497. Ne do të mundohemi të sqarojmë më tej gjendjen e malësorëve në vitet e fundit të shekullit XV, duke u mbështetur mbi një bazë më të gjerë materialesh dokumentare, edhe mbi të dhëna burimore që autori i mësipërm, siç e pohon edhe vetë, nuk i ka patur në dispozicion. Të tilla janë veçanërisht të dhënat e nxjerrja nga defteri i hollësishëm i sanxhakut të Shkodrës i vitit 1485 dhe nga regjistrimi i hollësishëm i krahinës së Pipërit dhe Kelmendit në vitin 1497, që i është vënë si shtesë defterit të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, si dhe disa kanune dhe komente ligjore të shënuara në defterin e hollësishëm të regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës në vitin 1582, por që bëjnë fjalë për gjendjen e këtyre krahinave në fund të shekullit XV, pas heqjes të statusit të florixhijve-Shih S.Pulaha, *Krahinat perendimore dhe qendrore të sanxhakut të Shkodrës në fund të shekullit XV, II*, në Studime Historike, nr.3, 1971, f.115-138.

74) Në të vërtetë regjistrimi i vitit 1485, me përjashtim të fshatrave të nënshtruara sistemit të timarit, pasqyron edhe gjendjen konkrete të detyrimeve feudale të fshatrave para pushtimit osman, me ndryshimin se tashmë këto ishin veshur pjesërisht me terminologjinë osmane siç ishin p.sh. termat hinne dhe hënta për dukatin dhe modin, dhe floriri për dukatin.

75) H.Inalcik, *Sureti i defteri*,... f.XXXIII, shënimi 219.

76) B.Djurdjev, *Dva deftera Crne Gore iz vremena Skender-bega Crnojevića*, prva sveska, Sarajevo 1968, f.30.

77) B.Djurdev *Dva deftera Crne Gore*..., f.60.



aq më tepër kur në dokumentacionin e kohës nuk dëshmohet për dhënien e taksave të tjera prej tyre. Por ndryshe nga florixhijt malazezë, të ardhurat e florixhijve të sanxhakut të Shkodrës, ashtu si tek vllehët (efllak) e Bosnjës[78], shkonin të gjitha në dobi të sanxhakbeut, të cilit i ishin dhënë në zotërim këto toka, pa ndarë një pjesë të tyre, si detyrim të xhizjes, që të shkonte në dobi të arkës shtetërore.

Pra floriri ishte një zëvendësim i të gjitha tatimeve dhe detyrimeve, si për ato që vileshin për arkën shtetërore, ashtu edhe për ato që i përkisnin «zotit të tokës», në këtë rast sanxhakbeut të Shkodrës. Në të vërtetë floriri ishte një pagesë më e vogël se shuma e tatimeve dhe detyrimeve që zëvendësonte. Detyrimi global që jepnin florixhijt përkundrejt të dhjetës dhe ispenxhes (p.sh.te malazezët arrinte në 20 akçe) ishte në fakt më i vogël se sasia prej 25 akçesh që një raja i paguante spahiut vetëm për ispenxhen.

Nga ana tjetër, krahinat malore të vendosura në statusin e florixhijve nuk iu nënshtruan spahijve, nuk u ndanë midis tyre në timare, por bashkërisht, si njësi, i ishin dhënë në zotërim sanxhakut të Shkodrës, i cili në të vërtetë konsiderohej zot i tokës së tyre.

Spahijtë nuk depërtuan dot në bashkësitë fshatare dhe në organizatat blegtorale të katuneve, në të cilat vazhdonte të ruhej ndikimi dhe autoriteti i kryeparëve (në origjinal: *kaznes*). Këta i gjejmë të regjistruar në defter vetëm për krahinat e Pipërit dhe Kelmendit në vitin 1497, në katunet Liçeni, Gjonoviq, Muriq, Kolemadi të fshatrave Selçisha dhe Çpaja të Kelmendit[79]; në katunet shqiptare Bukmir, Bushat, Dirnoviça, të fshatrave Istrahaliq dhe Dirnoviça, si dhe në katunet e tjera, për të cilat në defter nuk janë dhënë emrat e veçantë, të fshatrave Lushkozhupa, Drezka, Dobriqo, Izlatçisha, Reçiça (në Pipër)[80].

Pronat e fshatarëve florixhinj ishin të lira, sepse zotëruesi i tokës, sanxhakbeu i Shkodrës, nuk gëzonte faktikisht në to të drejtën e tapisë. Por të dhënat dokumentare dëshmojnë se më vonë në shekullin XVI, florixhinjtë ishin ngarkuar edhe me pagimin e gjobave (*cürmü cinayet*) dhe në rastet kur blinin toka nga fshatarët raja të zonave të vëna nën sistemin e timarit, paguanin edhe taksën e tapisë. Këtë e dëshmojnë qartë dy shënime të defterëve të regjistrimit të shekullit XVI[81] dhe më qartë, kanunnameja e sanxhakut të Shkodrës e vitit 1570. Sipas kësaj të fundit, më 1570 në fshatrat ku një pjesë e banorëve ishin florixhinj, kurse pjesa tjetër i ishte nënshtruar rentës karakteristike të sistemit të timarit, në rast se një florixhi blinte tokën e një rajaje, ai duhej t'i nënshtrohej pagesës të së dhjetës së prodhimeve bujqësore në dobi të spahiut që ishte zot i tokës në fjalë, ashtu si gjithë rajat e tjerë.[82] Si rezultat i kësaj, në defterët e shekullit XVI

78) *Kanun i kanunname za bosanskog*..., f.12-14

79) defter, f.200-204

80) defter, 189-200.

81) Në defterin e sanxhakut të Shkodrës të vitit 990 h/1582, në hasset e padishahut janë regjistruar dhe të ardhurat që vinin nga «mukataaja e (taksës) *cürmü cinayet* në hasset e florixhijve të vjetër së bashku me taksën e tapisë së tokës, gjithsej 12.000 akçe». TK.A., nr.59 fl.6. Sipas defterit të Dukagjinit të vitit 978 h/1570-71, florixhijt e Varoshit të Lezhës, të përfshirë në hasset perandorake, i paguanin arkës shtetrore taksën e tapisë për një truallishte që ata morën në shfrytëzim. «Truallishta Ishulla, derbend i popullsisë së varoshit të Ljeshit: truallishten e mësipërme e kishte zotëruar popullsia e vetë varoshit të Ljeshit. Meqenëse në kohën e regjistrimit doli në shesh se ata e kishin zotëruar pa tapi, me qëllim që t'i dërgohej arkës shtetërore, ju muar taksa e tapisë dheju dhanëtapitë popullsisë së varoshit të sipërpërmendur. Ata e zotërojnë dhe japin të drejtat (detyrimet) e domosdoshme në flori». B.V.A., Tapu defterleri, nr.499, f.18-20.

82) Ö.L.Barkan, *Kanunlar*, f.291.

janë regjistruar sasira të ardhurash nga taksa e tapisë tek florixhijtë, për tokat e blera nga rajatë ose për toka të marra në përdorim për herë të parë. Kjo është një karakteristikë për florixhinjtë e zonave fushore të vendosura në sistemin e timarit, siç është p.sh. rasti i florixhijve për të cilët bën fjalë kanunnameja e Shkodrës e vitit 1570, ose rasti i florixhijve të Varoshit të Lezhës. Pra, pagesa e taksës së tapisë varej nga statusi në të cilin qenë vendosur tokat në fjalë. Për florixhijt e zonave malore nuk mund të bëhet fjalë për pagimin e kësaj takse, sepse këto vise nuk u vunë nën pushtetin dhe administrimin e drejtpërdrejtë të spahijve të veçantë, por e ruajtën unitetin e tyre, duke u përfshirë bashkërisht në hassin e sanxhakbeut. Prona fshatare në viset malore, prona e përbashkët e fiseve mbi tokën, mbeti gjithashtu e lirë, duke u administruar në bazë të së drejtës zakonore vendase, pa u zëvendësuar me normat e legjislacionit osman. Rrjedhimisht florixhijt qendruan të lirë, pa patur kurrfarë vartësie personale ndaj zotëruesit të tyre, sanxhakbeut të Shkodrës.

Mungesa e spahijve, pagimi i rentës feudale në formën e floririt me një peshë shumë më të vogël se ajo e detyrimeve të rajave, lënja e lirë e pronës së përbashkët të fiseve dhe e administrimit të vendit në bazë të së drejtës zakonore, mungesa e çdo vartësie personale ndaj zotëruesit të tokës, sanxhakbeut, ishin ato të drejta që u krijojnë viseve malore një pozitë më të privilegjuar se ajo e krahinave të nënshtruara sistemit të timarit. Në fakt, pagimi i floririt në vlerën e 50 akçeve, ishte një rinjohje nga ana e qeveritarëve osmanë e formave të mëparshme të rentës feudale që vilej nga fshatarët e malësive në periudhën para pushtimit osman. Kjo formë njihej në viset malore që hynë tani në kazatë e Shkodrës dhe të Podgoricës, qysh në kohën e sundimit të Stefan Dushanit. Sipas kodit që mban emrin e tij, fshatarët e vendosur në tokat e proniarëve i paguanin shtetit nga një hiperper për çdo shtëpi. Në kohën e sundimit të Cërnojeviçve mbi një pjesë të këtyre viseve, vazhdoi të ekzistonte i njejti detyrim: në vend të hiperperit perandorak tani vilej në vit nga një dukat për çdo shtëpi, të ardhura që kalonin në dobi të sunduesit[83]. Ndërsa renta u rrit në viset fushore të krahinës së Shkodrës në periudhën e sundimit venedikas, duke paguar për çdo vatër dukatin, modin dhe obrokun, në viset malore ajo nuk pësoi ndonjë rëndim[84]. E tillë ajo qëndroi, siç e pamë, edhe pas pushtimit osman, pavarësisht nga ndryshimi i emrit dhe pavarësisht se qeveritarët osmanë të ardhurat që vinin nga detyrimi i 50 akçeve të floririt i ndanin midis sanxhakbeut dhe sulltanit, ose i konsideronin si pagim të disa detyrimeve që ishin karakteristikë për sistemin e timarit si p.sh. të xhizjes, të ispenxhes dhe të së dhjetës së prodhimeve bujqësore. Ruajtja e rentës feudale të mëparshme do të thotë se qeveritarët osmanë ende gjatë fundit të shekullit XV nuk ishin në gjendje t'i impononinfshatarësisë, veçanërisht të viseve malore, një shfrytëzim më të rëndë. Meqenëse në viset malore ruhej ende organizimi fisnor dhe marrëdhënjet feudale ishin në periudhën fillestare të zhvillimit, osmanët nuk mundën të depërtonin nëpërmjet njerës prej formave të zakonshme të politikës së tyre, siç ishte njohja e pozitës feudalëve vendas, duke i pranuar si spahij në gjirin e klasës sunduese osmane. Krerët e fiseve dhe të vëllazërive ende nuk kishin fituar pozitën e plotë të një feudali, gjë që mund t'i vinte në pozita kundërshtare me malësorët. Interesat e tyre në këtë fazë pothuajse ishin të përbashkëta me ato të malësorëve të tjerë, sepse akoma nuk ishte krijuar ndër ta një diferencim shoqëror i thellë. Në periudhën fillestare të pushtimit, qeveritarët

83) G.Ostrogorskij, v,p. f.242,254.
84) Po aty.



osmanë, u mjaftuan vetëm me njohjen e pushtetit të tyre nga ana e malësorëve, nëpërmjet pagimit të floririt për çdo vatër. Malësorët florixhij e ruajtën kështu gjendjen e mëparshme, lirinë e vetadministrimit të brendshëm, në bazë të së drejtës zakonore, vetëm me ndryshimin e rëndësishëm se tashmë ndruan kryezotin feudal, duke pranuar për sundues sulltanin.

Statusi i florixhijve nuk pati jetë të gjatë, sepse në vitin 1497 ai u ndryshua për shumicën e fshatrave të caktuar si florixhij në vitin 1485. Siç do ta analizojmë më poshtë, në periudhën pas regjistrimit të parë, me përforcimin e pozitave të veta, klasa feudale osmane e këtyre krahinave, e mbështetur tek aparati i fuqishëm shtetror, e thelloi më tepër shfrytëzimin feudal në viset e vëna nën statusin e floririt, duke anulluar këtë status për shumicën e krahinave malore dhe duke i ngarkuar florixhijt me detyrat suplementare të derbenxhijve (ruajtës të grykave), ose duke vendosur mbi një pjesë të vogël të malësorëve – siç qe rasti i malësorëve të Pipërit – detyrimet karakteristike të timarit.

Le të shohim më hollësisht se në ç'pozita gjendeshin malësorët e secilës krahinë pas heqjes së statusit të florixhijve.

Më 1497, sundimtarët osmanë nuk i ngarkuan malësorët e krahinave të *Pipërit* dhe të *Kuçit* me shërbimin e derbendxhiut, por u përpoqën t'i vinin nën detyrimet e sistemit të timarit. Tashmë nahija e Pipërit[85] ishte e ndarë në tre timare në zotërim të krerëve të katuneve: të Bozhidar Vukotës, të Radul Vukashinit dhe të Vuk Gjergjit[86]. Pipërasit u paguanin spahijve taksat që u takonin atyre si zotërues rajash (*rusumi raiyet*) në përpjesëtimet e zakonshme. Nga çdo vatër (kryefamiljar) dhe nga çdo beqar, vilej taksa e ispenxhes në sasinë prej 25 akçesh, kurse nga gratë e veja në sasinë prej 6 akçesh. Po kështu spahijtë si zotërues të tokës, vilnin rentën në natyrë (të dhjetën) në bazë të pjellshmërisë së tokës. Vendin kryesor midis këtyre detyrimeve e zinte ispenxha dhe jo e dhjeta, gjë që kuptohet nga fakti se prej saj nxirreshin 14.117 akçe të ardhura, kurse shuma e përgjithshme e detyrimeve arrinte në 17.452 akçe.[87]. Kjo ishte shkaktuar nga mungesa e tokave të punueshme në këtë krahinë.

Në krahasim me gjendjen e vitit 1485, në vitin 1497 renta feudale ishte rritur. Tani vetëm detyrimi i ispenxhes prej 25 akçesh për çdo të martuar dhe beqar, ishte sa gjysma e detyrimit të mëparshëm që ata jepnin si florixhij. Përveç kësaj, spahijtë vilnin të dhjetën dhe taksat badihava. Kështu 427 shtëpi të nahijes së Pipërit jepnin gjithsej 17.452 akçe d.m.th. secila shtëpi jepte 40,6 akçe si detyrim të ispenxhes, të të dhjetave dhe të badihavasë. Për më tepër vileshin në favor të shtetit taksa e xhizjes, detyrimet e divanit si dhe taksa e dhenve në sasinë 1805 akçe.

Më 1497 qeveritarët osmanë bënë gjithashtu hapat e para për të vendosur përfaqësuesit e tyre në Pipër. Duke mos qenë në gjendje të vendosnin njerëzit e tyre nga jashtë, ata u detyruan t'ua njihnin pozitën e spahiut krerëve të katuneve.

85) Po analizojmë gjendjen e kësaj krahine dhe jo të krahinës së Kuçit, jo vetëm sepse për të disponojmë të dhëna më të plota nga regjistrimet e përmbledhur dhe të hollësishëm të vitit 1497, por edhe për faktin se ajo u nda në timare, kurse Kuçi e ruajti unitetin e vet brenda hassit të sanxhakbeut.
86) Në regjistrimin mufassal, ndryshe nga regjistrimi icmal, jepet jo vetëm emri, por edhe mbiemri i spahiut. P.sh. në të thuhet shprehimisht Bozhidari, i biri i Vukotës. Kjo vërteton supozimin e B. Gjurgjevit se spahiu Bozhidar që përmendet në defterin icmal, është Bozhidar Vukotini, për të cilin flet gojdhana popullore, në kundërshtim me supozimin e Erdeljanoviçit se Bozhidar Vukotini ka jetuar në fund të shekullit XVI. B.Djurdjev, *Iz istorije Crne Gore...*, f.210-211.
87) Shih regjistrimin e hollësishëm të Pipërit më 1497; defter, f.189-200.

Kjo ishte një përpjekje për t'i kthyer në përçues dhe përfaqësues të administratës osmane, por që në realitet nuk bëri tjetër veçse rikonfirmoi pozitën që kishin patur këta krerë edhe më parë, me kusht që gjithë krahina të pranonte sundimin osman, duke paguar rentën feudale, e cila tashmë kalonte kryesisht në favor të krerëve vendës. Rritja e rentës feudale dhe ekzistenca e spahijve vendës të krishterë në Pipër, shënojnë një shkallëzë ndërmjetëse në rrugën e kalimit nga statusi i florixhijve të lirë drejt vendosjes së detyrimeve të rajave dhe të përfaqësuesve të rregullt të administratës osmane. Më 1497 ende nuk mund të themi se kemi një vendosje të administratës osmane, për arësye se nuk u cënua e drejta e vetqeverisjes së vendit. Nga ana tjetër fakti se tre krerëve vendës ju njoht e drejta të vilnin në dobi të tyre një rentë feudale më të madhe se më përpara dhe që tashmë u takonte atyre si spahij «zotërues të tokës» dhe «zotërues të rajasë», tregon se marrëdhënjet feudale, në sajë të përkrahjes së pushtetit feudal osman, po zhvilloheshin me ritme më të shpejta. Në këtë drejtim Pipëri na paraqit shembullin e parë të thellimit, në kushtet e reja, të procesit të feudalizimit që do të kryhet në shekullin e XVI edhe në krahinat e tjera malore të sanxhakut.

Ndërsa në krahinat e Pipërit dhe të Kuçit sundimtarët osmanë u përpoqën të zbatonin sistemin e timarit, në krahinat e tjera malore ata ndoqën një politikë të veçantë që u përshtatej më mirë kushteve lokale dhe njëkohësisht interesave të shtetit osman. Siç dëshmojnë të dhënat dokumentare të fundit të shekullit XV dhe të shekullit XVI, ata kishin caktuar jo më si florixhij, por si derbendxhij të gjithë malësorët e krahinave *të Hotit, të Pultit të sotëm, të Shalës, të Shoshit, të Nikaj-Merturit* (Petrishpan ili) dhe *të Kelmendit*.

Ndryshe nga vendet e tjera të pushtuara nga osmanët, në Shqipërinë e Veriut, gjejmë të ngarkuar me shërbimin e derbendxhiut jo vetëm banorët e fshatrave të veçanta siç veprohej zakonisht, por banorët e të gjitha fshatrave të krahinave të lartpërmendura që përbëjnë gadi krejt zonën malore të sanxhakut nga Hoti e Kelmendi në perëndim deri në Tropojë e Pejë në lindje. Sipas këtij statusi, malësorët duhet të kryenin shërbimin e ruajtjes të rrugëve kryesore që lidhnin krahinat bregdetare me krahinat lindore të sanxhakut. Kelmendasit kryenin shërbimin në dy rrugë: në rrugën që lidhte Shkodrën me Altun ilinë, duke kaluar përmes tokave që ishin dikur në zotërim të Pjetër Spanit, si dhe në rrugën që lidhte kalanë e Medunit me Plavën[88]. Hotjanët ruanin rrugën që lidhte Shkodrën me kalatë e Depedukenit dhe të Medunit, duke kaluar përmes krahinës së tyre[89]. Malësorët e Pultit të sotëm, të Shalës, të Shoshit, të Nikaj-Mërturit, ashtu si Kelmendasit, kryenin shërbimin e derbendxhiut për rrugën që lidhte Pejën, Kosovën e Novipazarin me Shkodrën dhe Podgoricën, duke kaluar përmes krahinave të tyre[90].

Malësorët derbendxhij duhej të ruanin shtigjet malore nga kalonin rrugët, të siguronin qarkullimin e lirë, duke vënë roje në çdo fshat, të mos lejonin të prekej jeta dhe pasuria e udhëtarëve, të ndërtonin ura, të hapnin grykat në kohën e dimrit etj.[91]

Përkundrejt këtyre shërbimeve malësorët ishin të falur zakonisht nga disa taksa në dobi të pushtetit qendror, të cilat nuk i paguanin kur qenë caktuar si florixhij; të tilla ishin detyrimet për divanin dhe taksat e jashtzakonëshme (*avarizi*

88) defter, f.204.
89) B.Djurdjev, *Iz istorije Crne Gore* ..., f,172; TK.A.defter nr.59, fl.115.
90) TK.A.,59, f.258.
91) B.Djurdjev, *Iz istorije Crne Gore*..., f.172; TK.A., defter nr.59, fl.115,258.



*divaniye ve tekâlifi örfiye*). Hotjanët ishin falur edhe nga e dhjeta e gjakut ose dhënia e fëmijve për jeniçerë (*yeniçer oglani*)[92].

Të dhënat dokumentare që i përkasin krahinave të Hotit dhe të Petrishpanilisë, e bëjnë të qartë rëndimin e shfrytëzimit feudal që sillte për malësorët vendosja e statusit të derbendxhijve, në krahasim me atë të florixhijve. Kështu p.sh. 169 shtëpi të fshatrave Tihomir, Mihaljani, Pobrezhani, Bozhani, Gegi, Lubicite të Hotit, të cilat më 1485 si florixhij paguanin vetëm 50 akçe për çdo shtëpi, më 1497 si derbendxhij jepnin 7417 akçe për ispenxhen dhe të dhjetat, d.m.th. 43,8 akçe për çdo shtëpi, pa përfshirë këtu taksën e dhenve dhe atë më kryesoren, taksën e xhizjes. Po kështu edhe malësorët e nahijes së Petrishpanilisë ishin detyruar të jepnin në formë qesimi përveç të drejtave zakonore (hukukî adiyeleri) dhe taksat e xhizjes dhe të badihavasë[93].

Në lidhje me këtë çeshtje duhet thënë se Kelmendasit bënin përjashtim, sepse e paguanin xhizjen e ispenxhen në formë qesimi, në një sasi shumë të vogël, duke qenë të falur nga taksa e së dhjetës. Në vend të 5435 akçeve që duhej të jepnin për ispenxhen dhe për të dhjetat e prodhimeve bujqësore, pa përfshirë këtu xhizjen, kelmendasit si derbendxhij do të jepnin vetëm 1000 akçe për ispenxhen dhe 1000 akçe për xhizjen (2000 akçe për 152 shtëpi, 25 beqarë e 7 të veja)[94].Përveç rëndimit të shfrytëzimit ekonomik, gjendjen e malësorëve derbendxhij e keqësonin edhe përpjekjet e sundimtarëve osmanë për të zbatuar sistemin e devshirmesë, gjë që kuptohet nga fakti se fshatrat e nahijeve të Hotit, të Plavës dhe të Izlarjekës -si një përjashtim-ishin falur nga detyrimi i dhënies së fëmijve për jeniçerë[95].

Në fakt dhe vetë ngarkimi i malësorëve me shërbimin e derbenxhiut, shërbim që nuk e kryenin më përpara si florixhij, ishte në thelb një rendim i shfrytëzimit feudal, ndonëse përkundrejt shërbimit ata ishin falur kryesisht nga detyrimet e divanit dhe nga taksat e jashtëzakonshme. Më përpara, si florixhij, ata nuk i paguanin këto detyrime.

Me gjithë rendimin e shfrytëzimit ekonomik, qeveritarët osmanë nuk mundën gjatë fundit të shekullit XV të përforconin pushtetin e tyre deri në atë shkallë sa të arrinin vendosjen e krahinave malore nën pushtetin dhe administrimin e drejtpërdrejtë të përfaqësuesve të tyre – të spahijve. Prandaj pronat e malësorëve

92) po aty.
93) Kjo thuhet shprehimisht qartë në një shënim të defterit të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1582, që bën fjalë për gjendjen e malësorëve gjatë gjysmës së parë të shekullit të XVI. Në të dëshmohet: «Nahija e Petrishpanilisë është një vend shumë i ashpër, malor dhe jopjellor. Ata [malësorët] kishin qenë të ngarkuar të hapnin në kohën e dimrit grykat që ndodhen në rrugën publike që vjen prej anëve të Pejës, të Kosovës dhe të Novipazarit për në anët e Shkodrës dhe të Podgoricës, të bënin ura në përrejtë që ndodhen aty dhe të ruanin rrugën mbretërore prej njerëzve, të cilët me çdo mënyrë mund ta dëmtonin atë. Përkundrejt këtyre shërbimeve, ata përveç xhizjes dhe badihavasë, kishin dhënë në formë qesimi sasinë vjetore që ishte shënuar në defterin e vjetër për të drejtat zakonore (hukukî adiyeleri) dhe kishin qenë të falur nga detyrimet e divanit dhe nga taksat e jashtëzakonëshme (avarizi divaniye ve tekâlifi örfiye). Meqenëse kanë në duart e tyre vendime perandorake të sulltanëve të mëparshëm, që dëshmojnë sipas mënyrës së mësipërme, kur u regjistruan rishtas, ju ngarkua atyre si dhe më parë shërbimi i mësipërm dhe sipas vendimeve perandorake që ata kanë në duar, të jenë të falur nga taksat që u janë falur deri tani dhe çdo fshat të japë në formë qesimi sipas mënyrës së mëparshme, të drejtat zakonore vjetore, aq sa mund të mbajë, përveç xhizjes dhe badihavasë. Me që kështu ishte shkruar në defterin e vjetër, edhe në defterin e ri u regjistruan si të ardhura të drejtat zakonore për çdo fshat aq sa mund të mbajë përveç xhizjes dhe badihavasë, duke i falur nga taksat që u ishin falur sipas defterit të vjetër». TK.A. nr.59, fl.258.
94) defter f.200-204.
95) TK.A., defter nr. 59, fl.258.

qëndruan ende të lira, duke u administruar në bazë të së drejtës zakonore, sepse si në periudhën kur ata ishin florixhij, edhe tani, kur u kthyen në derbendxhij, zotëruesi i tokave në fjalë (sahibi erz), sanxhakbeu i Shkodrës, nuk gëzonte mbi to të drejtën e tapisë. Renta feudale mbeti përsëri si një rentë shtetrore, e vjelë në formë të prerë – shprehje kjo e nivelit ende të ulët të zhvillimit të marrëdhënieve feudale. Si rrjedhim, derbendxhillëku, i zbatuar në viset e florixhijve, nuk shënonte asnjë hap përpara në vendosjen mbi fshatarët ish florixhij, të vartësisë personale ndaj tokës dhe ndaj personit të feudalit që përvehtësonte rentën e tyre d.m.th. ndaj sanxhakbeut të Shkodrës.

Duke u besuar detyrën për të mbrojtur rrugët që lidhnin viset bregdetare me pjesët e brendshme të vendit dhe të Ballkanit, sunduesit osmanë e linin kështu kontrollin e pjesës më të madhe të krahinave malore në duart e malësorëve, me përjashtim të qendrave ku kishin vendosur forcat e tyre ushtarake. Kjo u interesonte malësorëve sepse faktikisht kështu u njihej e drejta e vetqeverisjes; porse nga ana tjetër nuk duhet harruar se nëpërmjet kësaj politike sunduesit osmanë deri diku siguronin «qetësinë» e brendshme në vend dhe i vinin malësorët në shërbim të interesave të klasës sunduese.

Moszbatimi i sistemit të timarit në malësitë u shkaktua nga një varg faktorësh: në radhë të parë nga faktorët ekonomikë-socialë siç qenë niveli i ulët i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, d.m.th. diferencimi i pakët klasor, mbizotërimi i bashkësive fshatare dhe katuneve blegtorale si forma të organizimit shoqëror, vetadministrimi i tyre etj. Vëllazëritë dhe katunet jo vetëm që ruheshin të forta në malësi, por ndikonin në mbajtjen më këmbë të organizimit shoqëror mbi bazën e fisit edhe në zonat fushore me që këto popullohesin vazhdimisht nga fiset malësore, në radhë të dytë nga faktorët politikë siç qe qendresa e malësorëve etj.; përveç këtyre, një rol jo të parëndësishëm luajti edhe faktori gjeografik: karakteri malor i vendit dhe mungesa e tokave të përshtatshme për bujqësi.

Këta faktorë i detyruan qeveritarët osmanë të ndiqnin së pari rrugët dhe format e përdorura nga sunduesit e mëparshëm dhe më vonë të gjenin forma të përshtatshme për të thelluar shfrytëzimin dhe për t'i përdorur malësorët në dobi të tyre, siç qenë derbendxhillëku dhe marrja e malësorëve në shërbim ushtarak sipas sistemit të devshirmesë. Kjo tregon se përdorimi dhe rekrutimi i malësorëve si forcë ndihmëse e armatosur, ishin më të leverdisshme dhe më të realizueshme për sunduesit e rinj, se sa rëndëmi akoma më i madh i rentës feudale, i cili nuk mund ta kalonte cakun që lejonte prodhimi blegtoral e bujqësor i atjeshëm. Rëndimi i rentës tek derbendxhijt shkoi në përputhje me rritjen e prodhimit, me thellimin e diferencimit klasor në gjirin e malësorëve si dhe me fuqizimin e klasës feudale osmane të krahinave fushore të sanxhakut.

Të dhënat dokumentare që parashtruam zbulojnë në mënyrë konkrete gjendjen e krahinave malore dhe na japin të drejtën të konsiderojmë si një trajtim mjaft romantik pikëpamjet se malësitë në tërësi qëndruan si zona pak a shumë të izoluara dhe të shkëputura nga sundimi osman[96].

96) *Historia e Shqipërisë*, v.I, Tiranë 1967, f.348.



## III. TË DHËNAT ONOMASTIKE TË DEFTERIT DHE KARAKTERI ETNIK I POPULLSISË[97]

Deri më sot studjuesit e kanë përqëndruar vemendjen kryesisht në të dhënat e karakterit social-ekonomik që sjellin defteret e kadastres osmane, duke lënë mënjanë të dhënat mbi karakterin etnik të popullsisë që mund të nxirren nga burimet e këtij lloji.

Defteret kadastriale, duke qenë të hartuar për qëllime krejt të tjera, nuk japin të dhëna direkte për anën etnike, porse indirekt të dhënat e tyre onomastike lejojnë të nxirren konkluzione për këtë çështje. Siç dihet, për efekt të pagimit dhe të mbledhjes së detyrimeve feudale nga fshatarësia, eminët e kadastrës osmane ishin shumë të interesuar të regjistronin në defterë të hollësishëm (mufassal) emër për emër çdo fshat, çdo kryefamiljar, i cili në fakt përfaqësonte një vatër (hane) më vete, d.m.th. një unitet tatimor si dhe çdo beqar dhe çdo grua të ve. Si rrjedhim, edhe burimi që po botojmë, duke qenë defter i tipit të hollësishëm (mufassal), na sjell një pjesë të konsiderueshme të toponimisë dhe antroponimisë të krahinave të sanxhakut të Shkodrës në fund të shekullit XV. Këto të dhëna marrin një rëndësi të veçantë për studimin e anës etnike, veçanërisht për shtrirjen e elementit shqiptar në fund të shekullit të XV në krahinat skajore të sanxhakut të Shkodrës, të banuara si nga popullsi shqiptare ashtu edhe nga popullsi sllave; ato i përkasin jo vetëm zonave bregdetare, për të cilat nuk mungojnë informatat nga burime të tjera, por edhe zonave të brendshme. Vlera e tyre rritet gjithashtu nga fakti se janë dhënë në formë të plotë, jofragmentare dhe për çdo qendër banimi. Para se të parashtrojmë konkluzionet që mund të nxirren pas mendimit tonë nga të dhënat e këtij burimi për problemin në fjalë, po ritheksojmë edhe njëherë mendimin e përgjithshëm, të shprehur me kohë në literaturënhistoriografike, se përdorimi i të dhënave onomastike është mjaft i vështirë dhe nuk të çon gjithmonë në konkluzione të drejta, sepse është e pamundur të përcaktohet me saktësi të plotë se çfarë fshihet nga ana etnike, në një moment të dhënë, prapa një toponimi ose antroponimi. Megjithkëtë mendojmë se ato duhen shfrytëzuar duke u përpjekur për të eliminuar anët e dobëta, dhe duke i krahasuar me të dhënat e burimeve të tjera historike.

Kusht themelor për shfrytëzimin e vlerësimin e të dhënave onomastike të këtij burimi, mendojmë se është të vështruarit e tyre gjithmonë brenda kuadrit të rrethanave historike në të cilat ishin krijuar. Të nisur nga kjo, mund të themi se toponimia sllave që gjendet gjerësisht në krahinat e sanxhakut të Shkodrës, e ngulitur gjatë etapave të ndryshme që nga shekujt VI-VIII, pasqyron kontaktet historike të popullsisë shqiptare me sllavët, të kryera në periudha të caktuara, shumë kohë para shekullit të XV. Ajo nuk na jep pra mundësi të gjykojmë mbi simbiozën shqiptaro-sllave në këtë shekull, d.m.th. mbi problemin se çfarë popullsie kishin në shekullin e XV vendbanimet me një toponimi të tillë. Është e tepërt të themi se studimi i këtyre toponimeve përbën një problem të veçantë.

Ndryshe paraqitet puna me toponimet shqipe. Ato mund të përdoren me një farë sigurie si argumenta për të dëshmuar se vendbanime të tilla ishin troje të banuara nga shqiptarët, sepse ato në vetvehte dëshmojnë që aty popullsia e

97) Në mënyrë të hollësishme e kemi trajtuar këtë problem në tre artikuj të veçantë. Në ta është dhënë materiali burimor që shërbeu si bazë për nxjerrjen e pikëpamjeve që po parashtrojmë këtu. Shih: S.Pulaha, *Elementi shqiptar sipas onomastikës të krahinave të sanxhakut të Shkodrës në vitet 1485-1582*, I, II, III, në Studime historike nr.1,2 dhe 4, 1972.

vjetër vendase megjithë sundimin shumë shekullor të shtetit serb këtu, kishte mundur të qëndronte dhe t'i bënte ballë asimilimit nga ana e elementit sllav gjatë periudhës para shekullit XV.

Për përcaktimin e karakterit etnik të popullsisë mund të ndihmojë deri diku më mirë materiali antroponimik sepse antroponimia është më e lëvizëshme dhe pasqyron më mirë kushtet reale historike, ndryshimet shoqërore, ideologjike-fetare, dhe deri në një farë shkalle edhe ndryshimet etnike të ndodhura në periudhën së cilës i përket. Por studimi i gjendjes etnike nëpërmjet antroponimisë paraqet disa vështirësi:

Së pari është vështirë që grumbullin e madh të emrave të banorëve të regjistruar në defterin e lartpërmendur ta ndajmë saktësisht dhe në mënyrë të prerë në dy pjesë, në atë të përdorur nga popullsia shqiptare dhe në atë të përdorur nga popullsia sllave. Kjo është e pamundur për arësye se një sasi jo e vogël banorësh mbanin emra të cilët ishin të përbashkët për të dy popullsitë si p.sh. Nikolla, Andrea, Lazar, Gjorgj, Dimitër, Petr, Mihail ose Mihal etj.

Së dyti është e vështirë të ndiqet ngushtësisht kriteri se një banor me emër sllav është sllav dhe jo shqiptar ose e kundërta. Zakonisht në historiografinë kushtuar Shqipërisë, ky kriter është ndjekur në mënyrë absolute, duke vënë shenjën e barazimit midis antroponimisë dhe etnicitetit. Por një rrugë e tillë është e gabuar, mbasi kështu çeshtja gjykohet duke mos marrë parasysh kushtet konkrete historike dhe rrethanat politike-shoqërore dhe kulturale-fetare të periudhës të marrë në shqyrtim.

Siç dihet, për katër shekuj rrjesht (shek.XI-XIV), me shumë pak ndërprerje, krahinat e Shqipërisë veriore qëndruan nën sundimin e feudalëve serbë të shtetit të Dioklesë dhe të Rashës, duke bashkëjetuar politikisht dhe ekonomikisht në këtë kuadër shtetëror me popullsi sllave[98]. Kjo është edhe arësyeja kryesore pse në sanxhakun e Shkodrës nën sundimin osman gjejmë të bashkuara po ato toka që dikur kishin qenë përfshirë brenda kufijve të këtyre shteteve. Në këto kushte historike, kur klasa sunduese në shumicën e saj ishte sllave, shpjegohet edhe epërsia dhe mbizotërimi i saj politik dhe fetar mbi elementin shqiptar në krahinat e përfshira në shtetin e tyre, në një kohë kur procesi i zhvillimit të një klase feudale shqiptare nuk kishte arritur deri sa t'i lejonte asaj të formonte në këtë teritor shtetin e vet feudal, me një kishë të veçantë dhe autonome si tek sllavët; këtu duhen kërkuar edhe arësyet për ndikimin sllav në antroponiminë e elementit shqiptar. Në këto rrethana ishte shumë më lehtë që një shqiptar të merrte emër sllav se sa një sllav të merrte emër shqiptar. Pra mund të thuhet pak a shumë me siguri, se me emra shqiptarë mbahej vetëm popullsia shqiptare. Po kështu edhe ata banorë që në burimin në fjalë përmenden me emra shqiptarë dhe mbiemra sllavë ose anasjelltas, në këto kushte duhet të konsiderohen shqiptarë. Nga ana tjetër është vështirë të mendohet se nën antroponiminë shqiptare fshihej elementi sllav, veçanërisht kur është fjala për zonat qendrore të sanxhakut, larg teritoreve me popullsi kompakte sllave. Megjithëkëtë, në zonat e kontaktit midis të dy popullsive nuk mund të përjashtohet kategorikisht mundësia që nëpërmjet lidhjeve martesore një sllav të merrte një emër shqiptar. Por kjo mundësi ishte e kufizuar ende në shekullin XV nga lidhjet e forta të gjakut, që ruheshin në organizatat blegtorale shqiptare, në katunet si dhe në fshatrat që në shu-

98) K.Jireček-J.Radonić, *Istorija Srba*, Beograd 1952, prva knjiga, f. 121-125, 135, 188, 190, 193, 201, 211-227; *Historia e Shqipërisë*, v.I. Tiranë 1967, f.175-176, 192, 204-207.



micën e rasteve përbënin një bashkësi. Në një shoqëri të tillë patriarkale nuk mund të hynte elementi mashkull si pjestar i fisit ose i bashkësisë.

Sidoqoftë, me gjithë vështirësitë, gjerësia e të dhënave antroponimike që sjell ky defter, lejon nxjerrjen e disa përfundimeve. Krahas tij ekzistojnë edhe defterët e regjistrimit për krahinat e tjera fqinje të sanxhaqeve të Dukagjinit, të Ohrit, të Malit të Zi (shek. XVI), si dhe të Kosovës (Vilkili-1455). Kjo jep mundësi të krahasohet antroponimia e banorëve të këtyre krahinave e të dallohet deri diku ku kalonte vija ndarëse midis trevës ku banorët mbanin kryesisht antroponimi shqiptare dhe trevës ku banorët mbanin antroponimi sllave, dhe ku kishte antroponimi të përzier, të dallohen gjithashtu emrat e përdorur dhe emrat e papërdorur nga sejcila popullsi. Kjo gjerësi e të dhënave onomastike jep mundësi të nxirren deri diku me një farë saktësie disa konkluzione interesante në lidhje me gjendjen etnike në këto krahina gjatë fundit të shekullit XV.

Po t'i hedhim një vështrim antroponimisë së banorëve të regjistruar në defterin e sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, do të dallojmë tri zona:

1. Në zonën e parë bëjnë pjesë krahinat e përfshira në nahijet e Shkodrës, të Drishtit, të Bregut të Këndejmë, të Bregut të Përtejmë, të Shestanit (krahina e Anamalit), të Krajnës, të Merkodit, të Zhabjakut, të Petrishpanit, të Kelmendit, të Hotit dhe të Kuçit. Banorët e këtyre krahinave, nënkuptojmë kryefamiljarët, beqarët dhe gratë e veja, të gjithë ose në shumicën dërmuese të tyre mbanin antroponimi thjesht shqiptare. Të tillë ne kemi konsideruar emrat tipikë për popullsinë shqiptare si Gjin, Gjon, Leka, Kola, Gega, Progon, Tole, Lesh (Llesh), Bardo, Kolsh, Gjec, Tanush, Bushat, Lulo, Mazarak, Pal, Duka, Kal, Ulk, etj. Në 55 fshatra banorët mbanin onomastikë thjesht shqiptare pa asnjë influencë të onomastikës sllave, e madje pa emra të sferës së onomastikës fetare orthodhokse. Krahas tyre, gjenden afro 113 vendbanime ku kryefamiljarët mbanin në shumicën dërmuese të tyre emra tipikë shqiptarë, kurse një pakicë mbante kryesisht antroponimi të përzier shqiptaro-sllave, si bie fjala emrin shqiptar dhe mbiemrin sllav ose anasjelltas, po dhe antroponimi thjesht sllave ose antroponimi të sferës fetare ortodokse. Ndikimi i onomastikës sllave rritet më shumë, duke kaluar nga krahinat qendrore, të brendshme, në krahinat kufitare veri-lindore dhe veri-perendimore të sanxhakut. Kjo konstatohet më tepër në emrat e brezit paraardhës. Numri i banorëve me antroponimi joshqiptare është më i pakët në fshatrat e nahijeve të Petrishpanit, të Shkodrës, të Drishtit të Bregut të Këndejmë, të Bregut të Përtejmë, dhe vjen duke u rritur në krahinat kufitare si ato të Krajnës, të Merkodit, të Shestanit, të Zhabjakut, të Kuçit, të Kelmendit dhe të Hotit. Vetëm në një numër të vogël fshatrash (gjithsej 13) banorët mbanin në shumicën e tyre antroponimi sllave. Këto gjenden më tepër në nahijen e Zhabjakut (gjithsej 9).

Nuk ka dyshim se banorët e kësaj treve, me përjashtim të atyre pak fshatrave ku mbizotëron antroponimia sllave, kanë qenë krejtësisht shqiptarë, duke menduar se në kushtet historike të njohura në të cilat qe detyruar të rronte popullsia shqiptare, një antroponimi e tillë shqip mbahej vetëm nga ajo dhe jo nga popullsia sllave. Lidhjet farefisnore që mund të hetohen midis banorëve me antroponimi shqiptare dhe atyre me antroponimi sllave tregojnë se edhe ajo pakicë banorësh me antroponimi sllave që gjendet në këtë zonë, ishte në fakt shqiptare.

II. Në zonën e dytë bëjnë pjesë krahinat e përfshira në nahijet e Fipërit, të Shestanit (pa krahinën e Anamalit) dhe të Altun-ilisë ku thuajse gjysma e sasisë së banorëve mbanin antroponimi shqiptare. Banorët me emra shqiptarë përbënin pjesën më të madhe të popullsisë në shumicën e fshatrave, kurse banorët me antroponimi sllave popullonin pakicën e fshatrave. Megjithkëtë fakti që kjo pakicë

fshatrash kishte popullsi më të dendur, ka sjellë si rrjedhim që numri i banorëve me emra sllave dhe me emra të sferës fetare ortodokse, të përdorura nga të dy popullsitë, të jetë në këtë zonë më i madh.

Mbajtja e antroponimisë shqiptare nga afro gjysma e numrit të banorëve të kësaj zone si dhe popullimi prej tyre i pjesës më të madhe të fshatrave dëshmojnë se këto krahina ishin në shumicën e tyre troje të banuara prej shqiptarësh. Këta duhet të kenë përbërë aty shumicën e popullsisë.

Pra në të dy zonat e para kemi një bërthamë me antroponimi të pastër shqiptare, të depërtuar nga një shtresë e përbërë prej vendbanimesh ku mbizotëronte antroponimia shqiptare, me ndikime të antroponimisë sllave, si dhe prej disa pikave të huaja në periferi, të formuara nga vendbanimet e pakta me banorë që mbanin kryesisht emra sllavë.

III. Zona e tretë nga pikëpamja onomastike përbëhet nga ato krahina ku banorët mbanin tërësisht ose në shumicën e tyre onomastikë thjesht sllave siç janë fshatrat e nahijeve të Podgoricës, të Bjelopavliqit, të Izlarjekës, të Plavës, të Komaranit, të Komninit, të Pejës dhe të Suhogërlës. Antroponimi sllave kemi konsideruar emrat e njohur sllavë, karakteristikë për sllavët e jugut, si Bozhidar, Stepan, Milosh, Dabzhiv, Gjuro, Vuk, Vlad, Bogdan, Nenko, Branko, Brajan, Dobrosh, Rajko, Rada, Miliç, Tihomir, Radonja, Radosllav, Mladen, Zhivko, Radiç etj. Përveç këtyre, në këtë zonë ndeshen në një numër të madh fshatrash banorë që mbanin kryesisht onomastikë të përzier shqiptaro-sllave ose edhe thjesht shqiptare[99]. Ky element gjendet shumë i rallë në krahinën e Bihorit në Hercegovinën jugore, por vjen duke u shtuar sa më shumë zbritet në jugë, në Plavë-Podgoricë ose në jugë-lindje, në Pejë dhe Suhogërlë. Elementi shqiptar në antroponimi është i pakët dhe asnjëherë nuk përbën shumicën e banorëve, as edhe në ndonjë fshat të nahijeve të Komninit, të Komaranit, të Plavës, të Bjelopavliqit, të Izlarjekës, të Podgoricës dhe të Suhogërlës. Në nahijen e Pejës elementi shqiptar në antroponimi gjendej në një sasi më të madhe, duke arritur të përbënte shumicën dërmuese të popullsisë në 15 fshatra. Të tillë ishin fshatrat Oça (Uça), Çirna Potok, Dujak, Usak (Osak), Dobriçadol, Kovaliça, Lepovaç, Breloniça ose Djavica, Trenova, Kotrova Zramniku ose Nika, Shumeniça, Vraniq, Kraçor, Romaniça, Lezibaba[110]. Por elementi shqiptar në antroponimi nuk ishte kaq i kufizuar, sepse gjendej në afro gjysmën e vendbanimeve të nahijeve të lartpërmendura, por në një sasi të pakët[111]. P.sh. gjendej në 86 fshatra nga 194 fshatrat e nahijes së Pejës, në 14 fshatra nga 28 fshatrat e nahijes së Suhogërlës dhe në 12 fshatra nga 15 fshatrat e nahijes së Plavës.

Këto të dhëna dëshmojnë për një prani të rëndësishme të elementit shqiptar në këtë zonë. Më i dendur ky element gjendej në nahijen e Pejës. Ekzistenca e shqiptarëve në këto krahina në fund të shekullit XV, fill me pushtimin osman, kur ende nuk kishin filluar të vepronin faktorë të rinj të lidhur me këtë pushtim, presupozon se këta duhet të kenë qenë aty banorë vendës qysh prej kohësh. Këtë mendim e mbështetin edhe të dhënat që gjenden në krisobulat e car Stefan Dushanit lëshuar manastirit të Shën Mëhillit dhe Gavrilit (1348-1353) në Prizren, të cilat dëshmojnë për ekzistencën e 9 katuneve shqiptarë në një zonë të afërt me krahinën e Pejës, siç është ajo e Prizrenit[112] Praninë e shqiptarëve në zonat

99) Gjendet edhe element vllah, por me pakicë.
110) Shih në defter sipas radhës f.440-442, 446, 463-465, 469, 6-7, 9, 55-56, 61-63, 67.
111) Shih S.Pulaha, Elementi shqiptar ..., f. 73-74,
112) S.Novaković, *Zakonski Spomenici*, Beograd 1912, f.682–701; *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, v.II, Tiranë 1962, f. 143-145.



perëndimore, në Zetë, në periudhën para pushtimit osman e ka vënë në dukje me kohë M. Shufflaj. Ai me të drejtë i ka cilësuar grumbujt kompaktë të shqiptarëve që gjendeshin në afërsitë e Raguzës dhe Kotorrit në shekullin e XIII si mbeturina ilire autoktone, të shkëputura nga bërthama shqiptare[113], dhe ka zbuluar «përhapjen e fortë të gjakut shqiptar në Zetë», të dëshmuar nga emrat e disa vëllazërive të vjetra të Zetës si të Matagushëve, Mahinëve, Malonshiqëve (Malonsi), Matarugëve e Golemadhëve etj.[114] Për mbizotërimin e elementit shqiptar në krahinat perëndimore të sanxhakut të Shkodrës, si në ato të Merkodit, të Krajnës, të Shestanit, të Zhabjakut, të Kuçit, të Pipërit (1497), tërthorazi le të kuptohet edhe fakti që në regjistrimet e popullsisë të sanxhakut të Malit të Zi gjatë shekullit XVI ndeshen jo vetëm toponime shqipe si për fshatrat Golemat, Lazër (Lazor), Gjegjëza (Gegëza), Ber, mëhalla Leshoviq në nahijen e Malonshiqit, Arbanas, Selo Kuqi ose Zllatari[115], Leshni Desiq, Leshnan Staneviq, mëhalla Gorlo Koka dhe Leshoviq të fshatit Kosiq, Dodsh, Drekshiq, Malsiq etj.[116], por edhe një numër banorësh me emra thjesht shqiptare si Gjon, Lesh, Bard, Koja, Duka, Leka, Progon, Bulk etj., pothuajse në çdo nahije të Malit të Zi. Nga ana tjetër këto të dhëna konfirmojnë pikëpamjen e Shufflajt se vendosja e sllavëve kishte rënë mbi popullin shqiptar si një sëpatë që i kishte prerë në veri dhe në jugë disa degë të trungut, dhe e kishte ngushtuar brenda një qarku më të vogël[117].

Nga të dhënat e mësipërme del se numri i banorëve me antroponimi sllave ishte më i vogël në krahinat e brendshme të sanxhakut dhe vinte duke u rritur në krahinat kufitare si të Pipërit, të Zhabjakut, të Merkodit, të Krajnës, të Altunilisë, deri sa në krahinat më skajore të cilat ne i përfshimë në zonën e tretë, arrinte të përbënte shumicën e popullsisë. Përcaktimi me saktësi i përkatshmërisë etnike të kësaj popullsie paraqet vështirësi për arësye se një numër i konsiderueshëm i banorëve mbanin emra, të cilat i ndeshim si tek popullsitë shqiptare ashtu edhe tek ato sllave si p.sh. Nikolla, Andrea, Lazar, Gjorgj, Dimitër., Petr, Mihail, Mihal etj. Përveç asaj lind menjëherë pyetja e rëndësishme metodologjike në se mund të zbatojmë për përcaktimin e karakterit të popullsisë kriterin antroponimik d.mth. të supozojmë se çdo banor me emër sllav ishte sllav. Të dhënat që na sjell ky burim tregojnë se do të ishte gabim të vinim shenjën e barazimit absolut midis karakterit onomastik dhe karakterit etnik në këto zona, sepse kështu nuk do të merreshin parasysh kushtet historike në të cilat pat qenë e detyruar të rronte popullsia shqiptare. Shembujt që mund të nxirren nga burimi në fjalë dëshmojnë se në krahinat kufitare të sanxhakut të Shkodrës antroponimia që mbanin shqiptarët e kishte humbur karakterin e saj etnik të dalluar. Nga materiali i regjistrit del se ndikimi sllav u shpreh jo vetëm në toponomastikën e tokave shqiptare, por në një shkallë jo më të vogël edhe në antroponiminë, pra në një fushë ku mund të çante rrugë lehtë në kushtet e sundimit të gjatë feudal serb. Ky ndikim duket më qartë në zonat kufitare, në troje të banuara nga këto dy popullsi. Në këto zona elementi shqiptar në një

113) M. Šufflay, *Povijest sjevernih arbanasa*, f.61, në *Historija e shqiptarëve të veriut, Serbët dhe shqiptarët*, Prishtinë 1968.
114) M. Šufflay, *Povijest sjevernih arbanasa*, f. 61-62,
115) B.Djurdjev, *Dva deftera Crne Gore...* defter i nxjerrë nga BV.A. Tapu defterleri, nr.106, f.4v-5, 6v-7, 7v-8, 8v-9, 11v-12, 28v-29, 34v-35.
116) Defteri i regjistrimit të Malit të Zi (bënte pjesë në sanxhakun e Dukagjinit) të vitit 978 h./1570-71; BV.A., Tapu defterleri, nr.499, f.304-306, 322, 366-367, 398.
117) M. Šufflay, *Biologie des albanischen Volksstammes*, në Ungarische Rundschau für historische und soziale Wissenschaften, V.Jahrgang, 1.Heft, s. 12.

masë të madhe u vesh me emra sllavë. Defteri që po botojmë sjell të dhëna të shumta për këtë çeshtje. Kështu, në të gjitha krahinat ndeshim raste të shumta, të cilat tregojnë se pjestarët e një familjeje, e cila nga emra të tjerë identifikohet si shqiptare, mbanin edhe emra sllavë. P.sh. në fshatin Pantalesh të Kuçit përmendet si banor Vukaçi, i biri i Lula Loparit, ose në fshatin Brokina përmenden Zhivko dhe Pejash, të vëllezërit e Gjergjit të birit të Kolës (f.296) ose Bogdan Shqiptari, (arnavut), Nenko Shqiptari (arnavut), Drago Arbanasi, Nenada i biri i Arbanasit në fshatrat Tudorihoçi, Dolina Petriç, Netrobishta, Slojani të nahijes së Pejës (f.23,44,447, 462-463). Raste të tilla gjenden me dhjetra.

Ndikimin sllav në antroponimi e gjejmë të shprehur edhe në një varg emrash shqiptarë me përshtatje sllave, të përdorur veçanërisht në zonat e kontaktit midis popullsisë shqiptare dhe asaj sllave. Të tillë p.sh. janë emrat Lekaç. Lakaç, Lekashin për Leka; Nikaç, Nikashiza për Nika; Nokaç për Noka; Gjonça, Gjonaç, Gjonko, Gjonçiq, Gjonoviq për Gjon dhe Gjonajt; Ukça për Uk: Kolaç, Koliq për Kola dhe Kolajt; Dukaç, Dukoi për Duka; Lleshoviq për Lleshajt; Progonaç për Progon; Dedaç, Dedaq për Deda; Laliç për Lalajt, Luliç për Lul; Kojadin për Koja; Gjokaç, Gjokoviq për Gjoka dhe Gjokajt; Prekça, Prekoviq për Prek dhe Prekajt; Gjiniç, Gjinash për Gjin; Ulkash për Ulk, Malçin për Mal; Lumç për Lum; Krojashin për Kroja; Miraç për Mira; Ugjlesha, Uglesha, për Uk Lesha, emër kompozite si Pantalesh-Panta Leshi, të cilin e gjejmë si toponim në Kuç etj.[118]

Për të ilustruar faktin se elementi shqiptar në përgjithësi kishte huajtur emra karakteristikë sllavë, po sjellim disa shembuj akoma në shprehës. Sipas të dhënave të defterit në fjalë, gjejmë në zonën fushore të krahinës së Shkodrës një varg fshatrash që janë të banuar krejtësisht ose në shumicën e tyre nga pjestarët e një fisi shqiptar, kryepari i të cilit i ka dhënë emrin e vet edhe fshatit. Në të tillë vendbanime, ku lidhjet e gjakut ishin ende shumë të forta, më të forta se lidhjet teritoriale, gjejmë edhe antroponimi sllave për degët, kunorët që kishin rrjedhur nga kryepari i fisit me emër thjesht shqiptar. Kjo jo vetëm nuk do të thotë se bijtë, pasardhësit e atij kryepari ishin sllavë, por vërteton edhe se antroponimia sllave që përdorin pjestarët e këtij fisi shqiptar nuk kishte ardhur si rezultat i një simbioze midis shqiptarëve dhe sllavëve, por si pasojë e ndikimit të faktorëve politikë dhe fetarë gjatë periudhës së sundimit serb në këto toka. Kështu p.sh. në fshatin Reç të Shkodrës, i cili ka marrë emrin e një kryepari të quajtur me emrin Reç, banonin vetëm djemt e tij Gjorgji, Kola, Vuku, Nika, Deshardhi, Gjergji dhe Prosha (Prusha)[119]; ose në fshatin Petr Shiroka, që ka marrë emrin e kryeparit të një bashkësie familjare të quajtur Petr Shiroka, përmenden kunorët e rrjedhur prej tij: Prift Shiroka, Stepani, Gjini, Petri, Stepani (tjetër) dhe Gjergji. Të gjithë mbajnë mbiemrin Shiroka[120] Të njëjtin fenomen vërejmë edhe në fshatrat Mihalina (nga Mihal), Tihomir të nahijes së Kuçit[121] dhe Mglush Prekal e Prela të nahijes së Shkodrës. [123]

Një rast analog ndeshim edhe në organizatat blegtorale të pateritorializuara ose edhe në ato të sapoteritorializuara – në katunet shqiptare. Shëmbullin

118) Përshtatja sllave e emrave shqiptarë dhe në përgjithësi ndikimi sllav mendojmë se paraqitet në këtë defter më i zmadhuar se ç'ka qenë në realitet për arësye se shkruesi i defterit, siç e thamë më lart, duhet të ketë qenë me prejardhje sllave.
119) defter, f.146.
120) defter, f.319.
121) defter, 303-304.
123) defter, f.141, 160, 167-168.



më tipik në këtë drejtim e paraqet «*katuni arbanas*» me në krye Ljesh Tuzin, i njohur në dokumentacion qysh në vitin 1335[124], të cilin pas 150 vjetëve d.m.th. më 1485 e gjejmë të shpërndarë dhe të ngulitur si vëllazëri në 11 fshatra të emërtuara me emrin e kryeparit Tuz, gjë që kishte ardhur si pasojë e shtimit të degëve të fisit[125]. Në këtë vëllazëri shqiptare, pjesërisht orthodokse[126], nuk mungonin fashmë edhe pjestarë me emra sllavë ose emra të përzier shqiptaro-sllavë.

Të njejtin fenomen ndeshim në katunet e krahinave të Kelmendit dhe të Pipërit, siç janë katunet *Liçeni* në fshatin Selçisha, katunet *Gjonoviq*, *Leshoviq*, *Muriq* e *Kolemadi* në fshatin *Çpaja*, si dhe katunet *Bukmir*, *Bushat* dhe *Dirnoviça*[127], në fshatrat Istrahaliq dhe Dirnoviça të Lushkozhupës[128] në Pipër, të cilat u regjistruan dhe u njohën pushtetin osman së bashku me Kelmendin në vitin 1497. Megjithëse katunet janë shqiptare, siç tregon onomastika thjesht shqiptare që mbizotëron si në emrat e katuneve, ashtu dhe në ato të banorëve, ndeshim edhe antroponimi sllave ose përshtatje sllave të emrave shqiptarë[129]. Bile ky ndikim shprehet në emrat e kryeparëve të katuneve (*kaznes*) si p.sh. Rabjani, i biri i Kolës në katunin Liçeni; Stepani, i biri i Ulgashit në katunin Muriq; Radiçi i biri i Lazarit në katunin Bukmir dhe Nikaçi, i biri i Pashjës në katunin Bushat; ose në vetë emrat e katuneve, siç janë katunet *Gjonoviq* për *Gjonajt*, *Leshoviq* për *Leshajt*[130], ashtu si ndodh me katunet shqiptare në zonën e Prizrenit; *Gjinovci*, *Flokovci*, *Çaparçi*, *Gjonovçi*, *Shpinadinci*[131] për *Gjinajt*, *Flokajt*, *Çaparët*, *Gjonajt*, *Shpinadinët*[132]

Nga shembujt që sollëm më sipër del se veshja me antroponimi sllave e banorëve të një fshati ku lidhja e gjakut ishte e fortë, sepse në të bananin vetëm pjestarët e një fisi shqiptar, ose e pjestarëve të bashkësive blegtorale shqiptare, të katuneve, ku lidhjet e gjakut ishin akoma më të forta, dëshmon jo vetëm që banorët e tyre ishin shqiptarë, pavarësisht nga fakti se mbanin emra sllavë, por

124) M. Šufflay, *Povijest sjevernih arbanasa*, f.62, K.Jireček, *Skutari und sein Gebiet im Mittelalter*, në Illyrisch-Albanischen Forschungen, I, f.100.
125) Më 1485 vëllezëria e Tuzëve gjendet e vendosur në disa fshatra që ruanin ende emrin e fisit nga rridhnin si: Damniç Tuz, Bgur Tuz, Kuqik Tuz, Istulush Tuz, Petrashani Tuz, Pistull Tuz (i braktisur), Gjon Tuz (truallishte), Gradec Tuz, Shukovik Tuz, Tuz dhe Podol Tuz. (Shih defterin f.341-344, 143-144, 156, 164-165, 175). Zgjerimi dhe shtimi i madh i kunorëve në fisin e Tuzëve duhet të jetë bërë me kohë, përderisa me 1485 banorët e fshatrave ku u ngulit vëllazëria mbanin kryesisht mbiemra të ndryshëm, me përjashtim të shumë pak familjeve që kishin ruajtur mbiemrin Tuz. (Shih defterin f.343-344, 156-157, 164-165)
126) Në fshatin Damniç Tuz përmendet një Pop Martini. Shih defterin f. 341.
127) Katuni Dirnoviça ishte katun shqiptar, pavarësisht se mban emër sllav. Për këtë dëshmon jo vetëm antroponimia shqiptare që mbanin banorët e këtij katuni, por edhe një shënim i defterit sipas të cilit ky katun dikur ishte vendosur në fshatin Brestica dhe prej andej u shpërngul në mëhallën Dirnoviça të Lushkozhupës, prej nga mori dhe emrin e vet. Ky shembull tregon se në një rrugë të tillë duhet të kenë marrë emra sllave edhe katunet e tjera shqiptare, siç është rasti p.sh. i katuneve Bjellogllavci ose Novaci të Prizrenit. Shih defterin f. 199-200.
128) defter, f.197-200.
129) Ndikimi i antroponimisë sllave në katunet shqiptare të Pipërit është më i madh se në katunet e tjera shqiptare.
130) defter, 197-199, 200-204.
131) S.Novaković, *Selo*, Srpska knishevna zadruga, Beograd, 1943, f. 278; R.Ivanović, *Katunska naselje na manastirskim vlastelinstvima*, në Istoriski časopis, knjiga v, 1954-1955, f.400; *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, Tiranë 1962, v.I, f.147.
132) Të njëjtën gjendje gjejmë dhe në disa katune të tjera shqiptare, për të cilat nuk jepen emrat e tyre të origjinës, në fshatrat Lushkozhupa, Drezka, Dobriqo, Beliça, Reçiça, dhe Istrahaliq (grupi i banorëve që ka si kryepar Vukun, të birin e Gjorgjit). (Shih defterin f.189-196)

dhe se antroponimia sllave, veçanërisht ajo që gjejmë në krahinat e brendshme të sanxhakut të Shkodrës, d.m.th. në zonën ku mbizotëronte onomastika shqiptare, nuk kishte depërtuar sepse bashkëjetonin shqiptarë me sllavë, por kryesisht në sajë të ndikimit të faktorëve politikefetare gjatë kohës së sundimit serb. Për këtë na bind dhe fakti se ndikimin e antroponimisë sllave nuk e ndeshim vetëm në pak vendbanime, si ishuj midis një ambienti kompakt shqiptar, gjë që do të na çonte në mendimin se këto mund të ishin enklave me popullsi sllave, por atë e gjejmë me pakicë, të shpërndarë në një shumicë fshatrash p.sh. në 42 fshatra të nahijes së Shkodrës, në 22 fshatra të nahijes së Petrishpanit, në 9 fshatra të nahijes së Drishtit etj. Nga ana tjetër, kjo pikëpamje nuk mund t'u përshtatet zonave kufitare të kontaktit midis popullsisë shqiptare dhe sllave, ku simbioza luante me të vërtetë një rol të rëndësishëm në përhapjen e antroponimisë sllave. Në këtë drejtim rastin më tipik për shekullin XV e paraqet krahina e Pipërit, ku ishin ndërthurur tre elementë: shqiptar, serb, dhe vllah. Ndërmjet këtyre, me ardhjen e katuneve shqiptare, vendin kryesor e zinte elementi shqiptar (shih regjistrimin e vitit 1497). Duke u larguar nga zonat kufitare, roli i këtij faktori në përhapjen e antroponimisë sllave, dobësohet, deri sa zhduket krejtësisht në krahinat e brendshme.

Huajtja nga elementi shqiptar i emrave karakteristikë sllavë është një fenomen që ndeshet edhe në zona të tjera jashtë sanxhakut të Shkodrës. Shembullin më të qartë në këtë drejtim e jep një nga regjistrimet e vilajetit të Kërçovës (Kërçevo) në fundin e shekullit XV. Sipas një defteri të këtij vilajeti, që i përket kohës së sundimit të Bajazitit II[133], popullsia e vetë Kërçovës ishte regjistruar në këtë mënyrë: në fillim jepet popullsia (cemaat) myslimane e ndarë në mëhallën e xhamisë dhe në mëhallën e hamamit të Sinan beut. Pas kësaj gjendet e regjistruar popullsia e krishterë e ndarë në dy mëhalla: në mëhallën e serbve (serf) dhe në mëhallën e shqiptarëve (arnavut). Po të vërejmë emrat e banorëve të mëhallës, e cila në dokument cilësohet si lagje e banuar nga të krishterë shqiptarë, del se shumica e emrave të tyre nuk janë shqiptarë, por sllavë.

Duke u nisur nga kushte të tilla, është me vend të nxjerrim konkluzionin se shqiptarët duhen kërkuar edhe midis banorëve që mbanin antroponimi sllave, veçanërisht në ato fshatra, ku, ndonëse me pakicë, gjendet element me antroponimi shqiptare. Shembujt që dhamë më lart për përdorimin nga shqiptarët të emrave sllave, tregojnë nga ana tjetër se në kushtet historike në të cilat pat rrojtur popullsia shqiptare vetëm fakti se emrat i përkasin sferës së onomastikës sllave, nuk mund të shërbejë si kriter absolut për të përcaktuar si sllave karakterin etnik të kësaj popullsie. Rrjedhimisht sasia e elementit sllav në të vërtetë duhet të ketë qenë mjaft më e vogël nga sasia e personave që mbanin emra sllavë. Pra raporti midis të dy popullsive, asaj shqiptare dhe sllave në këto zona, nuk mund të jetë i barabartë me raportin që shprehet në onomastikë.

Po kështu, nuk mund të shërbejë si kriter absolut për të përcaktuar si sllave karakterin etnik të popullsisë as edhe parimi i ndjekur në mënyrë aqë koseguente nga historiografia e huaj për Shqipërinë, se çdo fshat me toponimi sllave paska qenë edhe gjatë shekullit XV truall i populluar nga banorë sllavë. Kjo kundërshtohet nga fakti se në këtë burim ndeshim të regjistruar një numur jo të pakët fshatrash me toponimi sllave dhe me banorë shqiptarë, gjë që provohet nga fakti se shumica e tyre mbanin antroponimi të pastër shqiptare. Vendbanime të tilla janë p.sh. fshatrat Brokina, Radona, Stani të nahijes së Kuçit; Tihomir, Mihalina, Pobrezhan, Lubice, Vidagi të nahijes së Maleve të Hotit; Gorica, Bobod, Mokrili të nahijes së Maleve të Shestanit, Grava, Pazari Lepoviça, Hrasto, Radina të nahijes së Petrishpanit; Nikshiq ose Psogllav, Dobranica, Bratoran, Dobri, Podgora të nahijes së Shkodrës; Dobriqo, Beliça, Brestiça, Moraçiça, Reçiça, Istrahaliq, Dirnoviça, Drezka ose Zavala të nahijes së Pipërit më 1497[134]; Oça (Uça), Çirna Potok, Dujak, Magjrica, Usak (Osak), Dobriçadol, Kovaliça, Lepovaç, Breloniça ose Djaviça, Trenova, Shumeniça, Vraniq, Kraçor, Lezibaba të nahijes së Pejës; Morina, Gorna Çirna Gonja, Dolina Çirna Gonja, Peronja, Rodosh, Dolina Bugjani, Bozhani, Vuçidol, Dobrosh Bujuk, Dobrosh Kyçyk, Sredna Çirna Gonja, Brankofiç, Trenova, Vagova, Goranica, Shishmançi, Popovici të nahijes së Altun Ilisë; Dajbaba, Stasaliq, Golubovça, Zhaborova, Brisaliq, Plavnica, Gruda të nahijes së Zhabjakut etj.[135].

Këto të dhëna dëshmojnë se popullsia shqiptare i kishte qëndruar dhe i kishte bërë ballë simbiozës me popullsinë sllave që ishte vendosur qysh prej kohësh pavarësisht nga fakti se toponimia shqiptare, duke mos e përballuar dot ndikimin sllav, ishte zëvendësuar me toponimi sllave. Ato na bindin se toponimia e këtushme sllave pasqyron kontakte historike të ndodhura midis shqiptarëve e sllavëve qysh shumë shekuj më parë dhe se nuk mund të ketë ardhur tërësisht si rezultat i dyndjes së popullsisë sllave në mesjetën e hershme, sepse kështu mohohen rastet kur emërtimet janë apelative të leksikut të shqipes, si dhe mundësia e vendosjes së toponimeve sllave edhe për shkak të ndikimit të faktorëve të tjerë të karakterit politikfetar, të cilët vepruan për një kohë të gjatë, ose për shkak edhe të ndryshimeve etnike që mund të kenë ndodhur deri në shekullin XV. Fakti se në shekujt XV-XVI gjejmë për shumë fshatra dy toponime, njeri shqiptar e tjetri sllav, siç janë p.sh. Bardon-Belan[136], Selo kuq ose Zllatar[137], Shëngjin-Rasha, Kotrova Zramniku ose Nika, Arnija ose Stajgoviq, Bgur Tuz ose Klaka, -Rash i vogël (küçük) ose Bukshi, Romeshta ose Maliçor, Shtyll ose Dragush (në nahijen e Shkodrës), Dolina Prekala ose Zahaç, Gorna Prekala ose Dujak, Bardoniq ose Zym, (në nahijen e Pejës)[138] etj., na bind se parimi i mësipërm nuk mund të zbatohet në mënyrë absolute as edhe për periud hat e mëpëparshme

\+
\+ \+

Në të njejtat konkluzione lidhur me praninë e shqiptarëve në trevat skajore të sanxhakut të Shkodrës na çojnë edhe disa informata që kanë të bëjnë me gjendjen kishtare të këtyre krahinave. Po të mbështetemi në to, bëhet e papranueshme pikëpamja e shfaqur nga Jireçeku se shqiptarët në veri duheshin identifikuar

133) Top–Kapi müzesinin arşivi, defter nr.7933, f.5-6.

134) Fshatrat e Pipërit kanë si veçori faktin se më 1485 elementi shqiptar aty ishte i pakët dhe u shtua vetëm me vendosjen e katuneve shqiptare më 1497.

135) defter, f. 297-298; 303-305; 322-323; 334-335; 137, 142, 154-155; 190-200; 440-442, 463-466, 469, 6-8, 55-56, 61-63, 67; 365-370; 380, 383-385, 387-393, 395-397; 128, 134, 136, 151, 163-164.

136) J.Valentini, *Acta Albaniae veneta saeculorum XIV et XV, tomus octavus*, München 1970, f.337; defteri i regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës i vitit 1582, fl.76.

137) B.Djurdjev, *Dva deftera Crne Gore...*, f.53 v.54.

138) Shih defterin e regjistrimit të sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485, f.166, 9, 157-158; defterin e regjistrimit të vitit 1582, fl.27, 28, 37, 40, 43, 178, 232.

me katolikë dhe si pasojë katolicizmi këtu mundka të vihej baras me «fenë shqiptare». Fakti se në një varg krahinash që ishin të lidhura me administratën kishtare të patriarkanës ortodokse të Pejës, si ato që përfshiheshin në nahijet e Altun-ilisë, të Pejës, të Petrishpanit (pjesërisht), të Plavës, të Pipërit, të Merkodit, të Krajnës, të Zhabjakut, të Podgoricës, të Bregut të Këndejmë, banorët e regjistruar mbanin antroponimi thjesht shqiptare, diku tërësisht dhe diku pjesërisht, le të dyshohet që këta shqiptarë mund të ishin të besimit orthodoks. Për përqafimin e orthodoksizmit nga shqiptarët dëshmon më mirë përmendja në listat e banorëve krahas klerikëve katolikë, të cilësuar me apelative që përdoren edhe sot në gjuhën shqipe: *prift, dom, abat*, edhe e klerikëve orthodoksë të cilësuar *papa, pop, kallogjer* (ose dhe bijt e tyre) me emra shqiptarë ose edhe me emra sllavë në vendbanimet ku banorët të gjithë ose në shumicën e tyre mbanin emra tipikë shqiptarë. Ndër të tjera ndeshen edhe fshatra ku përmenden popë ose të afërmit e tyre me emra thjesht shqiptarë, krahas popëve me emra sllavë, ndërsa banorët mbanin në shumicën e tyre antroponimi shqipe. Të tillë raste ndeshim p.sh. në fshatin Gruda të nahijes së Zhabjakut, ku përmendet «*Pop Progoni*» dhe «*Matraniku i biri i Popit*» ose në fshatrat Mel, Bozhani, Dujak, Vagova të nahijes së Altunilisë ku përmenden « *Popi i biri i Marinit*», «*Popi i vëllai i Progon Pavlos*», «*Gjoni i biri i Popës*», «*Popi, i biri i Nikollës* etj.[140]

Nga të dhënat konstatohet gjithashtu se krahas katolikëve kishte edhe ortodoksë, jo vetëm brenda për brenda një krahine, por edhe brenda një fshati ose vëllazërie shqiptare. Kështu p.sh. në fshatin Pok të nahijes së Petrishpanit gjejmë të regjistruar krahas «*Pop Nenadës*» edhe «*Andrija Dom Shirgjin*»[141], ose në fshatrat Koplik dhe Oblikë krahas klerikëve të tjerë ortodoksë përmenden edhe «*Milosh Prifti*», «*Prift Vladi*» dhe «*Prift Dimitri*»[142]. Vëllazëria e Tuzëve ishte ndarë në ortodoksë dhe katolikë; ndërsa në fshatin Damniç Tuz përmendet «*Pop Martini*», në fshatrat Kuqik Tuz, Istulush Tuz, Petrashani Tuz përmenden me radhë «*Prift Rada*», «*Prift Tanushi*», «*Dom Jaku*», «*Prift Ila,*», «*Prift Shugra*»[143] Madje gjejmë dhe klerikë katolikë (në dokument këta kanë cilësimin «prift»), me emëra sllavë siç është p.sh. rasti i «*Prift Radës*» në fshatin Kuqik Tuz, ose i «*Prift Vladit*» në fshatin Koplik.

Informatat e mësipërme na japin mundësi të nxjerrim dy konkluzione:

*Së pari*, në krahinat ku mbizotëron antroponimia sllave si ato të Pejës dhe të Suhogërlës duhet që një pjesë e banorëve të jenë shqiptarë ortodoksë me emra nga sfera e antroponimisë fetare ortodokse sllave ose greko-bizantine, përderisa gjejmë aty edhe klerikë ortodoksë ose dhe bij të tyre me emra thjesht shqiptarë, siç është rasti i kallogjerëve të quajtur Pepa dhe Gjonja në manastirin e Deçanit dhe në manastirin e Nova Cërkovës, i Gjonit të birit të Popit në fshatin Bana, dhe i Pop Markut e të birit të tij të quajtur Mali në fshatin Luboliq, etj.[144]

*Së dyti*, në këto kushte, prania e banorëve me emra sllavë ose me antroponimi të përzier shqiptaro-sllave në zonat ku banorët në shumicën dërmuese të tyre mbanin antroponimi thjesht shqiptare si p.sh. në fshatrat e nahijeve të Petrishpanit, të Shkodrës, të Bregut të Përtejmë, të Merkodit, të Krajnës, të Altun-

140) defter, f.163, 364-367, 384, 392. Shih gjithashtu S.Pulaha, *Elementi shqiptar...*, f. 80-82.
141) defter, 339.
142) defter, 123, 136-137.
143) defter, f.342-344.
144) defter, f.417,235,410-411, 67-68 etj.



-ilisë si dhe në vetë qytetin e Shkodrës, nuk do të thotë se këta ishin banorë sllavë të ardhur, ose banues vendës. Lidhjet farefisnore që bien në sy qysh në leximin e parë të defterit, midis banorëve ortodoksë me antroponimi sllave dhe të banorëve katolikë ose ortodoksë me antroponimi thjesht shqiptare, ose mbajtja e një onomastike të përzier shqiptaro-sllave madje dhe brenda për brenda një familjeje shqiptare, janë argumenta që na bindin se banorët e zonave të lartpërmendura janë shqiptarë të besimit ortodoks. Kjo nuk mund të jetë kështu, në mënyrë të prerë, në krahinat e tjera ku mbizotëron onomastika sllave, ose ku ajo mbahet nga gjysma e popullsisë. Këtu nuk mund të përjashtohet mundësia që një antroponimi e përzier të shprehë një përzierje të elementit shqiptar dhe elementit sllav. Gjithashtu nuk mund të përjashtohet mundësia që dhe në zonën ku mbizotëron antroponimia shqiptare, nga banorët me emra sllavë, ortodoksë, një pakicë të jenë sllavë si enklave brenda ambientit kompakt shqiptar[145]

Megjithë këto fakti që në zonat ku banorët mbanin në shumicën e tyre antroponimi shqiptare, siç janë krahinat e brendshme të Sanxhakut, ndeshim klerikë ortodoksë, na bind se veshja me emra sllavë e shqiptarve të këtushëm ka ardhur kryesisht si pasojë e kthimit të tyre nga katolikë në ortodoksë, ose thjesht si ndikim i kishës ortodokse nën sundimin e shtetit serb. Në zonat ku kisha ortodokse kishte qendrën e vet dhe pronat më të rëndësishme të manastireve si p.sh. në krahinat e Pejës, të Altun-ilisë, të Merkodit, të Krajnës, të Zhabjakut, procesi i kthimit të elementit katolik shqiptar në fenë ortodokse dhe rrjedhimisht ndikimi i antroponimisë sllave nuk ka dyshim që ka qenë zhvilluar në një shkallë më të lartë, se në zonat e tjera të brendshme. Këtu ndikonte për më shumë jo vetëm faktori shtetëror-administrativ, por edhe simbioza midis shqiptarëve dhe sllavëve, meqenëse këto ishin zonat e atëhershme të kontaktit midis dy popullsive.

Për praninë e shqiptarëve në zonat kufitare të sanxhakut të Shkodrës na dëshmojnë edhe disa të dhëna të tjera me interes të burimit në fjalë. Nga këto duhet të vemë së pari në dukje se në krahina si bie fjala në Kuç, Hot, Pipër, Zhabjak, Altunili, Pejë, krahas toponomastikës sllave ndeshim edhe një varg vendbanimesh me toponimi shqipe.

Për më tepër midis tyre gjejmë vendbanime të cilat, ndonëse mbanin toponimi shqipe, kishin banorë me antroponimi sllave ose antroponimi shqiptaro-sllave, diku në shumicën e tyre, diku më pak. Në asnjë nga këto vendbanime banorët nuk mbanin të gjithë antroponimi të pastër shqiptare. Këto dëshmojnë jo vetëm se elementi shqiptar kishte qenë aty një element vendës autokton, por dhe se kishte mundur t'i bënte ballë ndikimit të faktorëve shtetërorë serbë. Si ngulitje të tilla mund të përmendim p.sh. fshatrat Bushat, Rogam, Bushtiko të nahijes së Pipërit; Pantalesh, Bardhani, Bankeq, Bytidosi, Llazorci të nahijes së Kuçit; Bushad, Tuz të nahijes së Zhabjakut; Leshani, Lablati, Shtupal, Eg-

145) Shquarja e banorëve me emra sllavë, ortodoksë, si element shqiptar i besimit ortodoks, është më e lehtë dhe më e qartë në vendbanimet ku gjejmë ortodoksë dhe katolikë, si bie fjala në fshatrat e nahijes së Petrishpanit, në mëhallën e pazarit të qytetit të Shkodrës, në fshatrat Koplik, Oblikë etj., se sa në zonat kufitare të kontaktit midis popullsisë shqiptare dhe sllave, ose në ato ku institucionet fetare ortodokse kishin prona të rëndësishme, – zona këto ku banorët ishin të gjithë ortodoksë, pavarësisht nga fakti se mbanin jo vetëm antroponimi sllave, por edhe antroponimi thjesht shqiptare, si p.sh. në Krajnë, Merkod, Altun-ili etj.

thela, Fshajani, Nika, të nahijes së Pejës; Kaliq, Kolshiq, Rogam të nahijes së Altun-ilisë; Shekullar të nahijes së Komninit etj[146].

Në vendbanime të tilla të Pejës gjejmë banorë të cilët thuajse të gjithë mbanin antroponimi sllave. Kjo tregon se aty ndikimi i simbiozës dhe i faktorëve politikë-fetarë serbë ishte më i madh se në krahinat e tjera.

Nga ana tjetër në zonat e brendshme të sanxhakut, si p.sh. në krahinat e kazasë së Shkodrës dhe në nahijen e Fetrishpanit, ndeshim vendbanime me toponimi shqipe që kanë banorë me antroponimi sllave ose shqiptaro-sllave, por këta janë në një sasi më të pakët në krahasim me banorët që mbanin emra tipikë shqiptarë.

Prania e shqiptarëve në zonat kufitare dëshmohet edhe nga disa të dhëna të tjera të karakterit gjuhësor. Përveç banorëve me emra shqiptarë ndeshim aty edhe banorë me emra orthodoksë ose me emra sllavë të përshtatur gjuhës shqipe si Lazër, Lazor për Lazar; Gjergj për Gjorgj, ose emra sllavë të dhënë nga regjistruesi në trajtën e shquar me nyjat e shqipes *i, a (ja)*, si p.sh. Dimitri për Dimitr, Petri ose Pjetri për Petr; Aleksi për Aleks; Radi për Rad; Gjorgji për Gjorgj; Rajkoja, Vojkoja, Vojnoja, Dragoja, Vukja, Bozhja, Vladoja për Rajko, Vojko, Vojno, Drago, Vuk, Bozha, Vlado.

Në nahijet që përfshinin toka në jugë-perëndim të liqenit të Shkodrës, si në nahijet e Krajnës, të Maleve të Shestanit dhe të Merkodit, ku pjesën dërmuese të popullsisë e përbënin shqiptarët, ndeshim krahas antroponimisë thjesht shqipe edhe emra sllavë të përshtatur shqipes nëpërmjet prapashtesave të saja. Në këtë zonë, veçanërisht në nahijen e Merkodit, gjejmë të përdorur gjerësisht në emrat e kryefamiljarëve prapashtesën zvogëluese *z*, së bashku me nyjen shquese *a*. Kjo vërehet jo vetëm në emrat thjesht shqiptarë si Malza për Mal, Nikëza për Nika, Dukëza për Duka, Doroza për Doro, Kalza për Kala, Kolza për Kola, Lekëza për Leka, Burza për Burë etj.; por edhe në emra sllavë si Ivza për Iva, Pejoza për Pejo, Gjuroza për Gjuro, Miloza për Milo, Dabza për Daba, Mladoza për Mlado, Cvetoza për Cveto, Groboza (Gruboza) për Grubo, Zhivza për Zhivo, Dragoza për Drago etj. Emra sllavë me prapashtesa të tilla nuk i ndeshim rëndom në antroponiminë e krahina ve të tjera fqinje ose në krahinat e Malit të Zi, me përjashtim të nahijes së Cërnicës, fqinje me Merkodin. Të dhënat e mësipërme flasin në favor të tezës së popullsia e atjeshme ishte një popullsi shqipfolëse.

Fenomeni i përshtatjes së emrave sllavë gjuhës shqipe pati një shtrirje gjeografike mjaft të gjerë, gjë që kuptohet nga numri jo i vogël i fshatrave të krahinave skajore të Sanxhakut, ku ndeshet kjo dukuri. Ky është një fakt që na bind se simbioza shqiptare-sllave nuk ishte zhvilluar në një rajon të ngushtë, por në një territor të gjerë që fillonte në perëndim me krahinën e Merkodit dhe të Krajës, dhe vazhdonte në veri dhe verilindje në krahinat e Zhabjakut, të Podgoricës, të Pipërit, të Bjelopavliqit, të Plavës, të Pejës, të Suhogërlës etj. Këto ishin zonat e kontaktit midis të dy popullsive në shekullin e XV.

Mungesa e onomastikës shqiptare në nahijet Komninit, të Komaranit, të Izlarjekës le shteg të mendohet se onomastika sllave i përgjigjej këtu një popullsie sllave, kurse në zonat ku ndeshim edhe onomastikë shqiptare si në nahijet e Zhabjakut, të Podgoricës, të Plavës, të Pejës dhe të Suhogërlës, antroponimia sllave nuk tregon gjithmonë elementin sllav. Siç e thamë dhe më lart, faktorët politikë-fetarë ndikuan gjerësisht në huajtjen e antroponimisë sllave nga ele-

146) defter, f. 311-313; 295-299; 134, 164-165; 470-471, 42-43, 7-8, 52, 121, 232, 33, 9; 393-395, 398.



menti shqiptar gjatë periudhës së sundimit serb në shekujt XI-XIV. Pra këtu elementi sllav duhet të ketë qenë në një sasi më të pakët se numri i banorëve që mbanin antroponimi sllave. Shëmbulli i popullsisë orthodokse shqiptare të Kërçovës që mbante në shumicën e saj vetëm emra sllavë e mbështet këtë pikë pamje. Por nga ana tjetër mungojnë ende të dhëna më të plota për të vërtetuar se shumica e popullsisë me antroponimi sllave në këtë zonë ishte popullsi shqiptare ortodokse. Kjo kundërshtohet edhe nga fakti se Peja ishte shndërruar në qendër e kishës ortodokse serbe, gjë që nuk mund të mendohet si e mundëshme në zona ku të mungonte plotësisht elementi sllav. Këto arësye na bindin të pohojmë se përcaktimi më i saktë i raportit midis elementit shqiptar dhe atij sllav, veçanërisht për nahijet e Pejës, Plavës, Suhogërlës është i vështirë dhe thuajse i pamundur. Prapëseprap disa të dhëna të defterit, të cilat po i trajtojmë më poshtë, lejojnë të mendohet se elementi sllav në këto nahije mund të ketë qenë me shumicë.

Në zonat e Pejës e të Suhogërlës ne gjejmë të cilësuar një numur banorësh me mbiemrin shqiptar (në origjinal: *arbanas* ose *arnavut*)[147].

Cilësimi i disa banorëve si arbanas në këto vise dhe gjetkë jo, mund të lerë shteg për të menduar se aty kemi një popullsi heterogjene ku shumicën e formonte elementi sllav, gjë që mund ta ketë shtyrë regjistruesin të dallonte elementet e kombësive të tjera. Po kjo e dhënë nuk mund të konsiderohet si një argument i pakundërshtueshëm për të treguar se shqiptarët formonin aty pakicën. Kjo provohet nga fakti se elementi shqiptar në të vërtetë ishte më i shumtë nga sa tregon sasia e banorëve që mbajnë cilësimin *«shqiptari»*, për arësye sepse po në këto zona gjejmë një numur të konsiderueshëm banorësh me antroponimi shqiptare ose shqiptaro-sllave pa këtë cilësim. P.sh. në të njejtin fshat ku gjejmë banorë me antroponimi shqipe, d.m.th. shqiptarë, gjejmë njëkohësisht banorë me antroponimi shqipe ose sllave që cilësohen si shqiptarë (arbanas)[148]. Pra nuk i gjejmë të gjithë shqiptarët të cilësuar me mbiemrin arbanas. Kjo tregon se shkruesi në regjistrim nuk ka dalluar në mënyrë konseguente popullsinë shqiptare nga ajo sllave, prandaj duhet menduar se kishte ndonjë arësye të veçantë për të mbiquajtur këta njerës arbanas.

Elementi sllav në zonën e Pejës dhe të Suhogërlës duhet të ketë qenë i shumtë edhe për shkak të vazhdimit të migracionit aty të sllavëve gjatë fundit të shekullit të XV. Kjo na dëshmohet nga një e dhënë tjetër me interes e burimit në fjalë.

Në defter, shpesh herë ndërmjet cilësimeve që jepen për banorët si i *varfër* (siromah), *mjeshtër*, *arbanas*, etj. gjejmë për një numër jo të vogël banorësh cilësimin *i ardhur – prishliç* ( پرشليچ) ose *doshlac* دوشلج Rrallë ndeshet edhe në formën «... *biri të ardhurit – veled-i prishliç* dhe *veled-i doshlac*

147) Të tillë janë:
*nahija e Pejës:*
në qytetin e Pejës: Pavël Arbanasi, Nikolla Arbanasi (f.210-214) në fshatin Netrobishta: Drago Arbanasi (f.447).
në fshatin » Slojani: Nenada, i biri i Arbanasit; Miha i biri i Arbanasit (f.462-463).
» Tudorihoçi: Bogdan shqiptari (arnavut) (f.23).
» Dolina Petriç: Nenko Shqiptari (arnavut) (f. 44).
» Kraçor: Gjon Arbanasi (f.62-63)
» Lezibaba: Gjon Arbanasi (f.57)
*nahija e Suhogërlës:*
në fshatin Rudnik: Nikolla, i biri i Arbanasit (f.411).
» Gorna Beliça: Nikolla, i biri i Arbanasit (f.422).
» Leskovac: Dimitri shqiptari (arnavut) (f.78-79).

148) P.sh. në fshatrat Slojani, Netrobishta, Kraçor, Rudnik, Gorna Beliça – shih defterin ne faqet 462-3, 447, 62-3, 441, 422.

Banorë me një cilësim të tillë nuk ndeshen në zonat qendrore dhe perëndimore të sanxhakut të Shkodrës, me përjashtim të dy kryefamiljarëve në nahijen e Shkodrës dhe të Zhabjakut. Ky fenomen është karakteristik për krahinat veri-lindore si ato të Pejës dhe të Suhogërlës, ku banorë të ardhur ndeshen në 1/3 e fshatrave të tyre. Ai ndeshet shpesh edhe në nahijet e Vuçiternit, të Prishtinës, të Prizrenit, ndonëse në defterin e sanxhakut të Shkodrës janë regjistruar vetëm pak fshatra të tyre.

Po të vështrojmë këta banorë nga pikëpamja e antroponimisë, rezulton se nga 293 banorë të cilësuar të ardhur, vetëm 5 persona në nahijen e Pejës dhe të. Suhagërlës mbanin emra shqiptarë[149], kurse të gjithë të tjerët mbanin emra karakteristikë sllavë[150]. Pra, mund të themi se në zonat veri-lindore ka patur një lëvizje, një ardhje të elementëve sllavë. Fakti se ardhje të tilla nuk i ndeshim në krahinat e tjera të sanxhakut, madje edhe në ato që banoheshin nga popullsi sllave, na bind se këto lëvizje nuk duhet të kenë qenë kryesisht lëvizje nga një fshat në tjetrin brenda për brenda nahijeve të zonës veri-lindore të sanxhakut. Në shumicën e tyre ato duhet të ishin një lëvizje popullsie e ardhur nga krahinat sllave jashtë sanxhakut të Shkodrës. Këto lëvizje duhet të jenë zhvilluar jo vetëm në fund të shekullit të XV, por edhe më përpara, përderisa në defter gjejmë raste, ndonëse të ralla, kur banorët cilësohen si bij të të ardhurve.

+

\+ +

Materiali burimor i këtij defteri na jep mundësi të korigjojmë disa pikëpamje që vazhdojnë të mbahen sot e kësaj dite në historiografinë e huaj lidhur me problemin e shtrirjes së shqiptarëve në mesjetën e hershme.

Siç dihet, një drejtim më vehte formojnë pikëpamjet e një vargu studjuesish të cilët, duke u mbështetur kryesisht në numrin e madh të toponimeve sllave në tokat shqiptare dhe duke ndjekur kriterin se çdo qendër banimi me toponim sllav ishte truall i banuar nga sllavët, kanë arritur në konkluzionin se elementi shqiptar në krahinat veriore të Shqipërisë së sotme duhet të ketë qenë në shekullin e XV shumë i pakët dhe i përqëndruar kryesisht në zonat malore, ndërsa zonat e tjera, sidomos fushoret, duhet të kenë qenë populluar nga sllavët. Sipas tyre, vetëm me veprimin e faktorëve ekonomikë, politikë e shoqërorë të krijuar pas pushtimit osman, shqiptarët si popullsi blegtorësh u dynden prej krahinave të brendshme malore në zonat perëndimore si në Krajë, Merkot, Shestan Kuç etj. dhe në zonat lindore në Metohi dhe Kosovë. Ata mendojnë se në këto të fundit shqiptarët qenkan vendosur nga fundi i shekullit XVII dhe fillimi i shekullit XVIII, kur një sasi e madhe e popullsisë ortodokse sllave që mori anën e Austrisë gjatë luftës austro-turke (1683-1699) u tërhoq në veri, duke zbrazur kështu vendet e mëparshme[151].

149) Këta janë: Gjin Prishliç; Leka, i biri i Prishliçit; Mazarak Prishliç, Prenku Prishliç, Leka Doshlac në fshatrat Usak, Bjelopavliq, Beçi, Çërnovirha dhe Jagodina defter f.463, 45, 61, 466,115.

150) Për listën e emrave të banorëve të cilësuar «*të ardhur*» sipas secilit fshat, shih S. Pulaha, *Elementi shqiptar...*, në Studime historike, nr. 4, 1972, f. 212-215

151) A. *Селищев, Славянское население в Албании, София* 1931; A. Joviševic, *Crnogosko primorje i Krajina*, në Srbski etnografski zbornik Srbski kralevska Akademija, Beograd 1322, Knjige XXIII; M. Filipović *Has pod Paštrikom*, Sarajevo 1958; A. Urošević, *Kosova*, Beograd 1965; U. *Займов, Българские географические названий в Албании XV века*, në Studia Balkanika, I, Sofia 1970.



Një drejtim të dytë, me baza më të sakta shkencore se i pari, formojnë pikëpamjet e medievistëve të shquar si M.Shufflaj dhe K.Jireçek, të cilët u përpoqën për një trajtim objektiv të të dhënave ekzistuese lidhur me përhapjen e shqiptarëve në mesjetë. Pa ju përmbajtur në mënyrë absolute kriterit toponimik, por duke u nisur nga të dhënat e burimeve historike, ata arritën në përfundimin se shqiptarët në mesjetë popullonin një teritor më të gjerë dhe jo vetëm krahinat malore. Sipas tyre, në shekullin XV ishin troje të shqiptarëve të gjitha krahinat e përfshira në katërkëndin midis Tivarit, Prizrendit, Ohrit dhe Vlorës. Lidhur me çështjen e elementit shqiptar në Kosovë dhe Metohi këta autorë u bashkuan me pikëpamjen e studjuesve të drejtimit të parë, sipas të cilëve shqiptarët u vendosën atje nga fundi i shekullit XVII - fillimi i shekullit XVIII[152].

Materiali i defterit, na shtyn të themi se lidhur me problemin në fjalë, autorët e sipërpërmendur u mbështeten në një bazë burimore të ngushtë, fragmentare, të varfër për krahinat e brendshme jobregdetare, gjë që nuk i lejoi të nxirrnin një konkluzion të drejtë dhe përfundimtar. Në të vërtetë materialet e reja po bëjnë gjithnjë e më të dyshimtë dhe po plotësojnë pikëpamjen e tyre mbi shtrirjen gjeografike të shqiptarëve në mesjetë duke e zgjeruar zonën e përhapjes së elementit shqiptar si në krahinat veriore ashtu edhe në ato lindore e jugore[153].

Të dhënat burimore që parashtruam na çojnë në konkluzionin se shqiptarët e krahinave veriore gjatë shekullit XV nuk ishin përqëndruar vetëm në zonat malore, por kishin patur një shtrirje më të gjerë, shumë më të gjerë edhe nga ajo që mendonin M.Shufflaj dhe K.Jireçek.

Prania e shqiptarëve si shumicë e popullsisë edhe në zona të tilla kufitare të sanxhakut si Merkodi, Shestani dhe Anamali, Zhabjaku, Pipëri (1497), Kuçi, Altun-ilia, si dhe në krahinën e Pejës dhe të Suhogërlës, në një periudhë të tillë si fundi i shekullit XV, kur nuk kishin filluar ende të vepronin faktorë që lindën me pushtimin osman, presupozon se këtu kemi të bëjmë me një popullsi shqiptare ekzistuese që me kohë në këto troje dhe jo të ardhur aty në periudhën e shekujve XVII-XVIII. Kjo pikëpamje mbështetet edhe nga prania e një sasie elementësh shqiptarë në toponiminë dhe antroponiminë e Malit të Zi gjatë shekullit XVI.

Elementi shqiptar përbënte në nahijet e Pejës dhe të Suhogërlës një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, një sasi më të madhe banorësh nga numri i atyre që mbanin antroponimi thjesht shqiptare. Prania e tij në këtë zonë nuk është e rastit, sepse ky element nuk ndodhej aty i shkëputur, por gjendej edhe më tutje në viset më lindore në Kosovë,–gjë që e ka vënë në dukje për herë të parë studjuesi nga Sarajeva, Adem Hanxhiq[154]. Kjo popullsi përbënte atë shtresë shqiptare autoktone, që ekzistonte me kohë që para pushtimit osman, e cila i bëri ballë asimilimit gjatë simbiozës me popullsinë e ardhur sllave dhe u bë baza e burimi kryesor i shtimit të elementit shqiptar në këto vise në shekujt e pastajmë, një burim më i rëndësishëm në krahasim me migracionet e popullsisë shqiptare nga krahinat e brendshme malore.

152) M. Šufflay, *Die Grenzen Albaniens im Mittelalter*, në Illyrisch-Albanische Forschungen München und Leipzig 1916, Bd.I, f.202-3. K.Jireček *Albanien in der Vergangenheit* dhe *Skutari und sein Gebiet im Mittelalter*,, në Illyrisch-Albanische Forschungen, Bd.I, f.69-70, 117.

153) *Historia e Shqipërisë*, Tiranë 1967, v.I, f.151, 192. A. Hanxhiq, *Nekoliko vijesti o Arbanasima na Kosovu i Metohiji v sredinom XV vijeka*, në Simpozium për Skënderbeun (9-12 maj 1968) Prishtinë 1969, f.201-209.

154) A. Hanxhiq, v.p. 201-209.

Nga ana tjetër fakti se popullsia shqiptare ishte e vendosur jo vetëm në viset malore, por edhe në ato fushore, dëshmon se ajo nuk ishte një popullsi që merrej vetëm me ekonomi blegtorale siç ndodhte në malësi, por një popullsi e cila ushtronte kryesisht ekonominë bujqësore në zonat fushore. Rrjedhimisht nuk mund të barazohet, siç është bërë zakonisht në historiografinë e huaj, koncepti «*malok*» ose «*bari*» me konceptin «*shqiptar*».

Të dhënat e defterit në fjalë na bindin se zgjidhja e problemit të shtrirjes gjeografike të shqiptarëve në mesjetë veçanërisht çeshtja e pranisë së elementit shqiptar në trevat skajore të kontaktit me popullsitë fqinje ballkanike, kërkon jo vetëm botimin e materialeve dokumentare të reja, sidomos të regjistrave kadastralë osmanë të shekujve XV-XVI, por edhe një studim akoma më të thelluar dhe më të gjithanshëm të burimeve dhe në radhë të parë të onomastikës, si në prizmin historik ashtu dhe në atë gjuhësor. Ato na treguan gjithashtu se onomastika sllave që gjejmë në trevat e brendshme shqiptare dhe veçanërisht në trojet e kontaktit midis popullsisë shqiptare dhe sllave, nuk mund të përdoret në mënyrë të prerë dhe absolute si kriter për të përcaktuar karakterin etnik të popullsisë që e përdorte. Përkundrazi, vetëm duke e vështruar dhe duke e shpjeguar atë me kushtet historike në të cilat ajo lindi, mund të përcaktohet në mënyrë të saktë përkatësia etnike e mbartësve të saj.





## PASQYRA E LËNDËS

1) Hasset e mirlivait në nahijet e ndryshme. . . . . 210–332 *
2) Ziameti i [Mehmedit], të birit të Kasapit në nahijen e Petrishpanit dhe në nahijet e tjera. . . . . 334–348
3) Ziameti i të famshmit Hysen bej Çashnegjirit. . . . . 350–356
4) [Ziameti] i nahijes Altun-ili. Pjesa e Shuxhaa beut dhe pjesa e Mirza beut . . . . . 358–399
5) Ziameti i Suhagërlës. . . . . 402–413
6) Ziameti i Deçanit. . . . . 414–421
7) Ziameti Joshanicave. . . . . 422–426
8) Ziameti Zakovik. . . . . 426–428
9) Ziameti i Hamza beut. . . . . 429–437
10) [Timaret] e spahijve të nahijeve të Pejës (Ipek). . . . . 437–473, 1–118
11) [Timaret] e spahijve të nahijes së Shkodrës (Iskenderije). . . . . 120–165
12) [Timaret] e mbrojtësve të Drishtit (Dërgoz). . . . . 166–177
13) Vojnukët e sanxhakut. . . . . 178–188
14) [Regjistrimi i hollësishëm i nahijeve të Piperit dhe të Kelmendit në vitin 1497] . . . . . 189–204

*) Po japim faqet e dokumentit në origjinal.

[Defteri fillon me një hyrje ku hartuesit vlerësojnë lart detyrën e regjistrimit të të ardhurave, duke e konsideruar atë si një detyrë të shenjtë fetare, të ngarkuar nga zoti, të cilit me këtë rast i thurin një varg lavdesh që janë steriotipe dhe të zakonshme në literaturën mesjetare. Më poshtë ata vazhdojnë]:

(209)

... Ky libër është defteri i hollësishëm dhe i plotë i të ardhurave të vilajeti të Shkodrës – qoftë i mbrojtur nga fatkeqësitë gjersa të jetë njerëzimi! – U përpilua dhe u shkrua me sugjerimin dhe urdhërin e begatshëm të madhërisë së tij sulltanit të islamit, hies së Allahut në tokë, sundimtarit të të gjithë popujve, zëvëndësit të zotit mbi robët, mbrojtësit të vendeve të besimtarëve, zhdukësit të shenjave të pafesisë e të rebelimit, ngritësit të flamurit të shenjtërisë në horizontet e larta, zotëruesit me meritë të fronit të halifatit, atij që lëfton për të ngritur kudo shatoret e qetësisë e të sigurimit... Ai nuk ka shok nga pikëpamja e lartësisë së shpirtit dhe është vetë ideali i përsosur i virtytit. Ai është i mbështetur nga Zoti me ajetet e përforcimit. Sulltan Bajazidi, biri i një sulltani, dhe ky gjithashtu, biri i një sulltani – qofshin gjithmonë hurdhat e mbretërisë dhe kopshtet e vendit të mbushura plot dhe të ujitura nga burimet e sundimit të tij, është (një sundimtar) që e ka drejtuar vëmendjen e tij nga mbrojtja e islamit dhe, si pasojë, e ka forcuar godinën e fesë së drejtë, mbasi kjo i qe ekspozuar shembjes, dhe ka bërë që të rreshen mbi njerëzit retë e të mirave dhe të bujarisë së tepëruar; në mënyrë të veçantë ka nderuar me të mira të panumërta dijetarët. Personi i tij i dlirtë është qabeja e shpresave dhe virtyti i tij i lartë është ndjellës i lumturisë. Gjuha e pendës nuk mund të përshkruajë dot virtytet e tija të larta dhe gjuha e njerëzisë nuk mund të tregojë dot bujarinë dhe vetitë e ndritura të tij...

U ngarkuan me regjistrimin e popullatës: më i ulti i robërve, Mustafai, biri i Siraxhuddinit, dhe me të shkruarit (e defterit): më i varfri i robërve dhe më i pafuqishmi i shkruesve, Sulejmani, biri i Abdullahut, një nga robërit e liruar të të ndjerit dhe mëkatfalurit Mahmud Pasha.

Ky defter u dorëzua në muajin e Saferit të bekuar të vitit tetëqind e nëntëdhjetë (17 shkurt – 18 mars 1485) në kryeqytetin e mbretërisë, në Edrene...

(210)

1) HASSET E PADISHAHUT, MBROJTËSIT TË BOTËS, QOFTË I PËRJETSHËM HILAFETI I TIJ.

Mukataaja e liqenit të Bujanës[1] në tre vite: 165.000 [akçe].
Mukataaja e doganës së Bujanës në tre vite: 10.000 [akçe].

1) Sipas një shënimi të këtij defteri (f.156) kuptohet se regjistruesi dallon për këtë zonë dy liqene: liqenin e Shkodrës dhe liqenin e Bunës. Kjo na shtyn të pohojmë se me liqenin e Bunës ai ka kuptuar lumin e Bunës dhe jo liqenin e Shkodrës. Prandaj në këtë rast kemi të bëjmë me mukataanë e peshkimit në lumin e Bunës.

Mukataaja e skelës së Drinit në tre vite: 16.000 [akçe].
Mukataaja e [taksave të emërtuara] mevkufat, bejtulmal, maligajb dhe mali mevkud në kazatë e Podgoricës dhe të Shkodrës në tre vite: 10.000 [akçe].
Mukataaja e monopolit të kripës në vilajetin e Shkodrës dhe të Lezhës në tre vite: 32.000 [akçe].

*Shuma* 231.758 [*akçe*].

*Manastiri Viranja* brënda në ishullin e liqenit të Shkodrës. Është famulli. Shtëpi 2.
*Manastiri Istarxhik Gorica.* Varet nga e sipërpërmendura. Ndodhet në ishull. Shtëpi 1.
*Kisha e Shën Gjorgjit.* Shtëpi 3.
*Manastiri Preçista i quajtur edhe Moraçik.* Shtëpi 2.
*Mana stiri i Kishës së Ivanit*
*Manastiri Radimoga Gorıca* – i shkatërruar dhe i braktisur.
*Manastiri Kamnik* — i shkatërruar dhe i braktisur.
*Manastiri Aleksi Andrea,* i shkatërruar; është jashtë defterit (haric ez defter).

2) NAHIJA E PEJËS. HASSET E MIRLIVAIT TË SHKODRËS.

VETË PEJA, HASS I TË SIPËRPËRMENDURIT. MYSLIMANËT:

| | | |
|---|---|---|
| Sinan Demeshki[x] | Jusuf Qatipi | Ali Kyçyku |
| Senkuri, i biri Abdullahut | Hamzai, gulam i Isa beut | Dogan Delali |
| Hëzër Sati | Abdi Sati | Ismail Kasapi |
| Dogan Kasapi | Hoxha Dogani | Ismail Gjediku |
| Dogan Leqe | Ismail Kyçyku | Saruxha Kadiu |
| Karagjoz Doganxhi | Avesi | Hamza Çelebi |
| Ajas Xhajim | Hysejn Sabuni | Ali Sati |
| Shirmend Nalbani | Iskender Nalbani | Mehmed Naibi |
| Mehmedi , i biri i Odas. | | |

(211)

| | | |
|---|---|---|
| Karagjoz Kyçyku | Sulejman Kadiu | Ajasi, i biri Abdullahut |
| Jusuf Sati | Ajas Rumi | Ismail Delaku |
| Jonusi, i dhëndri i Ballabanit | | Ahmedi,i biri Abdullahut |

Shtëpi 33.

Meqenëse në vendimin perandorak që kanë në duar thuhet që nga vreshtat e myslimanëve të sipërpërmendur të merren sipas kanunit të padishahut nga 4 akçe për dynym si taksë dhe të mos merret e dhjeta, dhe meqenëse kështu shkruhet edhe në defterin e vjetër, përsëri u shkruan sipas vendimit dhe aktit të mëparshëm.

x) Rrjeshtimin e emrave po e japim në formë horizontale dhe jo vertikale.



**Të krishterët:**
**Mëhalla e Petrit, të birit të Dimitrashinit**

| | |
|---|---|
| Petri, i biri i Dimitrashinit | Dimitri, i biri i tij |
| Radoslavi, i biri Radivoit | Gjura Palçko[2] |
| Jovani (Juvani), i biri i tij | Jovani, i biri i Rajës (Raja)[3] |
| Stepan Dragushi | Mihajlo Vukça |
| Stepan Kloviriça | Stepan Obroviça |
| Vuk Gronja[4] | Papa, i biri i Mihailit |
| Petri, i vëllai i tij | Vukoslav Zeqanini[5] |
| bashtina e Stepanit Vuk Zeqanini | Vuku, i biri i Spaviliçit |
| bashtina e Radovanit Jovan Dragushi | Dimitri, i biri i Bojës (Boja)[6] |
| Juvko Bedrag, bashtina e Radovanit, i biri | Bogdanit; Todori, i biri i Nikasit. |
| Bojko Bariçi | bashtina në dorën e Jani Vladës |
| bashtina në dorën e të vejës së Vujës (Vuja) | |
| bashtina në dorën e vejushës Jovana | Nikolla, i biri i Jovanit |
| bashtina në dorën e Olivirit | bashtina në dorën e Josifit |
| Radiç Shustër | e veja Belina e veja Dobrosava |
| e veja Olivira | |

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe |
|---|---|---|---|
| 27 | 5 | 3 | 818 |

**Mëhalla e Nikollës, i biri i Vukmanit**

| | |
|---|---|
| Nikolla Vukmani | Jovan Nalbani Rajmil Kasapi |
| Stepan Radoshi | Dabzhivi, i biri Gjurës (Gjura) |

(212)

| | |
|---|---|
| Todor Mastori | Nikolla Belani Stepan Visha |
| Ivani, i vëllai i tij | Jovani, i biri i Petanit |
| Rajko Prishliç[7] (i ardhur) | Nikolla Ilia Vukashin Obradi |
| Radoslav Preponi | Dimitri, i biri i Rashkos |
| bashtina në dorën e Popadjas | Todori, i biri i Popit |
| e veja Ivana | e veja Visha e veja Olivira |
| e veja Vidosava | Pop Gjura |

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe |
|---|---|---|---|
| 15 | 3 | 4 | 474 |

2) Leximi është jo i sigurtë, sepse për germën e parë nuk janë shënuar shenjat diaktrike تالچقو . بالچقو ، تالچقو ( بالچقو ) Mund të lexohet edhe Balçko, Talçko, Nalçko
3) Ky emër është shkruar pa shenjat diakritike në të gjitha rastet (رايه)
4) Këtu është shkruar عروسه , kurse në faqen 212 është shkruar në formë të plotë, **Grunja** ose Gronja غرونيه .
5) Këtu është shkruar pa shenjat diakritike وكاس kurse në faqen 212 gjendet e **shkruar** Zeqanin زكانن.
6) Zakonisht është shkruar pa shenjën diakritike në formën بوبه. Vetëm në disa raste, si p.sh. në faqen 179, është shënuar b si germë e parë (پوبه) . Kjo na jep mundësi ta lexojmë Boja dhe jo Noja ose Toja.
7) Në këtë rast e gjejmë të shkruar pa shenjat diaktritike برسلمح Në faqen 58 e gjejmë të shkruar në mënyrë të plotë Prishliç پريشلچ

### Mëhalla e Stepan Zeqanin*it*

Stepan Zeqanini
Gjura, i biri i Gega Petrit
Pavël Arbansi
Marku, i biri i tij Radiç Kozhohari
bashtina në dorën e Belinës
bashtina në dorën e vejushës Vidosava
Cvetko Prishliç
e veja Belina
e veja Ermenika
Todor Spiça Jovan Branko
Stepan Vlada Nikolla Boshko
Nikolla Arbanasi Jovan Mullixhiu
Dimitër Grunja (Gronja)
bashtina në dorën e Radës (Rada)
Vuku, i biri i Bojkos
Radovani, i biri i Vojavës (Vojava)
e veja Todora e veja Belina
Junakash Prishliç

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe |
|---|---|---|---|
| 17 | 2 | 3 | 493 |

### Mëhalla e Radiç*it*, të birit të Pop*it*

Radiçi, i biri i Popit
Mihaili, i vëllai i tij
bashtina e Cvetkos, në dorën e Marës(Mara)
bashtina në dorën e Dabzhivit
Popi, i vëllai i tij
Vuku, i vëllai i Mehmedit
bashtina në dorën e Iskenderit
Nikolla, i biri i tij Uglesha Zeqanini
Vuku, i dhëndri Bojës
Radko, i dhëndri i Hamzait
Gjura Dobroslavi
Dimitri, i vëllai i tij
Vuksani, i vëllai i Nokut[8]
e veja Rada

(213)

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe |
|---|---|---|---|
| 13 | 1 | 1 | 375 |

### *M*ëhalla e Ivanko*s*, i biri i Radmilije*s*

Ivanko, i biri i Rominës (Romina)
Nikolla Jovani
Jovan Kondjari
Gjugjash[9] Doshlaç (i ardhur)
Stepani, i vëllai i tij
Mença[10], i biri i tij
Nikolla, i biri i Pisos
Nikolla, i biri i Kakrës (Kakra)
Radivoi Braniqi
Vuku, i biri i tij
Bashtina në dorën e Todorit
bashtina në dorën e Petri Beqit
Radonja Kereshnik
Jovan Upaka (Opaka) Draimiq Doshlaç
Nikolla Peçi Petri, i biri i Gjonit
Radiçi, i biri i Bozhiçit
Bogdan ···
Dabzhivi, i biri i Kurës (Kura)
Gjoni, i vëllai i tij
Gjuriça, i biri i Bogut
Bozhidari, i biri i Dulit
Nikolla Çavlo Damjani, i biri i tij
e veja Daba
e veja Vlada

8) Këtu është shkruar pa shenja diakritike نو فو. Në faqen 310 e gjejmë të shkruar Noku نو فو
9) Mund të lexohet edhe Gjonash.
10) Në këtë rast është shkruar pa shenjat diakritike مسچ Duhet të jetë Mença مسچه ashtu si shkruhet më poshtë në këtë faqe.



e veja Milica
Gjuriçi, i biri i Bogdanit
Andreja, i biri i Nikollës
Stepani, i biri i Gjergjashit

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe |
|---|---|---|---|
| 21 | 7 | 3 | 718 |

### Mëhalla e Dabzhiv*it*

Dabzhiv Domeniku
Todor Radoslavi
Radashin Liku
Mença, i biri i Vukotës (Vukota)
Nikolla Siromah (i varfër)
Stepan Prishliç
e veja Olivira
Rasha, i biri i Stojës Stepan Nikolla
Stepan Radiçi Jovani, i vëllai i tij.
Radivoi, i biri i Bedës (Beda)
Stepan Brajini
bashtina në dorën e Pop Dabzhivit
Nikolla, i vëllai i Dabzhivit
e veja Todor (a)

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe |
|---|---|---|---|
| 12 | 2 | 2 | 312 |

(214)

Shuma e shtëpive të mëhallave të sipërpërmendura:

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe |
|---|---|---|---|
| 104 | 20 | 16 | 3148 |

Kësti i nijabetit, baxhi, mirponi, taksa e gjerdekut dhe badihavatë edhe të tjera të vetë Pejës dhe hasset e tjera të sanxhakbeut së bashku me gjysmën e të ardhurave të nijabetit të timareve të spahijve të kazasë së Pejës, [gjithsej] 12.000 [akçe] në vit.

| grurë | thekër | elb | tagji dhe okër | musht | mel |
|---|---|---|---|---|---|
| barrë 25 | barrë 6 | barrë 14 | barrë 17 | subur 400 | 5 |
| 750[x] | 120 | 224 | 218 | 8000 | 100 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| vreshta hassa 3, subur 150 3000 | të shkatruara 2 / | [taksa] e perimeve 300 | mullinj të rajave 21 630 | |
| mullinj dërstile 2 30 | [taksa] e bletëve 60 | qoqel 871 | fruta 220 | nga drurët hassa 400 |
| arra barrë 5 | taksa e govatës 430 100 | bidati i derrave 250 | tokë hassa, dynym 100 150 | |

*shuma 30.001*

(215)

### Fshati Bjelopolja e madhe[x], varet nga Peja, hassi i sanxhakbeut.

Vuku, i biri i Ivaninit
Boja, i biri i Dobrashinit
Vukaçi, i vëllai i tij
Jovan Prebili[11]

11) Zakonisht është shkruar pa shenjat diakritike në formën پربل Në faqen 30 të këtij regjistri e gjejmë të shkruar Prebil-پربيل

x) Shifrat e vëna nën prodhimet bujqësore të vjela si taksë e së dhjetës shprehin vlerën e tyre në akçe

Dimitri, i vëllai i të sipërpërmendurit
Radiçi, i vëllai i tij
Stepani, i biri i Kallogjerit
Gjurash Bozhidari
Stepan Radiçi
Dimitrashi, i biri i Vladisavit
Domeniku, i biri i Bogdanit
Radiçi, i vëllai i tij
Jovan Bozhidari
Prebili, i biri i Stepanit
Nikolla, i biri i tij
Pop Bozhidari Pop Vuku
Petko[13], i biri i Milijës (Milija)
Rasha , i biri i Bozhidarit
Rajça, i biri i Petkos
Beljan Sava
Stepani, i biri i tij
Todori, i biri i Radiçit
Petri, i biri i Zajiçit
Nikolla, i biri i Vlajës
Rahon Vasili
Bogdan Bubqi
Oliviri, i biri i Nikavaçit
Bozhidari, i biri i Radosavit
Ivanko, i biri i Stepanit
Vuku, i vëllai i Bogdanit
Vukaçi, i vëllai i tij
Nikolla, i vëllai i tij
Nikolla Boraja
Radiçi, i biri i Bogdanit
Stepani, i biri i Vukiqit
Gjura, i biri i tij
Gjorgj Bubqi

Stepani, i biri i Obradit
Bogavaç Prishliç
Bubqi[12], i biri i Prebilit
Stepani, i vëllai i tij
Petri, i biri i Bjeljas
Radiçi , i biri i tij
Radenko, i biri i Dimitrit
Radiçi, i biri i Gjorgjit
Bogdan Gjurko
Vukashi, i biri i Bojkos
Rodosavi, i biri i Popit
Bogdani, i biri i Vitomirit
Rodosavi, i vëllai i Petkos
Rajaku, i biri i Radiçit
Stepani, i biri i Radiçit
Vukashini, i dhëndri i Beljanit
Stepan Bubqi
Bozhidar Prishliç
Stepani, i biri i Petkos
Damjan Bogdani
Vukashini, i biri i Vasilit
Jovani, i biri i tij
Bozhidari, i vëllai i tij
Jovani, i biri i Obradit
Petko, i vëllai i tij
Pavlo, i vëllai i tij
Jovani i biri i Bozhidarit
Jovani, i biri i Vukosavit
Rasha Gllavini
Vojnani, i biri i Rashkos
Radonja Mrka
Bozhidari, i biri i Vukashit

(216)

Brajovaçi[14], i biri i tij
Radosavi, i vëllai i tij
Bozhko, i biri i Radosalit
Dimitri, i vëllai i Stepanit, i biri i Obradit
Vukashini,i biri i Nikzës (Nikza)[15]
bashtina në dorën e Dabës (Daba)
Radiçi, i biri i Petros

Radivoi Miokodoviq
Bogdan Prishliç
Petko, i biri i Rashës (Rasha)
Oliviri, i biri i Petrit
bashtina e Hysejnit
Damjani, i vëllai i Bozhidarit

12) Zakonisht është shkruar në formën بولك Në faqen 218 është shkruar Bubqa ose Bobqa–بوبكه

13) Zakonisht ky emër është shkruar pa shenjat diakritike تسقو, prandaj mund të lexohet në format: Petko, Nenko, Niku, Niko. Leximi i këtij emri nuk është i sigurtë. Zakonisht e kemi lexuar Petko dhe Nenko.

14) Lexim jo i sigurtë براناواح Mund të lexohet edhe Branovaç ose Bratovaç براتواچ، برانواچ

15) Këtu është shkruar pa shënjat diakritike نفره . Në faqen 325 lexohet qartë Nikza نقزه



Mihali, i biri i Nikollës
e veja Vukoslava
e veja Bosava
e veja Bosava tjetër
e veja Todora

Nikolla, i biri i Gjergjit
e veja Visha
e veja Todora
e veja Barça
myslimani Saruxha

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | thekër | elb |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 74 | 12 | 7 | 2192 | barrë 36<br>1080 | barrë 24<br>480 | barrë 10<br>160 |

| tagji dhe të tjera | mel | musht | vreshta hassa 2 | arra |
|---|---|---|---|---|
| barrë 23<br>322 | barrë 5<br>100 | subur 410<br>8200 | subur 23<br>460 | barrë (?)<br>20 |

| qoqel | [taksa] e perime | fruta | taksa e govatës | [taksa] e bletëve |
|---|---|---|---|---|
| 10 | 78 | 40 | 415 | 30 |

| bidati i derrave | [taksa] e druve | *shuma* 14210. |
|---|---|---|
| 370 | 148 | |

**Fshati Bjelopolja e vogël[16], varet nga Peja, hass i sanxhakbeut.**

Gjorgji, i biri i Radiçit
Nikolla, i biri i Melkut
Vukaçi , i biri i Ohriçës (Ohriça)
Rasha, i biri i Nikollës
Radonja Liku
Kosta, i biri i tij
Nikolla Dobriq
Vuçri, i biri i Bojçës
Radosavi, i biri i Kallogjerit
Vuku, i biri i Gulupit

Stepani, i vëllai i Popit
Vuku, i biri i Bozhidarit
Rodonja Prishliç
Jovani, i biri i Govedarit (Loparit)
Petri, i biri i tij
Vuku, i biri i Olivirit
Bojça, i biri i tij
Radosavi, i vëllai i tij
Radiçi, i vëllai i Stanishës
Vladisavi, i vëllai i tij

(217)

Vukosavi, i vëllai i tij
Brezan Prishliç
Rasha Prishliç
Jovani, i vëllai i tij
Jovan Todori
Bozhidar Vukmani
Vuçeta Prishliç
Dimitri ,i dhëndri i Radiçit
Vukashin Prishliç
Mihajlo, i biri i Jovanit, i vogël, zotëron një bashtinë.
Dabzhivi, i biri i Petkos
Radosa, i vëllai i Radonjas
bashtina në dorën e të vesë Mara
e veja Vukosava
e veja Pripslada

Zorko Prishliç
Cvetko Siromah
Bogdani, i dhëndri i Dodës (Doda)
Bogdani, i biri i Kallogjerit
Jovan Prishliç
bashtina në dorën e Bozhidarit
Mihajlo, i biri i Gjurashinit
Radonja Prishliç
Vuçrini, i biri i Todorit
Nikolla Kovaçi
e veja Belina
e veja Ruzha
e veja Bogosava
e veja Kallogjerica

16) Në defter përmenden dy fshatra me emrin Bjelopolje: Bjelopolja e madhe dhe Bjelopolja e vogël. (Bjelopolja kebire dhe Bjelopolja Kyçyk). Sot ekziston vetëm një fshat me emrin Bjelopolja, në jugë të Pejës.

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | thekër | elb |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 34 | 9 | 6 | 1111 | barrë 20 600 | barrë 10 200 | barrë 5 100 |

| tagji dhe okër | mel | musht | perime | fruta | mullinj të rajave |
|---|---|---|---|---|---|
| barrë 27 378 | barrë 2 40 | subur 240 4800 | 48 | 20 | 5 |

| qoçel | taksa e govatës | arra | bidati i derrave | lini | taksa e druve |
|---|---|---|---|---|---|
| 80 | 300 | barrë 2 60 | 55 | 165 | 66 |

| [taksa] e bletëve | vreshta hassa, copë 1 | *të ardhura* 8978 |
|---|---|---|
| 30 | 40 | |

**Fshati Boçoça, varet nga Peja, hassi i sanxhakbeut.**

Popadin Siromah
Petko, i biri i Ivashit
Bogdani, i vëllai i tij
Vuku, i biri i tij
Pora[17], i vëllai i tij
Bozhidari, i biri i tij
Jovani, i biri i Gjorgjit
Gjura, i biri i Çapçës (Çapça)
Cvetko, i biri i Dujçinit
Radosavi, i biri i tij

(218)

Bogdani, i biri i Vladisavit
Bogdan Stojiqi
Bozhidari, i biri i Vukosavit
Jovani, i biri i Radiçit
Petko, i vëllai i Vukashinit
Branko, i dhëndri i Domenikos
Vuk Siromah
bashtina e Ilias, në dorën e së shoqes Belina
bashtina e Stojës (Stoja)
bashtina e Stojës në dorën e ...
bashtina e sipërpërmendur në dorën e Kasëmit, të birit të Ballabanit.
Është raja mysliman.
Mihajlo, i biri i Bubqit
bashtina e Vasit, në dorën e Milicës (Milica)
bashtina e Bozhidarit
bashtina në dorën e Kurakës (Kuraka)
e veja ...
Dabzhivi, i biri i Petkos
Bogdani, i biri i Jovanit
Pop Petra
Nikolla, i biri i Brankos
Gjura, i biri i Nikshës (Niksha)
Bozhidari, i dhëndri i ...
bashtina e Jovanit, në dorën e Bozhidarit
bashtina në dorën e Dabzhivit
Vukoka, i biri i Mioçës (Mioça)
myslimani Ahmed
bashtina në dorën e Ivashit
bashtina në dorën e Spanit[18]
e veja Spana
e veja Vlada
e veja Popadja

17) Leximi është jo i sigurtë: بورە . Në faqen 194 të këtij defteri ky emër është shkruar Pora– پورە dhe mendojmë se duhet të jetë emri Bora. Në rastet kur i mungojnë shënjat diakritike e kemi lexuar Bora. Këtu nuk mund të përjashtohet mundësia që regjistruesi të mos ketë shënuar shenjën diaktritike për germën r – ـــر ـــ, e cila atëhere do të lexohej z ose zh – ز ژ Rrjedhimisht do të na dilte emri Bozha. Një rast të tillë e gjejmë në faqen 135.

18) Shkruesi në këtë rast emrin e ka dhënë në rasën gjindore të serbishtes. Baştina der destj Ispana.



| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | thekër |
|---|---|---|---|---|---|
| 22 | 5 | 4 | 949 | barrë 12 360 | barrë 4 80 |

| elb dhe të tjera | musht | vreshta hassa, sasia 1 | mullinj të rajave 1 |
|---|---|---|---|
| barrë 23 368 | subur 183 3660 | subur 3 60 | 30 |

| [taksa] e perimeve | [taksa] e frutave | taksa e govatës | [taksa] e barit |
|---|---|---|---|
| 42 | 60 | 120 | 160 |

| mel | taksa e druve | bidati i derrave | qershia hassa | arra hassa |
|---|---|---|---|---|
| [barrë] 1 20 | 64 | 32 | 50 | 40 |

lini 10 *shuma 6115*

**Fshati Radavça[x], varet nga Peja, hass i mirlivait**

Radosavi, i biri i Radiçit
Radenko[19], i vëllai i tij
Mihajlo, i biri i Bogosavit
Radosna, i biri i Sujçës (Sojçës)
Stepani, i biri i tij
Radiçi, i biri i tij
Gjorgji, i biri i tij
Vukashin Siromah
Oliviri, i biri i tij
Bojko, i biri i Radoit
Boga, i vëllai i tij
Bogdan Siromah
Rashko Minomali
Radosavi, i biri i Bogojës (Bogoja)
Gjorgj Govedari
Radiçi, i vëllai i tij

(219)

Brajoti, i biri i Vuçkos
Bogdani, i biri i Brajotit
e veja Stroja[20]
e veja Luba
Dimitri, i biri i tij
Rashmio, i biri i Vukaçit
e veja Vlada
bashtina e Bogosavit

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | tagji | elb |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 19 | 2 | 3 | 543 | barrë 8 240 | barrë 8 128 | barrë 5 80 |

| thekër | mel | [taksa] e bletëve | musht | taksa e govatës |
|---|---|---|---|---|
| barrë 5 100 | barrë 6 120 | 35 | medre 44 880 | 55 |

| (taksa] e barit | taksa e druve | [taksa] e frutave | mullinj dërstile 6 |
|---|---|---|---|
| 95 | 38 | 5 | 90 |

| mullinj të rajave 1 | bidati i derrave | arra | [taksa] e perimeve |
|---|---|---|---|
| 30 | 25 | 9 | 25 |

*shuma 2467*

19) Zakonisht e gjejmë të shkruar pa shenjat diakritike رادنغو Në mjaft raste, si p.sh. në faqen 227 është shënuar në formë të plotë Radenko رادنقو

20) Lexim jo i sigurtë استرونه Mund të lexohet edhe Strona استرونه tj.

**Fshati Krivogllava[x], varet nga Peja, hass i sanxhakbeut.**

Nikolla Petko
Radiç Gjorgji
Nikolla, i vëllai i tij
Radosav Prishliç
bashtina në zotërim të banorëve të fshatit.
Bogosavi, i vëllai i Vukut

Vuku, i biri i tij
Radiç Petko
Radovan Oliviri
bashtina e Tomçinit në dorën e Milics

| htëpi | beqarë | ispenxhe | grurë | elb | thekër | tagji dhe okër |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | 1 | 250 | barrë 5<br>150 | barrë 5<br>80 | barrë 3<br>48 | barrë 6<br>96 |

| mel | musht | taksa e govatës | [taksa] e bletëve | [taksa] e frutave |
|---|---|---|---|---|
| barrë 1<br>20 | subur 40<br>800 | 50 | 20 | 20 |

| arra | taksa e druve | [taksa] e barit | bidati i derrave | drurë hassa, arra copë 20 |
|---|---|---|---|---|
| barrë 1<br>20 | 18 | 45 | 7 | 40 |

*shuma 1629*

(220)

**Fshati Brestja, varet nga Peja, hass i sanxhakbeut.**

Radiç Vlajko
Melko, i biri i Vuçkos
Stepani, i biri i Petkos
Vukota, i biri Stepanit
Bogoi Prishliç
Jovan Stepani
Stepan Bogdani
Dimitri, i vëllai i tij
bashtina në zotërim të banorëve të fshatit
bashtina në zotërim të Stepanit
e veja Olivira

Marku, i biri i tij
Nikolla, i vëllai i tij
Bozhko Prishliç
Stepan Bozhidari
Radosav Prishliç
Todor Bozhidari
Radoshi, i vëllai i tij
Dabzhivi, i biri i Pop Jovanit
e veja Rada
e veja Tihosava

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | elb | tagji dhe okër |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 14 | 4 | 3 | 468 | barrë 25<br>750 | barrë 10<br>160 | barrë 20<br>280 |

| thekër | mel | musht | lini | [taksa] e bletëve | [taksa] perimeve |
|---|---|---|---|---|---|
| barrë 12<br>240 | barrë 5<br>100 | subur 55<br>1100 | 40 | 50 | 30 |

| [taksa] e frutave | taksa e govatës | [taksa] e barit | taksa e druve |
|---|---|---|---|
| 30 | 70 | 70 | 70 |

| mullinj të rajave 3 | livadhe hassa 1 | tokë hassa, 500 dynym | bidati i derrave |
|---|---|---|---|
| 90 | 60 | 300 | 20 |

*të ardhura 3886*



**Fshati Novosela[x], varet nga Peja; hass i sanxhakbeut.**

Bogdan Gllavaçi
Radona Prishliç
Marko, i biri i Brankos,
Rajko, i biri i tij
Vukaç Drajçini
Marko, i biri i Rajinit
Nikolla, i biri i Poposit[21]

Stojan Nikolla
Vukashini, i bir i tij
Nikolla, i vëllai i Vukashinit
Pop Bogdani
Bogdani, i biri i tij
Radiçi, i vëllai i tij
Radenko, i biri Pavlit[22]

(221)

Bogdani, i biri i tij
Bozhidar Siromah
Bogoi, i vëllai i tij
Vuku, i vëllai i tij
Bogdani, i biri i Rajçinës (Rajçina)
Gjorgj Rajini
Vladisavi, i vëllai i tij
bashtina e Radivoit, në dorën e Radonjas
e veja Bjela[23]
mysliman Karagjozi

Petko, i vëllai i tij
Bogdan Visha
Jovani, i vëllai i tij
Melko Mileni
Radosav Prishliç
Vlajko, i biri i tij
Bozhidari, i biri i Mihros
Andreja Siromah
Dujçini, i biri i Bozhidarit

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | elb dhe të tjera |
|---|---|---|---|---|---|
| 30 | 3 | 1 | 731 | barrë 15<br>450 | barrë 9<br>336 |

| thekër | mel | musht | taksa e govatës | taksa e barit |
|---|---|---|---|---|
| barrë 9<br>180 | barrë 3<br>60 | subur 90<br>1800 | 85 | 150 |

| taksa e druve | lini | [taksa e] bletëve | [taksa e] perimeve | fruta dhe arra |
|---|---|---|---|---|
| 60 | 150 | 55 | 6 | 42 |

| mullinj të rajave 4 | mullinj dëstile | bidati i derrave | livadhe hassa 1 |
|---|---|---|---|
| 120 | 120 | 30 | 30 |

| arra hassa, copë 40 | tokë hassa: dynym 200 | *shuma 4539* |
|---|---|---|
| 70 | 20 | |

**Fshati Petriça, varet nga Peja, hass i sanxhakbeut.**

Radenko, i biri i Dabzhivit
Radosa, i vëllai i Dimitrit
Bogiq Oçova
Radonja Radenko
Radosna Rajko

Gjura, i vëllai i tij
Todori, i vëllai i tij
Nikolla, i biri i tij
Stepani, i biri i tij
bashtina e Radiçit, në dorën e së

21) Mund të lexohet edhe Bobos, Potos- پوتوس، بوبوس. etj
22) Shkruesi e ka dhënë emrin në formën e gjindores së serbishtes: Radenko veled-i Pavla.
23) Zakonisht ky emër është shkruar pa shënjat diakritike بله dhe mund të lexohet Bjela ose Jela. Mendojmë se duhet të jetë Bjela بلة, ashtu siç shkruhet në faqen 281.

Bërçini[25], i vëllai i tij
Radiç Braslavi
Vuku, i biri i Bogoit
Bogdani i vëllai i Dimitrit

shoqes së Dabzhivit[24]
Bogdan Nenada[26]
Radosna, i biri i tij
Nikolla, i vëllai i tij

(222)

Jovani, i vëllai i tij
Rahaç Siromah
Petko, i biri i Gurishës (Gurisha)[27]
Bozhiqi, i vëllai i tij
Bogosav Stepa
Damjan Stepani
Jovani, i biri i Popit
Radosav Dabzhivi
Dabzhiv Radiçi
Milovani, i vëllai i tij
Laloja, i vëllai i tij

Vuk Prishliç
Radonja,i biri i Radonës (Radona)
Vukaçi, i biri i tij
Todor Radiçi
Milan Radovani
Bogdan Stoja
Pop Marko
Jovani, i biri i Dabkos
Rasha Dabko
Miloi, i vëllai i tij
bashtina e Vjukos (Vojuko), në dorën e Radës
Radonja Radovani

Radiç Rajini
bashtina e Mihajlos, në zotërim të Stosavës[28]
bashtina e Radiçit, në zotërim të Olivirit
Radiçi, i biri i Bogiqit
Nikolla, i vëllai i Radosavit
bashtina e Radoit, i biri i Ali Pashës, [në dorën] e Radiçit, të birit të Radosavit
sbahtina e Ivkos në dorën e Radosavit
bashtina e Miloshit, i biri i Milenit
e veja Todora e veja Spana
e veja Zhupa e veja Spasava
e veja Spasava
e veja Belina

Gjura, i biri i Vukut
Radovani, i biri i Todorit
Radosna, i vëllai i Nikolla Bogiqit
bashtina në dorën e Vidosavit
e veja Popadja e veja Milica
e veja Milica e veja Deboja
e veja Vukosava, e mplakur.

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | thekër dhe okër |
|---|---|---|---|---|---|
| 49 | 6 | 11 | 1441 | barrë 35<br>1050 | barrë 30<br>480 |
| elb | tagji | mel | musht | lini | [taksa e] bletëve |
| barrë 15<br>240 | barrë 35<br>490 | barrë 8<br>160 | subur 120<br>2400 | 150 | 45 |

24) Emri është dhënë në rasën gjindore të serbishtes: baştina Radiç der dest i zenëş-1 Dabjiva
25) Zakonisht është shkruar në formën برحں . Në faqen 265 e gjejmë të shkruar në mënyrë të plotë Bërçin برچن
26) Zakonisht është shkruar në formën: ننادہ . Në disa raste, si p.sh. në faqen 254 e gjejmë të shkruar në mënyrë të plotë Nenada ننادہ .
27) Mund të lexohet edhe Gorisha.
28) Në këtë rast, si e në të gjitha rastet e tjera kur tregohet zotëruesi i bashtinave emri i tij jepet në rasën gjindore të serbishtes.



| mullinj të rajave 3 | mullinj dërstile 2 | [taksa e] frutave | [taksa e] perimeve |
|---|---|---|---|
| 90 | 45 | 20 | 12 |
| taksa e govatës | taksa e barit | taksa e druve | bidati i derrave |
| 165 | 245 | 18 | 75 |
| livadhe hassa: 1<br>2 | *shuma 7334* | | |

(223)

**Fshati Liba,[29] varet nga Peja; hass i sanxhakbeut.**

Branko, i biri i Ramjonës (Ramjona)
Radonja, i vëllai i tij
Rajko, i vëllai i tij
Radosna, i vëllai i tij
Bogosavi, i biri i Borisavës (Borisava)
Vukaçi, i biri i Petkos
Radonja, i biri i Milanit
Radosav Siromah
Stepani, i biri i tij
Radenko Radovani
Vuçrini, i vëllai i tij
Vuku, i biri i tij
Radovaçi, i biri i Bogdanit
Vukosav Vlajko
Nikolla, i biri i Ivanit
Radosa, i vëllai i tij
Petko, i vëllai i tij
Ramjona Radosavi
Jovani, i vëllai i tij
Marko Vladisavi
Dimitri, i vëllai i tij
e veja Vladisava
e veja Vishosava

Ivko, i vëllai i tij
Radosna, i vëllai i tij
e veja Radosava

Melku, i biri i tij
Vuksani, i biri i ...
Radiçi, i biri i tij
Vukashini, i vëllai i tij
Radonja, i vëllai i tij
Radosa, i biri i tij
Radivoi, i biri i tij
Radosna, i biri i Bozhidarit
Jovani, i vëllai i tij
Brabari, i vëllai i tij
Radosna Gjorgji
Radosavi, i dhëndri i tij
Jovani, i biri i tij
Vukaçi, i vëllai i tij
Radonja, i biri i tij
Llaja, i vëllai i Petkos
Radosavi, i vëllai i Petkës
Radiç Stari (plak); Radosna, i biri i tij
Bozhidar Vojmiri
Mihajlo, i biri Markos
Vukosavi, i biri i Rajkos
e veja Radosava tjetër

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | elb dhe të tjera |
|---|---|---|---|---|---|
| 35 | 10 | 4 | 1149 | barrë 15<br>450 | barrë 19<br>34 |
| [taksa e] bletëve | [taksa e] perimeve | bidati i derrave | taksa e barit |
|---|---|---|---|
| 25 | 21 | 30 | 175 |
| taksa e druve | livadhe hassa: 1 | *shuma 22.4* | |
| 70 | 30 | | |

(224)

29) Sot ekziston me emrin Lipa. Ndodhet në veri të Pejës.

**Fshati Luzhiça[30], varet nga Peja; hass i sanxhakbeut.**

Vlaja, i biri Kodajës (Kodaja)
Dobroi, i vëllai i tij
Bozhidari, i biri i Vladisavit
Bogdani, i vëllai i tij
Radosav Nikolla
Bogdan Stari
Nikolla, i vëllai i tij
Nikolla Novaku Jovan Stepani
Vukashin Prishliçi
Rasha Vladisavi
Radiçi, i vëllai i Vlajës
Radosna Kallogjeri
Mirça, i vëllai i tij
Cvetko Siromah
Gjorgji i biri i Radosnës
Mihali, i vëllai i Radiçit
në dorën e Vuçës (Vuça) e veja Milica

Pop Radoslavi
Jovan Brisavi
Dabzhivi, i biri i tij
Vuk Milovaci
Bozhidari, i vëllai i tij
Damjani, i biri i tij
Vukaçi, i biri i Radosavit
Pavlo, i vëllai i tij
Bosa[31] Popi, Mihajlo, i vëllai i tij
Radivoi Bogdani
Radona Vlaja
Bozhiq Borovaci
Radonja, i biri i Gjuriqit
Gjura Prishliçx Radiç Prishliç
bashtina e Radonjës, i biri i Radiçit
bashtina e Cvetkos,
e veja Milica tjetër

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | elb | thekër |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 | 6 | 2 | 887 | barrë 35<br>1050 | barrë 15<br>240 | barrë 12<br>240 |

| tagji dhe okër | bathë | burxhak | musht | taksa e govatës |
|---|---|---|---|---|
| barrë 17<br>237 | barrë 1<br>30 | barrë 2<br>40 | subur 70<br>1400 | 95 |

| taksa e barit | taksa e druve | [taksa e] bletëve | [taksa e] perimeve |
|---|---|---|---|
| 145 | 85 | 30 | 12 |

| [taksa e] frutave | bidati i derrave | vreshta hassa, 1 | livadhe hassa: 1 | *shuma 4692* |
|---|---|---|---|---|
| 12 | 35 | subur 5<br>100 | 80 | |

**Fshati Virpnica, varet nga Peja; hass i sanxhakbeut.**

Radiçi, i biri i Nikollës
Todori, i biri i Brajanit[32]
Dabzhivi, i biri i Nikollës

Nikolla, i biri i tij
Radonja, i biri i Ivanit

(225)

Dulovaç Siromah
Stepan Gjorgji

Radosavi, i vëllai i Radiçit
Radosavi, i vëllai i tij

30) Sot Ljuzhi, në veri të Jablanicës.

31) Zakonisht emrin بوسه e kemi lexuar Bosa. Nuk e kemi lexuar Boja, sepse këtë emër e gjejmë në formën بوبه،بوبه

32) Zakonisht këtë emër e ndeshim të shkruar në formën: براپان prandaj mund të lexohet në dy forma: Brajan dhe Bratan. Në disa raste e gjejmë të shkruar edhe me shenjat diakritike, p.sh. në faqen 267 jepet në formën Brajan– براپان ose në faqen 355 jepet në formën Bratan براتان. Këtë emër zakonisht i kemi lexuar Brajan, sepse në këtë formë e ndeshim më shpesh edhe në materialet e tjera dokumentare osmane si p.sh. defteri i sanxhakut të Shkodrës i vitit 1582. (Tapu ve Kadastro umum müdürlüğün ün arşivi, defter nr.59).



Dabzhivi, i vëllai i Bojkqs
Radosav Gjurashini
Jovani, i vëllai i Gjurashinit
Radosavi, i biri i Popit
Nikavaçi, i biri Menkut
Vukosali i biri i Todorit
bashtina e Ivanit
e veja Belina
e veja Raja

Radosav Bojko
Bogosavi, i vëllai i tij
Jovani, i biri i tij
Radosav Nikolla
Radiçi, i biri i Radosavit
bashtina e Markos
bashtina e Nikollës, në dorën e Radiçit

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | elb | thekër |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 21 | 2 | 2 | 587 | barrë 15<br>450 | barrë 7<br>113 | barrë 7<br>140 |

| okër | mel | burxhak | musht | taksa e govatës | taksa e barit |
|---|---|---|---|---|---|
| barrë 9<br>126 | barrë 2<br>40 | barrë 3<br>60 | subur 49<br>980 | 95 | 105 |

| taksa e druve | [taksa e] perimeve | [taksa e] bletëve | bidati i derrave |
|---|---|---|---|
| 42 | 12 | 20 | 20 |

| mullinj uji: 2 | [taksa e] frutave | truallishta Popoça, e braktisur |
|---|---|---|
| 30 | 15 | të ardhura 150 |

*shuma: 2834*

**Fshati Balic, varet nga Peja; hass i sanxhakbeut.**

Bozhidar Radosavi
Radiç Bozhidari
Radiç Bozhiqi
Radiç Miloshi
Stepan Stanisha
Olivir Radiçi
e veja Radosava

Bogosav Gjorgji
Todor Stepani
Stepani, i vëllai i tij
Dimitri, i biri i Radosavit
Radiç Radenko
e veja Vidosava

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | elb dhe tagji |
|---|---|---|---|---|---|
| 9 | 2 | 2 | 287 | barrë 14<br>420 | barrë 15<br>240 |

| burxhak | musht | mel |
|---|---|---|
| barrë 1<br>20 | subur 23<br>440 | barrë 2<br>40 |

(226)

| taksa e govatës | taksa e barit | taksa e druve | [taksa e] perimeve |
|---|---|---|---|
| 45 | 45 | 18 | 12 |

| [taksa e] bletëve | bidati i derrave | *shuma 1601* |
|---|---|---|
| 20 | 14 | |

**Fshati Jablanica e madhe[x 33], varet nga Peja, hass i sanxhakbeut.**

Mali, i biri i Radosnës
Radosna Radenko
Pop Bozhidari
Marko, i vëllai i tij
Radiçi, i biri i Radiçit
Vukani, i biri i tij
Jovan Popi
Radosavi, i vëllai i tij
Vukosavi, i vëllai i tij
Bogdan Vllaku
Rashko Radonja
Milani, i vëllai i tij
Vuku, i vëllai i tij
Radona, i biri i Vukut
Bozhidar Ivani
Vuku, i biri i tij
Bozhidar Radmili
Bozhidari, i vëllai i tij
Radosavi, i biri i tij
Todori, i biri i tij
Oliviri, i biri Bogdanit
Bozhidari, i vëllai i tij
Jovani, i vëllai i tij
Jovan Vukashini
Bosa Rajko
e veja Stosava

Radiçi. i vëllai i tij
Radosavi, i vëllai i tij
Jaku (Jako), i biri i tij
Dimitri, i vëllai i tij
Radenko, i vëllai i tij
Petri, i biri i Brankos
Bozhiq Kovaçi
Stepan Pljaku[34]
Bozhidar Bogdani
Radosna, i biri i Radenkos
Jovani, i biri i tij
Vukaç Vlajko
Vuku, i biri i Radonës
Todori, i biri i Gjuriqit
Radiç Radonja
Gjurashini, i vëllai i Radiçit
Dobroi, i biri i Radosavit
Bogdan Gjorgji
Rashani, i biri i Gjorgjit
Olivir Stanisha
Radona, i vëllai i tij
Vuku, i biri i Bogdanit
Todor Protogjeri
Radiç Radani
bashtina në dorën e Bogdanit
e veja Mara

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | elb dhe tagji |
| 38 | 12 | 2 | 1262 | barrë 16<br>480 | barrë 40<br>640 |

| | | |
|---|---|---|
| thekër | musht | mel |
| barrë 4 | subur 180 | barrë 2 |
| 80 | 3600 | 40 |

(227)

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| [taksa e]perimeve | [taksa e] bletëve | mullinj të rajave, uji | | taksa e govatës |
| 96 | 50 | 15 | | 180 |
| [taksa e] frutave | lini | arra | bidati i derrave | taksa e barit |
| 40 | 60 | barrë 1 | 55 | 190<br>25 |
| taksa e druve | *shuma 6889* | | | |
| 76 | | | | |

33) Në orgiinal: Jablanica kebire. Sot ekziston fshati Jablanica në veri të Pejës.

34) Zakonisht këtë emër e gjejmë të shkruar në tre forma Pljak (پلاق), Pjak (پاق)dhe Plak (پلاق)Për emrat Plak dhe Pjak leximi është i sigurtë sepse gjejmë raste kur ata janë të shkruar me shenja diakritike (shih f.166), kurse leximi i emrit Plajk nuk është i sigurtë mbasi mund të lexohet edhe Bljak ose Beljak. Mendojmë se emri Plak duhet të ketë qenë përdorur, meqë e ndeshim shpesh edhe në trajtën serbe star.



**Fshati Moster[34], varet nga Peja; hass i sanxhakbeut.**

Vukota Radonja Zhivko, i biri i tij
Gjurashini, i vëllai i tij
Dragushi, i biri i tij
Bogosavi, i vëllai i Vukotës
Radosavi i biri i Vukaçit
Vuksani, i vëllai i tij
Vuku, i vëllai i tij
Melshini, i vëllai i tij
Zhivko, i biri i tij
Radosav Radani
Vuku, i vëllai i tij
Todori, i vëllai i tij
Stepani, i vëllai i tij
Zhivko, i biri i tij
Radosavi, i biri i tij
Vukota, i biri i Vlajkos
Vukashin Vukota
Petko, i vëllai Radiçit
Ibrahimi, i biri i tij
Zhivko, i biri i Vladisavit
Bozhidari, i biri i tij
Radonja Rajko
Gjurashini, i vëllai i tij
Radiçi, i vëllai i tij
Brajani, i vëllai i tij
Vukçko Vlajko
Radovani, i vëllai i tij

Stepani, i vëllai i tij
Bogdani, i vëllai i Vukotës
Dimitri, i vëllai i tij
Radashini, i biri i tij
Milashi, i vëllai i tij
Radiç Radovaçi
Mihaçi, i vëllai i tij
Radonja, i vëllai i tij
Dobroi, i vëllai i tij
Gjurko, i vëllai i tij
Radmili, i vëllai i tij
Zhivko, i biri i Nenadës
Bogosavi
Bojko Siromah
Radiçi, i vëllai i tij
Vladisavi, i biri i tij
Radiçi, i vëllai i tij
Stepan Obradi
Vladisavi, i vëllai i Stepanit
Vukashin Rajko
Radenko, i vëllai i tij
Radashani, i biri i tij
Vukadini, i vëllai i tij
Radosavi, i vëllai i tij
Vuksani, i vëllai i tij
Rahaçi, i biri i tij
Vukaç Radosavi

(228)

Vukmani, i vëllai i tij
Vukani, i vëllai i tij
Radashini, i vëllai i tij
Vuku, i biri i tij
Mihaçi, i vëllai i Petkos
Gjurashini, i vëllai i tij
Vuku, i biri i tij
Radonja, i vëllai i tij
Radashini, i biri i tij
bashtina në zotërim të Vukadinit
e veja Milica

Radiçi, i vëllai i tij
Milashini, i vëllai tij
Petko Oliviri
Nikolla, i vëllai i tij
Vukashini, i vëllai i tij
Prenushi,[35] i biri i Dabzhivit
Bogdani, i vëllai i tij
Brajan Ekmena (Ekumena)[36]
Vukmani, i vëllai i tij
e veja Stosava

34) Sot Mojster.

35) Zakonisht është shkruar pa shenjat diakritike- برابوش. Mund të lexohet edhe Bratosh, Brajosh, Branosh- براتوش، برايوش ، برانوش

36) Këtu është shkruar اكمنه. Në faqen që pason e gjejmë të shkruar me shenjat diakritike Ekmena اكمنه

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | elb | okër |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 64 | 10 | 2 | 1862 | barrë 25<br>600 | barrë 15<br>240 | barrë 25<br>350 |

| thekër | thjerza | lini | [taksa e] perimeve | [taksa e] bletëve |
|---|---|---|---|---|
| barrë 15 | barrë 1<br>30 | 60 | 60 | 100 |

| taksa e derrave | mullinj të rajave 2 | taksa e druve | [taksa e] barit |
|---|---|---|---|
| 100 | 30 | 128 | 320 |

*shuma;* 4180

**Fshati Dobrina[37], varet nga Peja; hass i sanxhakbeut.**

Vuk Nikolla
Vuku, i biri i Mihaçit
Radosavi, i biri i Mirebjelanit
Radiçi, i vëllai i tij
Radovaçi, i biri i Pjakut
Radonja Radosavi
Nikolla Radiçi
Rahaçi, i biri i Rashës
Jovani, i vëllai i tij
Ivanshi, i biri i tij
Rahaç Radosavi
Vuku, i vëllai i tij
Jovan Radmani

| shtëpi | beqarë | ispenxhe | grurë | elb | thekër | tagji |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | 3 | 325 | barrë 7<br>210 | barrë 9<br>144 | barrë 3<br>60 | barrë 10<br>160 |

| okër | kumbulla *38* | lini | [taksa e] bletëve | [taksa e] perimeve |
|---|---|---|---|---|
| barrë 17<br>238 | gjysmë barre<br>15 | 10 | 50 | 20 |

| mullinj të rajave 1 | taksa e barit | taksa e druve | bidati i derrave |
|---|---|---|---|
| 30 | 50 | 20 | 15 |

*shuma* 1347

(229)

**Fshati Smraka, varet nga Peja; hass i të sipërpërmendurit.**

Vukashin Oliviri
Marku, i vëllai i tij
Brajan Çerpi
Vukashini, i vëllai i tij
Bozhiqi, i biri i tij
Vuku, i biri i tij
Rahaç Radonja
Melku, i vëllai i tij
Ramjona Ekmeni
Gjurko, i vëllai i tij
Miloshi, i vëllai i tij
Mërsha, i biri i tij
Radosavi, i biri i Dubkos
Nikolla, i vëllai i tij
Radonja, i vëllai i tij
Vuksani, i vëllai i tij
Radosavi, i vëllai i tij
Mihan Ekmeni (Ekumeni)
Vukmani, i vëllai i tij
Petko, i biri i Radosnës
Vukaçi, i vëllai i tij
Radiçi, i biri i tij
Vuku, i vëllai i tij
Radiç Radoviça
Bojko, i vëllai i Radiçit
Todori, i biri i Bogqarit

37) Mund të jetë fshati i sotëm Dubrava, në lindje të Istokut.
38) Një lloj kumbulle e zezë që përdoret për prodhimin e rakisë.



Vukla, i biri i Ramiçit
bashtina e Jovanit në dorën e Vukashinit
bashtina e Vukut në dorën e Ramiçit
e veja Radosava
bashtina e Gjurës, në dorën e Brajanit
e veja Todora
mysliman Jusufi

| shtëpi | beqarë | të veja | ispenxhe | grurë | elb | thekër |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 24 | 7 | 2 | 787 | barrë 12<br>360 | barrë 9<br>144 | barrë 4<br>80 |

| tagji | okër | kumbulla | [taksa e] perimeve | [taksa e] bletve |
|---|---|---|---|---|
| barrë 13<br>182 | barrë 14<br>196 | barrë 2<br>60 | 20 | 30 |

| lini | taksa e barit | taksa e druve | bidati i derrave |
|---|---|---|---|
| 20 | 120 | 48 | 25 |

mullinj të rajave 1
15

**Fshati Koçarnik, varet nga Peja, hass i sanxhakbeut.**

Pop Radiçi
Jovani, i biri i tij
Vuku, i vëllai i tij
Olivir Obradi
Stepani, i vëllai tij
Radan Radsavi
Brajani, i vëllai i Popit
Bojani, i vëllai i tij
Radivoi Radonja
Dimitrashi, i vëllai i tij
Stepani, i vëllai i tij
Marko, i biri i tij

(230)

Radmani, i vëllai i tij
Radosna Viosava
Radonja, i biri i tij
Dimitri, i vëllai i tij
Bozhidar Dabzhivi
Radivoi, i vëllai i tij
Marko Radosavi
Stepan Gosali
Radonja, i vëllai i tij
Vuçeta Todori
